



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 11 DHE 18 PRILL 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 11. I 18. APRILA 2013. GODINE**

**PRILL - APRIL
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për turizmin,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut,
6. Debat parlamentar lidhur me statusin e pazgjidhur të punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti 1990 deri në vitin shkollor 1999, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së dhe rekomandimeve të komisioneve parlamentare.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o turizmu,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o inspektoratu i nadgledanju tržišta
6. Parlamentarna rasprava u vezi nerešenog statusa albanskih prosvetnih radnika Republike Kosova od školske 1990 do 1999. god. na zahtev Parlamentarne grupe LDK i preporukama parlamentarnih komisija.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha e paraparë për këtë pikë të rendit të ditës është 30 minuta, në emër të grupeve parlamentare 5 minuta, në emër të deputetëve 3 minuta. Mos kërkon kohë shtesë.

Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit!
I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Jakup Krasniqi,
E nderuara Qeveri,
Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete
Ju të pranishëm,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Dje, më 10 prill, u mbushën 15 vjet kur Kosova dhe shqiptaria e ka humbur pa gjurmë njeriun, i cili dha gjithçka që ne sot të jemi këtu, të jemi këtu si deputetë të këtij Parlamenti, si ligjvënës shtetërorë, si përfaqësues të ligjshmërisë njerëzore dhe kombëtare.

Nuk mund të anashkalohet kjo ditë dhe datë pa i thënë disa fjalë për doktor Hafir Shalën.

Doktor Hafiri, siç rëndom e thërriste populli, punonte si doktor i Shoqatës Humanitare “Nëna Tereza” në disa punkte shëndetësore të fshatrave të Drenicës, si në Bajicë, Krajkovë, punonte edhe në Shtëpinë e Shëndetit në Drenas, ish-Gllogoc, derisa hynë masat e dhunshme.

Ai, përveç që e bënte si mjek, ishte humanist i madh, ishte veprimtar dhe i burgosur politik, mbrojtës i të drejtave njerëzore, si dhe aktivist i dalluar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

Ai e udhëhiqte Shoqatën e të Burgosurve Politikë, ishte intelektual dhe atdhetar i pashoq.

Më 10 prill të vitit 1998, u kidnapua nga Shërbimi Sekret Serb në bashkëpunim me disa shqipfolës, në pikë të ditës. Dihet botërisht se aktorët dhe dëshmitarët e këtij rrëmbimi janë gjallë dhe shëtisin në Kosovë dhe jashtë saj. Andaj, u bëj thirrje institucioneve relevante të drejtësisë vendore dhe ndërkombëtare që ta zbardhin të vërtetën, ta sqarojnë opinionin dhe familjen e tij mbi fatin e humanistit doktor Hafir Shala.

15-vjetori i zhdukjes së tij le të jetë jo vetëm thirrje për drejtësi, por trokitje në ndërgjegjen e të gjithë atyre që e njohën, që bashkëvepruan, e të gjithë atyre që sot bartin përgjegjësi institucionale, e që kanë mundësi të ndihmojnë në këtë proces.

Vetëm atëherë, sadopak do ta justifikonim obligimin dhe përgjegjësitë që i kemi, e do ta nderonim humanizmin dhe atdhedashurinë e doktor Hafir Shalës.

Shpresoj se angazhimi ynë i përbashkët do t'i japë fund ankthit të familjes, gruas dhe fëmijëve të tij, të gjithë atyre që e njohën nga afër dhe nga larg. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike, nënkryetar Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit, Krasniqi, Deputetë, kolegë të nderuar,

Ne do ta kemi sot pikë të rendit të ditës çështjen e arsimit shqip të viteve të '90-ta të shekullit të kaluar. Por, unë sot dal që tash të shpreh më së pari nderimin më të thellë për gjithë ata që kanë mbajtur mësim, që e kanë organizuar mësimin dhe që i kanë ndjekur mësimet që nga klasa e parë e fillores dhe në universitet në ato vite. Ky është sistemi më i provuar dhe më i verifikuar që ka ndodhur ndonjëherë në një shoqëri, i një rezistence arsimore, kulturore dhe identitare shqiptare.

Ky është një shërbim dhe një organizim i rrjetit të mbijetesës kulturore dhe arsimore të shqiptarëve dhe shpëtim i një brezi, i një brezi të rinjsh dhe i një brezi shërbyesish të tyre. Këto janë 10 vjet shkollorë, që kur shumëzohen me numrin e nxënësve, ju do të gjeni një fatum të nocionit, i cili ka mbijetuar, duke mësuar dhe ka rezistuar duke mësuar.

Kjo ka ndodhur për shkak se në krye të zhvillimeve shoqërore politike në Kosovë aso kohe ka qenë Rugova, i cili për kah natyra ka qenë biri i dijes dhe dashurues i dijes brenda shqiptarëve dhe gjithë politikën e vet e ka pasur të mbështetur në diturinë si bazë e durimit, e ekzistencës, e tolerancës, e marrëveshjes, e përparimit. Këtu sot nuk mund të mos i përmend edhe ata që në fushën e arsimit në vitet e '90-ta kanë qenë përgjegjës direkt ose indirekt, dy këshilltarë të tij të njohur, profesor e universitetit Xhavit Ahmetin, që nuk është më në mesin tonë, dhe Zejnullah Rrahmani, e po ashtu dhe Rexhep Osmanin, i cili ka qenë organizator i rrjetit shkollor dhe mësimor të atyre viteve. Plus rektorin e Universitetit të Prishtinës në kushte e jashtëzakonshme të mbijetesës të mësimin universitar, Ejup Statovci, me ekipin e studentëve të vet.

Arsimtarët dhe nxënësit janë mbijetuesit e mëdhenj të këtij vendi, për të mos u shprishur. Unë i kujtoj burrat dhe gratë mësimdhënës të viteve '90 të papaguar, të veshur ligisht, të ndjekur të kaluar nëpër procese të egra gjyqësore, policore, me dosje policore, të cilët nuk kanë hequr dorë t'i mësojnë nxënësit dhe nuk kanë hequr dorë nga programet identitare kulturore.

Kujtoj që në këto vite dhe ky është absurdi i situatave të jashtëzakonshme që prodhon gjendje, do të thosha të jashtëzakonshme, janë bërë programet e lëndëve nacionale të përbashkëta Shqipëri-Kosovë dhe janë prodhuar tekstet më të njohura, të cilat kanë

mbijetuar dy decenie. Domethënë prodhimi në këtë nivel ka qenë i lartë, plus është hera e parë që mbyllja e Seminarit Ndërkombëtar në Kosovë për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është shpërngulur për dy vjet, në vitet 1995 dhe 1996, në Tiranë, dhe e ka ruajtur nivelin, rritjen e bashkëpunësuesve, të të interesuarve.

Unë edhe një herë po e përmbyll për të thirrur atë që do ta bëjmë në një pikë të veçantë të rendit të ditës, që është një periudhë specifike e mbijetesës, e strukturimit nacional kulturor, që është trashëgimi e këtij vendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Grupit të “Vetëvendosjes” deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Serbia nuk e pranoi marrëveshjen që do ta përmbyllte dialogun politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, jo për shkak se ajo nuk ishte e favorshme për të, por për shkak se nuk ishte e mjaftueshme për apetitet e saj.

Arsyeja tjetër pse Serbia e refuzoi këtë marrëveshje është për shkak se ai është person edhe më tej kryeministri Thaçi, prandaj edhe kërkoi dialog shtesë.

Kërkesa e Serbisë për dialog shtesë është shpresë për koncesione shtesë nga Kosova.

Serbia e di që Thaçi është i dobët, posaçërisht karshi faktorëve ndërkombëtarë. Andaj, dëshiron që të zgjatet kjo lojë me fatin e Kosovës.

Këtë javë, me atë që u quajt qasje integruar për veriun, pjesëmarrësit, ku ishte edhe kryeministri Thaçi, u dakorduan, përveç tjerash që, po citoj “deri në fund të muajit prill do të përgatiten termat e referencës për angazhimin e donatorëve në veri. Temat e referencës do t’i përcaktojnë strukturat, përgjegjësitë dhe procedurat për investimet në Mitrovicën veriore”, siç është quajtur aty.

Kjo do të thotë që edhe pa marrëveshje me Serbinë po zbatohen koncesione ndaj saj. Kjo qasje integruar për veriun nuk e integron veriun, përkundrazi ajo do ta ndajë Kosovën me veriun gjithnjë e më të zhvilluar dhe jugun gjithnjë e më të varfër në frymën e fondit zhvillimor për veriun, këtij buxheti paralel me Kosovën.

Ngjashëm edhe pas rundit të tetë të dialogut ndërmjet Thaçit e Daçiqit në Bruksel ku nuk u arrit marrëveshja atje në konferencën për shtyp në Prishtinë. Thaçi deklaroi që asociacioni i komunave me shumicë serbe do të jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Po cili është kuptimi të flitet për këtë asociacion, kur nuk u bë marrëveshja.

Kjo është edhe një dëshmi tjetër për tendencën që të gjitha koncesionet e deritashme të zbatohen njëanshëm, sikur plani i Ahtisarit.

Dialogu pa kushte për Serbinë dhe për çështje të brendshme të Kosovës ka qenë gjithmonë i padrejtë ndaj Kosovës dhe zgjatja e tij vetëm sa e shton dëmin që e përjetojmë.

Edhe më keq se kaq, Qeveria e Kosovës i zbaton njëanshëm koncesionet ndaj Serbisë, përkundër refuzimit që Serbia ia bënë marrëveshjes, si shumë e atyre koncesioneve.

Pikërisht zbatimi i njëanshëm në Kosovë i koncesioneve ndaj Serbisë e inkurajon Serbinë ta refuzojë marrëveshjen drejt dialogut, me çka fiton koncesione të reja.

Ky dialog ka qenë i keq prej fillimit. Nuk bëhet fjalë për kurrfarë marrëveshje të mirë që na e paska refuzuar Serbia. Ajo marrëveshje e ndryshon Kosovën përbrenda për të keq dhe Serbisë së njëjtë të Milosheviqit i krijon favore jashtë.

Dialogu me Serbinë e pezullon shtetndërtimin e Kosovës. Dialogu kurrësi nuk duhet të vazhdohet. Të gjitha dakordimet e marrëveshjeve të mëparshme gjatë dialogut teknik e politik me Serbinë duhet të shpallen të pavlefshme.

Ne ju bëjmë thirrje të gjitha subjekteve politike dhe gjithë shoqërisë që ta kundërshtojnë çfarëdo dialogu të mëtutjeshëm. Gatishmëria individuale e Thaçit duhet të mbetet e tillë, pra vetëm individuale dhe vetëm e tij.

Nga komunikata e kësaj jave, pra para disa ditëve, kuptojmë që ai po i thotë ‘po’ vazhdimit të dialogut pa raportuar në Kuvend për takimin e tij të tetë me Daçiqin. Ai po përgatitet për një proces të ri anash e sipër institucioneve të Kosovës.

Ndërkohë që në këtë proces të ri, natyrisht që do të ketë dialog shtesë dhe koncesione shtesë për atë që është quajtur marrëveshja e refuzuar nga Serbia, mirëpo as qytetarët e Kosovës, e as Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk do ta ketë një pikë reference për ta ditur nëse dhe në ç’masë ka ndryshuar kjo marrëveshje prej asaj që është refuzuar nga Serbia në atë që ka mundësi ta pranojë Serbia në të ardhmen.

Për shkak se nuk e kemi parë marrëveshjen, çfarëdo marrëveshje që mund të lindë nga ky dialog shtesë do të na quhet ose do të na shitet si marrëveshje, e cila një herë është refuzuar nga Serbia dhe tash Serbia paska ndryshuar mendje.

Pra, ndryshimi i mendjes, lëshimi pe i kryeministrit Thaçi do të na shitet si lëshim pe i Serbisë karshi këtij dialogu dhe kësaj marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryetar!

Diskutimi im sot ndërlidhet me mungesën e Spitalit të Qytetit të Prishtinës. Pse Prishtina nuk ka spital të qytetit dhe cilat janë dobitë nga një spital i tillë?

Mungesa e Spitalit të Qytetit të Prishtinës, në radhë të parë, është hendikep për qytetarët e kryeqytetit. Prishtinasit për shërbime sekondare shëndetësore janë të detyruar të drejtohen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ku duhet të hyjnë në radhë me të gjithë qytetarët e Kosovës që drejtohen apo udhëzohen këtu për shërbime terciare.

Në këtë mënyrë, qytetarët e Prishtinës nuk e kanë privilegjin dhe komoditetin e pranimit të shërbimeve sekondare spitalore në spitalin e qytetit të tyre, i cili sigurisht nuk do të ishte i ngarkuar, ashtu siç është aktualisht QKUK-ja.

Në anën tjetër, Spitali i Qytetit të Prishtinës do të ndikonte në zvogëlimin e radhëve të gjata të pritjes, si dhe listat e gjata të pritjes në QKUK.

Rëndësia e dytë e funksionalizimit të Spitalit të Qytetit të Prishtinës do të bënte që QKUK-ja të merrej vërtet me shërbimet terciare shëndetësore për çka edhe është e dedikuar, e që sot për sot nuk është në nivelin e pritjes, pa dyshim edhe për faktin e mungesës së një qendre për ofrimin e shërbimeve sekondare në Prishtinë.

Unë thellësisht besoj se prania dhe funksionalizimi i Spitalit të Qytetit do të ndikonte në shkarkimin e QKUK-së nga barra sasiore, e kjo domosdoshmërisht do të ndikonte në ofrimin e shërbimeve shëndetësore më cilësore dhe më të sofistikuara në vetë QKUK-ja, pra të ofrohen vërtet shërbime të nivelit terciar shëndetësor.

Dimensioni i tretë i rëndësisë së këtij spitali do të ishte edhe punësimi i specialistëve të rinj. Aktualisht, QKUK-ja është e vetmja qendër ku synojnë dhe shpresojnë të punësohen specialistët, e posaçërisht ata që janë qytetarë të Prishtinës. Me keqardhje më duhet të konkludoj se QKUK-ja po shndërrohet në një qendër sociale të mbipopulluar që ka për qëllim t'i akomodojë specialistët e mjekësisë që kanë investuar vite të gjata shkollimi, por me oferta shumë të vogla për vende të punës, e që të vetmen shpresë për punësim e shohin në QKUK-në e mbipopulluar me mjekë. Këtu më duhet të theksoj se nevoja për Spital të Qytetit të Prishtinës është që nga koha e themelimit të Fakultetit të Mjekësisë, por në mungesë të kuadrove një gjë e tillë nuk ka mundur të bëhet atëherë. Por, a do ta ketë Prishtina spitalin e vet sot?

Në buxhetin e vitit 2011, tek investimet kapitale të Ministrisë së Shëndetësisë parashihej që investimet për Spitalin e Prishtinës të fillonin në vitin 2012, me rreth 1 milion e 130 mijë euro dhe të vazhdonin në vitin 2013 me rreth 2 milionë e 130 mijë euro. Ndërkaq, në buxhetin e vitit 2012, pikërisht në vitin kur është dashur të fillohej me investimet për Spitalin e Qytetit të Prishtinës, kjo rubrikë është hequr nga tabelat. Kjo ndodhi heshturazi, pa u komentuar fare.

Të nderuar deputetë, është koha e fundit që Prishtina të ketë spital të qytetit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Më 15 tetor 2011, gjatë punimeve në lagjen Bair të Mitrovicës, në vendin e ish-kazermës së Armatës jugosllave, janë gjetur mbetjet mortore të 55 personave.

U bë më shumë se një vit që ku në këtë foltore e kam paraqitur kërkesën e familjarëve të personave të zhdukur të luftës së fundit dhe të Luftës së Dytë Botërore që mbetjet mortore të gjetura në lagjen Bair të ekzaminohen dhe të identifikohen nëpërmjet analizës së ADN-së, gjë e cila deri më sot nuk është bërë, por mbetjet mortore të 55 personave të gjetura në zonën afër ish-kazermës ushtarake në lagjen Bair të Mitrovicës janë rivarrosur në varrezat e martirëve në Shipol të Mitrovicës pa u bërë asnjë ekzaminim, as identifikim i tyre.

Supozohet se këto mbetje mortore të jenë të shqiptarëve të vrarë nga ushtria serbe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Dyshohet se këto mbetje mortore janë eshtrat e udhëheqësve të Drenicës të asaj kohe që ishin ekzekutuar në kazermën e Bairit. Dyshohet se ato janë mbetje mortore të eshtrave si të Sadik Zenelit, Rexhep Vojvodës e Alil Haxhisë dhe 17 personave nga Gllanasella dhe të disa ushtarëve amerikanë, të cilët dyshohen se ishin rrëzuar me aeroplanin e tyre në regjionin e Mitrovicës.

Aty dyshohet se janë eshtrat e udhëheqësve të luftës së Drenicës dhe pjesëmarrësve të Konferencës së Bujanit.

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës e ka mbështetur kërkesën e familjarëve të personave të zhdukur dhe Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Qendra rajonale Mitrovicë, që mbetjet mortore të zhvarrosura në lagjen Bair të Mitrovicës të ekzaminohen dhe të identifikohen nëpërmjet analizës së ADN-së. Por, deri më sot nuk është bërë asnjë veprim konkret për t'i filluar punën për ekzaminimin dhe identifikimin e këtyre mbetjeve mortore në bazë të analizave të ADN-së.

Kërkoj nga Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, Departamenti i Mjekësisë Ligjore, nga Ministria e Drejtësisë dhe institucione tjera përkatëse që të angazhohet seriozisht që kërkesa e Shoqatës së Familjeve, zëri i prindërve të jetësohet që këto mbetje mortore të identifikohen.

Gjatë punimeve në këtë lokacion, kam theksuar edhe më parë, janë gjetur eshtrat e mbetjeve mortore, që nuk janë të një ngjyre. Andaj, dyshohet se disa nga këto mbetje mortore mund t'i takojnë edhe luftës së fundit. Kështu që është në interesin e përgjithshëm ekzaminimi i tyre nga ekspertët e Departamentit të Mjekësisë Ligjore, pavarësisht se cilës periudhë kohore i takojnë, sepse bëhet fjalë për 55 persona të vrarë, tani të zhdukur. Është njerëzore, është humane që të bëhet ekzaminimi i atyre eshtrave të njerëzve të vrarë.

Departamenti i Mjekësisë Ligjore e ka obligim ligjor dhe profesional që t'i ekzaminojë këto mbetje mortore, edhe pse deri më sot nuk i është përgjigjur kërkesës së Shoqatës së

Familjeve për Persona të Zhdukur dhe Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur që këto mbetje të vendosen në Morgun e Departamentit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë dhe të ekzaminohen nga ekspertët, sipas legjislacionit në fuqi.

Ajo çka është bërë deri më sot për këto mbetje mortore të gjetura në Bair është varrosja e tyre nga Bairi në Shipol, pa u bërë ekzaminimi dhe identifikimi i tyre në bazë të analizave përkatëse.

Shpresoj që institucionet përkatëse ta marrin seriozisht trajtimin e këtyre mbetjeve mortore dhe ankthi i familjarëve të këtyre personave të përfundojë njëherë e përgjithmonë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe përkundër mundësisë reale për ndalimin e negociatave me Serbinë, po shihet qartë se kryeministri po tregon gatishmëri për ta vazhduar këtë proces.

Refuzimi nga Serbia tani, edhe përkundër koncesioneve të shumta, përbën një rast për tërheqjen e marrëveshjeve dhe për vendosjen e kushteve asaj në lidhje me të ardhmen.

Rast ideal që tani t'i vihen kushte Serbisë edhe për të drejtat e qytetarëve të Medvegjës, Preshevës e Bujanocit. Rast për ta korrigjuar sadopak të kaluarën, për ta korrigjuar gabimin që Kosova i shkonte Serbisë në negociata dhe takime, në ndërkohë që ajo ushtronte dhunë kundër shqiptarëve atje.

Rast për ta korrigjuar gabimin që kryeministri nuk vuri asnjë kusht para se të fillonin negociatat, në ndërkohë që krekosej se ka bërë shumë më shumë se cilido, madje më shumë se edhe vetë qytetarët e atjeshëm, për këto tri komuna.

Rast i mirë që të ndërpriten negociatat dhe të viheshin kushte për Serbinë ishte edhe heqja e lapidarit. Serbia etregoi brutalitetin e saj pikërisht ndërmjet takimeve. Ishte rast dhe madje i domosdoshëm. Kryeministri shkoi serish në takim, edhe pas kësaj ngjarjeje. Daçiqi u rehabilitua për veprimin e bërë nga kryeministri ynë.

Në këto takime nuk hezitoi të bënte oferta, por kurrsesi të vinte kushte për Serbinë. Kosova pati raste të shumta dhe e ka një rast tani. Nuk duhet të shkoni sërish në negociata, e keni rastin ideal, shikuar edhe nga këndvështrimi juaj i dobët.

Edhe pse ne nuk besojmë se mund ta bëni këtë, ju madje keni vënë barriera për shqiptarët e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës dhe nuk i lini të kalojnë këndeja pa paguar haraç. Ndalojeni haraçin për qytetarët shqiptarë të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës dhe vendosni kushte Serbisë dhe për të drejtat e tyre. Kjo është më e pakta që mund të bëni për ta. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje zëvendëskryeministër, ministër,

Kolegë deputetë,

Kuvendi i Kosovës e ka mbajtur një seancë më 19 maj 2011 për çështjen e shqyrtimit në debat për rastin e Dubravës, për masakrën në Burgut të Dubravës.

Dy vjet më pas, ende nuk kemi asnjë qasje se deri ku ka arritur drejtësia, deri ku ka arritur kjo çështje e trajtimit të kësaj masakre, që është një ndër më të rëndat pas Luftës së Dytë Botërore që ka ndodhur në burgje.

Më 17 janar 2007, është bërë një kallëzim penal nga Shoqata e të Burgosurve Politikë në Pejë, me të cilin dëshmohej qartë se atje janë vrarë 110 të burgosur shqiptarë, aty është po ashtu një staf prej 32 vetave, të organizuar mirë nga Drejtoria e Burgut, prej drejtorit Aleksandër Rakoçeviqi, Miodrag Lidiqit - Miki, Branko Humadina dhe gjithë stafi që ka qenë aty, me këtë krim që e kanë bërë, me vrasjet e 110 të burgosurve dhe të plagosur me qindra të tjerë, tregon që drejtësia në Kosovë ende nuk është arritur.

Me këtë tregohet që edhe debati që është mbajtur para dy vjetësh, pa një muaj, ende nuk kemi drejtësi dhe drejtësia është selektive. Nuk kemi drejtësi, sepse kërkohet drejtësi për hiçgjë, ndërsa kur e kemi një krim të organizuar, një terror dhe një masakër, drejtësia mbetet në heshtje.

Këtë e ka bërë Serbia, e ka bërë si institucione të organizuara, e ka bërë sistemi dhe ne nuk i akuzojmë serbët që e kanë bërë, por e akuzojmë shtetin serb drejtpërdrejt, sepse të burgosurit dhe burgjet kanë qenë pjesë e institucioneve dhe e shtetit serb. Prandaj, kërkoj që për këtë çështje nga Ministria e Drejtësisë të kemi informata deri ku ka mbërri kjo çështje, a është ngritur kallëzimi dhe a është ngritur akuza drejtpërdrejt, apo jo, dhe çfarë më tutje?

Ne presim me shqetësim. Tash e kemi më 19 maj përvjetorin e masakrës së Dubravës dhe ne ende nuk e dimë çfarë është dhe si do të gjendemi në këtë situatë. Edhe pas dy vjet debati në Kuvendin e Kosovës, në institucionin më të lartë, nuk është ndërmarrë asnjë veprim. Prandaj, edhe një herë kërkoj nga ministri i Drejtësisë të na sjellë informatën se deri ku ka arritur kjo çështje dhe a është ngritur aktakuza, kur dihet se të gjithë personat të cilët janë të akuzuar, edhe pse në kallëzim penal që e ka bërë shoqata, janë punëtorë dhe punojnë nëpër institucionet e Serbisë në Serbi? Faleminderit!

KRYETARI: I fundit për sot, deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Më 1999 është mbyllur kapitulli i përgjakshëm dhe i dhunës së ushtruar deri në këtë kohë, si në Mesjetë, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Por, në vazhdim është kapitulli tjetër, i konotacioneve dhe i vendosjes së marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës së pavarur dhe të Serbisë.

Kjo duhet të bëhet në interes të dy popujve, të popullit të Kosovës dhe të popullit në Serbi. Që këta popuj njëherë e mirë dhe përfundimisht ta mbyllin kapitullin e dhunës, të konflikteve dhe të gjakderdhjes.

Si duket, si edhe në etapa të tjera, edhe në këtë etapë, do të na ndihmojë edhe i madhi Zot. Siç e shihni, tani në etapën e përmbylljes së bisedimeve me ndërhyrjen e Brukselit dhe të ekipit që është emëruar atje, kemi një tërheqje të establishmentit të politikës serbe, e cila aktron, e cila imiton paraardhësit e asaj politike, e cila e ka sjellë këtë gjendje dhe i ka ngrirë këto raporte.

Një qasje konstruktive vërejmë te lidërshipi politik i Kosovës dhe një prezantim të vullnetit çfarë duhet t'i bëjë një elitë përfaqësuese popullit të saj. Në këtë çështje dhe në këtë trajtim shohim edhe qasje nihiliste dhe një mosbesim ndoshta jo krejt real, sa i manifestuar nga vullneti politik për ta krijuar një situatë nebuloze para zhvillimeve politike dhe para shpalosjeve, qëllimeve të cilat nuk i kanë aspak për bazë interesat e këtij vendi dhe qëllimet e këtij populli.

Ne jemi duke dëgjuar edhe oferta të reja nga lidërshipi i Serbisë që nuk janë krejt të reja, sepse në kuzhinat shoviniste të Beogradit janë gatuar ato, por nuk janë bërë programe publike dhe nuk janë shtruar në tryezat diplomatike.

Kapitulli i ndarjes së Kosovës ka qenë synim gjithmonë i politikës së Beogradit. Madje, edhe në etapat më të fundit, kur shihet se gjithçka që quhet Kosovë me 10 877 km katrorë, gjithçka ka marrë fund dhe është një tërësi territoriale e njohur nga afro 100 shtete dhe nga një vendim i Gjykatës së Drejtësisë Ndërkombëtare, e cila është e pakontestueshme se është tërësi territoriale e këtij populli dhe ky popull prej atij momenti kur e ka shpallur të pavarur këtë vend, e ka pasur të drejtën e tij legjitime.

Dhe, kështu...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë janë parashtruar nëntë pyetje parlamentare. Koha është 60 minuta. Prej të gjitha pyetjeve që janë bërë për Kabinetin qeveritar, vetëm një ministër është këtu dhe ne menjëherë shkojmë me pyetjen, që i drejtohet këtij ministrit Nenad Rashiq. Pyetjen e ka bërë deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar kryeparlamentar!

Pyetja ime ka të bëjë me angazhimet e Ministrisë që udhëheq zoti Rashiq apo të Qeverisë së Kosovës, në lidhje me kontributet pensionale të bashkëvendësve tanë, që kanë punuar në Zvicër.

Nga interesimi ynë për të gjetur zgjidhje në këtë problem, pyetja parlamentare që ju kemi bërë më herët, vizita në Ambasadën zvicerane në Kosovë, unë bashkë me zonjën Sahatqija, ani se kemi besuar në etikën zvicerane dhe takimet me qytetarët tanë, që kanë punuar përkohësisht në shtetin e Zvicrës, kemi marrë një letër që prezanton vendimin e Gjykatës Federale Zvicerane, e cila konstaton se gjendja mbetet e njëjtë. Kontributet në të holla të sigurimit invalidor dhe pensional nuk do të dërgohen në Kosovë, pasi nuk ka marrëveshje për sigurime shoqërore ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës.

Pyes ministër, a ishte e lodhshme që të bëhet një marrëveshje e tillë, në të cilën ka tri kushte, të cilat ju sigurisht se i dini mirë dhe do t'i sqaroni këtu para deputetëve, dhe pse nuk është proceduar më tutje që të bëhet zgjidhje për këtë kategori të kontributdhënësve kosovarë në Zvicër, kur dihet që një pjesë e tyre e kanë lënë edhe shëndetin atje, e fatkeqësisht një pjesë e tyre edhe nuk jeton më?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Poštovani zameniče premijera,

Poštovani dame i gospodo narodni poslanici,

Poštovana gospođo Kajtazi,

Zahvaljujem se na pitanju zbog toga što pre svega hoću da vam kažem da od prvog dana, kada smo dobili informaciju o prekidu takozvane saradnje za penzionere sa Kosova, koji su radili u Švajcarskoj, odmah smo reagovali onako kao što i treba preko Švajcarske ambasade, i odmah smo započeli pregovore o stvaranju jednog novog sporazuma, koji bi trebalo da bude bilateralan.

Ali, pre nego što vam kažem detalje, ja moram da napomenem jednu stvar. Absolutno je sigurno da Švajcarska čini jedan ogroman napor da pomogne kosovskom društvu. To kažem ne samo zbog projekata koje su postojali, nego i zbog projekta koji su recimo evo započeli sad pre 20 dana, jedan novi projekat, kojim Švajcarska vlada obezbeđuje 88 miliona franaka za različite projekte. U tom generalnom projektu je uključeno Ministarstvo za rad sa 7,2 miliona. Znači doprinos Švajcarske vlade ni u jednom momentu nije pod znakom pitanja.

Ali od samog početka našeg prekida dogovora, prekida tog sporazuma međunarodnog, ja sam razgovarao i sa gospodinom premijerom. Tražio sam od njega da bude uključen u direktne pregovore na višem nivou. Takođe sam sa gospodinom predsednikom Jakupom Krasnićijem, tražio sastanak gde smo razgovarali o tome kako uticati poslanike Švajcarske, koji su zbog vaše informacije, bili takođe iniciatori ovog jednog prekida memoranduma u Švajcarskom Parlamentu. I ja sam sa gospodinom Krasnićijem insistirao da se na neki način ovaj naš problem podigne na viši nivo, gde mogu biti uključeni i predsednik Parlamenta i predsednik Vlade, da bi mogli brzo da rešimo.

Mi sa naše tehničke strane, kao što sam rekao, od početka je rezultiralo stalnim razgovorima preko Švajcarske ambasade do tog tehničkog tima, koji je tamo napravljen u Švajcarskoj, da se sporazum napravi što pre. Jer smo mi videli u tome samo jedan

tehnički problem, gde mi menjamo ime institucije, odnosno države, koja bi trebala odgovornost i tehničke detalje unutar toga prepravimo.

Mi smo to uradili, i zbog toga je došlo do potpisivanja protokola koji ja, ako dozvolite, kod sebe imam kopiju i u pisanoj formi i takođe odgovor od tih 8 tačaka koje je predviđao protokol, koje smo mi ispunili, da vam takođe pošaljem. Uglavnom ovaj protokol je potpisan 9-og septembra 2010.godine.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë? Urdhëro Lirije, e ke fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit ministër për pak hapa, por nuk janë të mjaftueshëm, ngase ata vazhdojnë të mos i gëzojnë kontributet. Mendoj se duhet një angazhim shumë i shtuar dhe ndihmesë e kryeministrit.

Ambasadorja zvicerane ka shprehur, duke iu referuar vendimeve të Gjykatës Federale atje, ka shprehur shqetësimet e veta se nuk po kryhen çështje shumë të thjeshta, që kanë të bëjnë edhe me regjistrin e këtyre personave të kontributeve. Aq më keq, ka edhe keqpërdorues. A do t'i ndihmoni Qeverisë zvicerane në këtë drejtim, që së paku të mos ketë keqpërdorime, që të ulet edhe serioziteti i kontributdhënësve.

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala još jednom!

Ja moram, evo samo jedan deo odgovora, sve obaveze koje proističu iz potpisanog protokola datuma 2.9.2010.godine, su realizovane od strane institucija Kosova, i potom poslato Švajcarskoj strani. Prilikom dostavljanja dokumenta, koji proizilazi iz protokola švajcarske je učinjen poziv da zvanično posete Kosovo u prvoj polivini, to je bilo 2011.godine, ali do sada nismo imali nijedan odgovor od Švajcarske strane.

Na žalost skraćeno, situacija je takva da mi dve godine nemamo odgovor na ono što tražimo sa tehničke strane, da nam kažu jel dokument u redu. I svaki put kad pitam gospodu ambasadorku sada, ranije gospodina ambasadora, odgovor je bio: ekipa i dalje razmatra naše predloge. A što se tiče ono "keqpërdorimi" što ste rekli, ili zloupotreba, to absolutno bilo nekih prijava da je bilo privatnih indikacija pretnji nekim agentima i osiguravajućih kuća u Švajcarskoj, da je neko navodno pretio, ali verujte to ništa nije dokazano. To je ostalo samo na reči tih agenata, i to opet kažem, to su privatni procesi, privatne tužbe, nisu ni na koji način bili povezani sa Ministarstvom za rad.

Naravno, još jednom kažem, da u svakom momentu smo mi spremni ako to bude sutra, mi tu dokumentaciju već smo poslali, mi imamo naravno i u našoj arhivi, i sve što bude trebalo, mi smo tu.

Opet kažem, nije nikakav tehnički problem, a da li politički, ja to stvarno ne bih ulazio u to, jer kao što rekoh, uključeni su i gospodin premijer i gospodin predsednik, pa

verovatno mislim da smo mi svim snagama uključeni u ovaj problem, samo možda malo nam treba i pozitivna snaga ili pozitivan signal, od druge strane, odnosno od Švajcarske vlade. Hvala!

KRYETARI: Ju lutem, kush dëshiron të bëjë pyetje, e dini që procedurat respektohen. Ju keni të drejtë të pyetjes, ministri ka të drejtë të përgjigjet.

Pyetje tjera i janë parashtruar për ministrin e Arsimit, që nuk është këtu; tri pyetje janë për ministrin e Kulturës, Memli Krasniqi, i cili gjithashtu nuk është këtu, dy pyetje për kryeministrin, nuk është këtu; dhe dy pyetje për ministrin Dardan Gashi, i cili është lajmëruar se nuk do të jetë i pranishëm.

A doni t'i bëni pyetjet? Vazhdojmë! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Buja. Dëshiron ta parashtrosh pyetjen? Urdhëro, e ke fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Pyetja ime që kam për t'ia drejtuar ministrit të Arsimit, zotëri Ramë Buja, nuk e humb aktualitetin, edhe pse, fatkeqësisht, studentët sot presin një përgjigje, kanë pritur ta marrin një përgjigje direkte nga ministri. Unë propozoj që kjo pyetje të bartet në seancën tjetër.

KRYETARI: Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Memli Krasniqi. Do ta lexosh pyetjen deputet? Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Është seanca e tretë kjo në të cilën i parashtroj pyetje ministrit të Kulturës, Memli Krasniqi. Shpresoj që kjo të mos jetë arsyeja e mungesës së tij në këto tri seanca. E transferoj pyetjen për seancën e radhës, me kusht që herën tjetër ta lexojmë.

KRYETARI: Përsëri Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Memli Krasniqi.

BEKIM HAXHIU: Njëjtë sikur me pyetjen tjetër, e transferojmë për seancën e radhës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Lirije Kajtazi, pyetje për ministrin Memli Krasniqi. E pret ministrin? Mirë, faleminderit! Deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete, e ke fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Gjermania është njëra nga vendet lidere të Bashkimit Evropian, e cila veçanërisht nën udhëheqjen e kancelares Merkel, në bashkëpunim me Bundestagun, e ka kushtëzuar Serbinë në proceset e saj të integritetit, ndërmjet tjerash edhe me shpërbërjen e strukturave ilegale në veri të Kosovës.

Vetë Kosova ka hyrë në procesin e bisedimeve pa kushte, gjë që do të thotë se Gjermania ka qëndrime shumë më të avancuara për interesin shtetëror të Kosovës se vetë kryeministri i Kosovës.

Duke i mirëpritur këto qëndrime të Gjermanisë, ne nuk po shohim se kryeministri Thaçi po e zhvillon ndonjë raport të veçantë me këtë shtet, apo po e avancon bashkëpunimin. Një mënyrë e avancimit të bashkëpunimit do të ishte vizita në këtë shtet dhe takimi me krerët e lartë të shtetit gjerman.

Prandaj, pyetja ime për kryeministrin është: Përse ai nuk e ka zhvilluar asnjë vizitë zyrtare me krerët shtetërorë në Gjermani, në mënyrë që ta avancojë bashkëpunimin dhe koordinimin në fushën e diplomacisë, por edhe në fushat tjera, siç është ekonomia, arsimi e tjera? A ka ndonjë pengesë specifike në lidhje me këtë dhe çfarë ka bërë kryeministri për ta eliminuar?

Unë kërkoj që qytetarët e Kosovës ta shohin nivelin e llogaridhënies së kryeministrit dhe të ministrave të tij, të cilët në kohën e pyetjeve parlamentare nuk vijnë në seancë. Në rast se nuk e jep përgjigjen, radhën tjetër do ta japim vetë ne. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për kryeministrin. Deputete, dëshiron ta parashtrosh pyetjen?

KYMETE BYTYÇI: Po e ruaj pyetjen për seancën e radhës.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Vazhdojmë! Deputetja Justina Shiroka- Pula, pyetje për ministrin Dardan Gashi. Ministri nuk është këtu. Deputetja, do ta lexosh pyetjen?

JUSTINA SHIROKA-PULA: Duke parë që ministrat nuk kanë kohë, unë do ta lexoj pyetjen, e përgjigjen me siguri do ta japë ai në ndonjë mbledhje, apo në formë të shkruar.

Përkundër të gjitha apeleve të shumta të ekspertëve dhe institucioneve, praktika e djegies së gomave, mbeturinave, sidomos në prag të festave, si dhe keqmenaxhimi i mbeturinave të automjeteve të hedhura skaj rrugëve, po shkaktojnë, jo vetëm pamje të keqe, por ndotje dhe helmim të tokës.

Pyetja për ministrin është: Pse nuk po zbatohet Udhëzimi administrativ nr. 02/2009 për administrimin e automjeteve të hedhura, si dhe vendimi i Qeverisë për mirëmbajtjen e këtyre mbeturinave?

KRYETARI: Mirë! Deputete, lexoje edhe pyetjen tjetër.

JUSTINA SHIROKA-PULA: Gjendja e lumenjve dhe shtretërve të tyre është degraduar mjaft gjatë viteve të fundit. Për këtë gjendje po kontribuojnë edhe operatorët, që veprojnë në kundërshtim me ligjin, si dhe me vendimin e Qeverisë të vitit 2012, e cila është në fuqi.

Pyetje për ministrin është: Çka është duke ndërmarrë ministria për vetëdijesimin e qytetarëve për mosshkatërrimin e shtretërve dhe lumenjve të Kosovës dhe sa janë duke u realizuar projektet për rehabilitimin e lumenjve? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Këtu edhe kanë përfunduar pyetjet e deputetëve. Pyetjet e deputetëve, që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit, neni 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit. Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kisha propozuar që në orën 12:00 ta bëjmë një pauzë, sepse është një akademi përkujtimore për Agim Ramadanin dhe në këtë akademi përkujtimore e nderojmë Parlamentin, nderohemi vetë dhe e madhështojmë atë ceremoni nëse marrim pjesë të gjithë deputetët. Ju lus, ta keni këtë në konsideratë! Faleminderit!

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 28 dhe 29 mars dhe 4 prill 2013

TEUTA SAHATQIJA: Mendoj që është pika e tretë, te procesverbali, sepse pikërisht te procesverbali kam vërejtje. Po, pikërisht aty e kam një vërejtje. Është pika numër 11 e rendit të ditës të datës 28 mars, formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar, me kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së, mbështetur edhe nga deputetë tjerë. Dhe, në vazhdim është fjala juaj, kryetar, ku e lexoni kërkesën tonë, e lexoni vetëm titullin, vetëm pjesën e parë. Ndërsa, në vazhdim në paragrafin e dytë, domethënë në faqen 11 thuhet: Fjala e Ismet Beqirit, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar. Ai e propozoi deputetin Muhamet Mustafa për anëtar dhe kryesues, e të tjera...

Por, mendoj që vendimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar është bazuar vetëm në paragrafin e parë apo në fjalën e juaj dhe nuk e ka paraqitur edhe pjesën tjetër, në të cilën zoti Ismet Beqiri e tregon arsyetimin. Mendoj që në vendimin, i cili ka dalë prej kësaj pike, duhet të shtohet edhe pjesa e arsyetimit, e cila është në procesverbal, ashtu që vendimi të jetë i plotë, sepse në këtë mënyrë vetëm me paragrafin e parë, vendimi është i cunguar.

Prandaj, kërkoj që vendimi të bazohet në procesverbal dhe të shtohet arsyetimi, në mënyrë që të jetë komplet. Faleminderit!

KRYETARI: Vendimi ka dalë mbi bazën e kërkesës. Dhe, kërkesën ju e dini si e keni parashtruar. Debati është përqendruar kryesisht në faturimin për shpenzime të rrymës elektrike për muajin janar 2013. Ka qenë e precizuar.

Dhe, natyrisht, ne e kemi lexuar rendin e ditës dhe miratimin e kërkesës sipas rendit të ditës. Kurrfarë ndryshimi nuk i kam bërë. Por, i gjithë debati është kërkuar me kërkesën tuaj për shpenzimet dhe faturat e rrymës elektrike për muajin janar 2013.

Nuk ka qenë më e zgjeruar kërkesa që e keni bërë. Dhe, nga kjo është përgatitur edhe procesverbali i datave të përmendura dhe i çështjes së përmendur.

Komisioni le ta kryejë punën. Nëse duhen kërkesa tjera, le ta bëjë kërkesën. Nëse nuk ju mjafton hapësira që është dhënë me vendim, le të kërkojë zgjerim të kompetencave. Fjalën e ka Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Mendoj që ajo kërkesa për zgjerim të kompetencave mund të jetë si opsioni numër 2, të cilin edhe mund ta konsiderojmë, por në rend të parë mendoj që vendimi do të duhej që të ishte pasqyrim i saktë i kërkesës. Ajo e cila është pasqyruar në vendim është vetëm titulli, ndërsa po e lexoj prej kërkesës, në bazë të së cilës është formuar komisioni, thuhet në vazhdim në faqen e dytë: “Duke pasur parasysh se faturat e fryra të janarit janë ndikuar nga rritja e paralajmëruar e çmimit të energjisë elektrike, vendosja e njehsorëve digjitalë, edhe pas privatizimit të Distribucionit, privatizim i cili në raportet ndërkombëtare konstatohet se nuk është bërë në përputhje me praktikat më të mira, as në përputhje me ligjet ndërkombëtare”. E katërta është: “Kapacitetet e pamjaftueshme menaxhuese të KEK-ut dhe MZHE-së, mungesa e kapaciteteve të reja energjetike të Kosovës, mungesa e linjës së interkonjeksionit 400-kilovoltësh”, dhe në fund thuhet “Implementimi i strategjisë energjike, 2008-2018”. Ne nuk po kërkojmë asgjë më shumë seç është e shkruar dhe për të cilën është votuar ky Komision Parlamentar Hetimor.

Prandaj, kryetar, ju kisha lutur që vendimi i cili është marrë në bazë të këtyre fjalëve, në bazë të të cilit është formuar komisioni, vetëm të plotësohet, në mënyrë që të mos kemi nevojë që të bëjmë kërkesa shtesë. Vetëm të jetë konform kërkesës, për të cilën është votuar ky komision.

KRYETARI: Çka përmban vendimi, unë po e lexoj: Themelohet Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me:

- faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013.
- kohën e llogaritjes sipas tarifës së lirë,
- njehsorët digjitalë dhe masat e ndërmarra në lidhje me këtë rast,

Privatizimi nuk e di që ka qenë çështje e kërkesës, por edhe një herë po them, nëse Komisioni i merr çështjet, bën kërkesë për zgjerim dhe kjo mund të kuptohet edhe nga stenogrami i seancës. Sigurisht që do të jepet vendimi tjetër për zgjerim të kompetencave. Unë mendoj që nuk do të ketë problem. Po, Administrata në bazë të kërkesës e ka përgatitur këtë vendim.

Urdhëro, kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Një gjë duhet ta kemi të qartë. Ky komision është formuar, jo mbi bazën e debatit, por është formuar me 40 nënshkrime. Dhe, unë e mbështes çfarë thotë zonja Sahatqija, në mënyrë të qartë 40 nënshkrimet të kërkesa dhe arsyetimi shkruajnë se çfarë bën ky komision. Shumë qartë shkruan.

Edhe një herë po e përsëris: vendimi për formimin e komisionit është marrë në bazë të kërkesës, arsyetimit dhe 40 nënshkrimeve.

Herën e parë, komisioni ad hoc nuk është votuar. Ju e dini këtë. Prandaj, komisioni i ka kompetencat e plota për të punuar konform kërkesës dhe arsyetimit dhe 40 nënshkrimeve dhe nuk mund ta ketë të limituar punën e vet, ose punën e tij si komision vetëm në atë që thuhet në titull, sepse edhe një herë po e them: Shikoni, kjo është kërkesa, arsyetimi dhe i kam 40 nënshkrime, mbi bazën e të cilave është formuar komisioni.

Nuk ka asnjë nevojë për të bërë kërkesë të re, për t'ua shtuar kompetencat. Ata i kanë këto kompetenca për të gjitha këto çështje që t'i bisedojnë, t'i analizojnë, t'i kontaktojnë njerëzit dhe kjo po ashtu është lexuar edhe në transkript.

Prandaj, është shumë e qartë që janë kompetencat e qarta dhe vendimi mund të jetë i tillë çfarë është, por se çfarë mund të bëjë dhe duhet të bëjë ky komision, shkruan në kërkesën, në arsyetimin dhe 40 nënshkrimet, mbi bazën e të cilave është formuar komisioni.

Ndërkaq, ajo që thuhet në procesverbal, për herën e parë ad hoc s'ka kaluar dhe ka mundur të gjendet arsyetimi, por për të tretën, për të katërtën herë po e përsëris, komisioni është formuar mbi bazën e kërkesës, arsyetimit dhe 40 nënshkrimeve, ku shkruan qartë se çfarë duhet të bëjë ky komision, cila është fushëveprimtaria e tij. Kaq! Faleminderit!

KRYETARI: Shikoni, ne duhet ta shikojmë ligjin, mbi bazën e të cilit formohet komisioni.

Komisioni nuk formohet mbi bazën e arsyetimit. Shikojeni ligjin! Komisioni formohet mbi bazën e diapozitivit dhe kërkesës. Dhe, ajo i përmban kështu siç është bërë vendimi. Po, edhe një herë po them, ligji ia jep mundësinë e zgjerimit të kompetencave dhe nëse ka nevojë komisioni t'i zgjerohen kompetenca, e bën kërkesën edhe i zgjerojmë.

Më duket, jam shumë i qartë. Nuk e kam problem, pse të mos hetohet, por problemi është që ne e kemi një ligj dhe të gjitha procedurat duhet t'i vazhdojmë mbi bazën e ligjit. Lexojeni ligjin dhe do të bindeni.

Fadil Demaku e ka fjalën.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë veç dua të jap si sqarim, pasi jam emëruar anëtar i Komisionit Hetimor Parlamentar. Ne e kemi pasur një mbledhje të parë si Komision Hetimor Parlamentar dhe, natyrisht, çështja siç po del tani ka dalë edhe pas asaj mbledhjeje, sepse në mbledhjen e parë të Komisionit Hetimor Parlamentar, ne një grup deputetësh, sidomos deputetët që janë nga radhët e Partisë Demokratike, kemi kërkuar që të punojmë në bazë të vendimit, që na ka

ardhur nga Kryesia e Kuvendit, me nënshkrimin e kryetarit të Kuvendit dhe gjithë puna jonë, si Komision Hetimor Parlamentar, do të fokusohet në atë çështje.

Dhe, aty pastaj ishte bërë edhe një propozim i planit të veprimit të punës së Komisionit Hetimor Parlamentar, gjë që ishte në shprehje totale me vendimin që kishte ardhur nga Kryesia e Kuvendit dhe ne nuk pajtoheshim në asnjë mënyrë, që projekti i planit të veprimit të punës së Komisionit Hetimor Parlamentar ishte në shprehje dhe ishte tepër i zgjeruar në raport me vendimin që e kishim ne, se ku do të fokusohemi si Komision Hetimor Parlamentar.

Dhe, ne kemi kërkuar për të qenë i qartë edhe përpara jush këtu, edhe përpara opinionit, kemi thënë që nëse ky vendim mbetet kështu, ky plan i veprimit duhet të jetë në përputhje të plotë me vendimin. Nëse ndryshohet vendimi, atëherë ne mund të diskutojmë për këtë plan të veprimit, që na ka ardhur në mbledhjen e parë.

KRYETARI: Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Edhe një herë po e përsëris, edhe ne dëshirojmë të punojmë në bazë të ligjit, dispozitës, siç e thoni edhe ju. Ne e kemi të qartë, që kur të nxirret vendimi për çka punohet, nuk është thënë edhe arsyetimi, se pse duhet të punohet për atë pikë. Dhe, në arsyetimin tonë, ju shikojeni procesverbalin, thuhet shumë qartë që Ismet Beqiri në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar.

Dhe, ato i keni sigurisht në transkript. Edhe një herë po e them, zoti kryetar, Komisioni për Hetim Parlamentar është formuar, jo mbi bazën e debatit, po është formuar me 40 nënshkrime, me kërkesën dhe arsyetimin tonë.

Po, nuk ka më shqip! Unë s'di a duhet t'ia përkthej dikujt se çfarë shkruan këtu. Se çfarë thotë tash pozita, është shumë e qartë, sepse po ta donin komisionin, e kishin bërë ad hoc dhe nuk do të kishte nevojë të shkohet tutje. Po, pikërisht problemi ka qenë se s'kanë dëshiruar të formohet komision dhe jemi detyruar të bëjmë Komision Hetimor. Prandaj, mos i ngatërroni!

Komisioni Hetimor është bërë mbi bazën e kërkesës, arsyetimit, që ia ka përcaktuar edhe fushëveprimtarinë në këtë rast komisionit, dhe i mbështetur me 40 nënshkrime, e jo mbi bazën e debatit. Mbi bazën e debatit ka qenë kërkesë për tjetër komision, ad hoc, dhe s'ka kaluar.

Prandaj, mos e komplikoni! Po kush është ai i cili na pengon si komision që të veprojmë në bazë të kësaj çfarë shkruan në kërkesën dhe në arsyetimin tonë, që është votuar. Nuk është votuar të themi veç ky titull, zoti kryetar, po kërkesa jonë realisht për Komision Hetimor. Përmbajtja është votuar. Edhe këto 40 nënshkrime e kanë dhënë këtë si rezultat, por jo mbi bazën e debatit, sepse ai ka qenë në tjetër seancë, e nuk ka kaluar.

Prandaj, nuk mund të ngushtohet, të thuhet veç për këtë titull, po ai deri te ajo çfarë ka ndodhur rreth faturave, kanë sjellë këto probleme, prandaj edhe këto duhet debatuar. Nuk mund t'i thuash veç jepma një faturë ta bisedoj, qysh është puna e kësaj fature, po janë shumë punë tjera, që i paraprijnë kësaj. Dhe, kush është ai që mund t'ia pengojë këtij komisioni një të dejtë që e ka fituar me 40 nënshkrime.

Dhe, realisht, në fund edhe është votuar. Është joserioze të thuhet këta s'kanë të drejtë të diskutojnë, të interesohet se po shkruan në titullin e vendimit. Po kurrkund vendimet nuk bëhen me shumë çështje që duhet biseduar. Vendimi është vendim. Realisht, ky ka mundur të plotësohet, sepse këtu në procesverbal thuhet qartë se unë e kam arsyetuar, edhe kërkesën, edhe e kam arsyetuar pse kërkesa.

Prandaj, në kërkesën tonë, urdhëroni shikojeni në transkript, i keni edhe arsyetimet. Dhe, nuk mund të hiqen nga e drejta jonë e këtij komisioni këto arsyeime që i kemi dhënë dhe kjo e drejtë që të hetohet në këtë mënyrë. Edhe të intervistohet çdonjëri që ka të bëjë me këtë çështje. Fundi i fundit, kë e pengon që të bëhet kjo punë? Ne nuk po themi që dikush është i involvuar në këtë punë, po komisioni le ta vlerësojë. Pse të mos e bëjë këtë punë?

(Ndërhyrje)

Le ta vlerësojë procesin, por çka është pengesë të vlerësohen në bazë të arsyetimit që e kemi. Prandaj, zoti kryetar, është shumë e qartë dhe unë ju lus që komisioni të veprojë konform kërkesës, arsyetimit dhe vendimit të këtij Kuvendi, i mbështetur me 40 nënshkrime. S'ka asnjë shans t'i ngushtohet vushëveprimtaria, të merret veç me një titull të vendimit. Po kjo është qesharake! Mos luani me vendimet e Kuvendit dhe me votën e deputetëve dhe të 40 nënshkruesve.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYETARI: Mirë! Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Meqë jam anëtare e Komisionit Hetimor, dëshiroj t'i them edhe unë disa fjalë.

Realisht ka shpërputhje ndërmjet fushëveprimtarisë, të cilën e keni caktuar në vendim dhe fushëveprimtari të kërkesës së Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ju, kryetar, e përmendët edhe Ligjin për formimin e Komisionit Hetimor, mirëpo ligji nuk e përcakton fushëveprimtarinë e Komisionit Hetimor. Andaj, ajo ta përcakton mënyrën e formimit të kompetencave, por jo edhe fushëveprimin.

Në këtë rast, do të ishte mirë që vendimi juaj të zgjerohet sa u përket kompetencave, të jetë në përputhje me kërkesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës, përndryshe ne jemi të kufizuar në mandat, si Komision Hetimor.

KRYETARI: Vendimi, ju lutem, është i plotë. Ju po e lexoni veç një pikë, e tjerat s'po i lexoni. E keni pikën 3 të vendimit:

Komisioni Hetimor Parlamentar në pajtim me Ligjin për hetim parlamentar duhet ta hetojë çështjen e ngritur dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin përfundimtar në afat prej 2 muajve nga dita e themelimit.

Pra, përveç këtij vendimi, pika 3 thotë: Komisioni Hetimor Parlamentar në pajtim me Ligjin për hetimin parlamentar duhet ta hetojë çështjen e ngritur dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin përfundimtar në afat prej 2 muajsh. Unë mendoj që komisioni të punojë në pajtim me ligjin dhe nuk kemi diçka të paqartë.

Urdhëro! Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, Visar Ymeri.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse jam edhe nënshkrues i kësaj kërkesë dhe anëtar i komisionit, është e qartë që vendimi nuk i përmban të gjitha pikat që janë të shtruara në kërkesë dhe pajtohem plotësisht me kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së, që Komisioni Hetimor bëhet në bazë të kërkesës dhe arsytimit, që është ngritur aty. Pra, këto pika të arsytimit, ose të ngritjes së dyshimit të bazuar si faktorë, që kanë mundur të kenë ndikim në çmimet dhe llogaritjet e faturave të janarit, janë pikat të cilat janë mbështetur nga 40 deputetë dhe si të tilla duhet të hetohen.

Çështja e dytë është që e dëgjuam edhe nga deputetët e pozitës, anëtarë të komisionit, por edhe që kemi dëgjuar në komision, në atë mbledhjen që u përmend, është në fakt që në njëfarë mënyre kërkohet që Komisionit Hetimor t'i pamundësohet hetimi.

Pra, ne e kemi thënë edhe aty, edhe në planin e punës, që është paraqitur nga kryetari i komisionit, dhe në arsytimet shtesë, që ne na nevojitet që ta zgjerojmë hetimin. Pra, t'i marrim parasysh të gjithë faktorët e mundshëm të kenë ndikuar në këtë dhe pastaj të vlerësojmë nëse kanë pasur ndikim apo jo. Të gjitha çështjet që janë përmendur në arsytim.

Pra, nuk është që po mendojmë apriori që kanë ndikim, është që duhet t'i trajtojmë si faktorë të mundshëm që kanë ndikuar. Ndërkohë, që refuzimi që të merremi me këtë çështje, është refuzim apriori thua se këta e dinë, deputetët që po e refuzojnë, që këtu nuk kanë pasur ndikim në këto fatura të janarit.

Pra, në këtë mënyrë pamundësohet edhe hetimi për këto fatura të janarit dhe duhet ta kemi parasysh që Komisioni Hetimor është për ta hetuar tërë atë që po ndodh në sektorin e energjisë, karshi përcaktimit të çmimit të energjisë dhe pastaj karshi faturave të fryra apo jo të fryra, që kanë ardhur në muajin e janarit, për shkak se kemi arsytimet e institucioneve, sikur të Korporatës Energjetike të Kosovës, po ashtu edhe të Zyrës së Rregullatorit, që në fakt ka mundur të jetë fatura e janarit edhe si rrjedhojë e keqkalkulimeve, por jo në të gjitha rastet, për shkak se çmimi i janarit është më i lartë, meqenëse çmimi i energjisë elektrike është ngritur në qershor, apo jo? Tash, ne duhet ta dimë se çka e ngriti çmimin e energjisë elektrike në qershor, se kjo është pjesë e çmimit dhe e faturave të shtrenjta për të cilat qytetarët kanë kërkuar që të hetohen.

Prandaj, në këtë drejtim unë mendoj që dokumenti valid i vetëm edhe sipas ligjit në këtë Komision Hetimor është ai dokument që është nënshkruar nga 40 deputetë. Pra, ne e dimë që Komisioni Hetimor me 40 deputetë, pra me 1/3-ën e deputetëve e krijojnë drejtpërdrejt ata deputetë dhe nuk kërkohet votimi në seancë. Dhe, rrjedhimisht, krijohet në bazë të kërkesës që ata e kanë nënshkruar. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, ju lutem! Nuk ka nevojë për të folur shumë. Nuk ka nevojë për replikë. Nuk jemi duke bërë debat. Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit edhe një herë.

Mendoj se këtu ka ardhur deri te një moskuptim, apo te një qasje e ndryshme e njerëzve, e cila nëse nuk sqarohet që nga fillimi, do ta politizojë punën e këtij komisioni dhe do ta dëmtojë.

Prandaj, mendoj se është e dobishme që sot po diskutojmë dhe ta zgjidhim këtë problem.

Sigurisht që komisioni është ngritur në bazë të kërkesës së LDK-së dhe deputetëve tjerë. Në atë komision ka një titull, por në faqen e dytë thuhet se duke pasur parasysh se faturat e fryra të janarit janë të ndikuara nga... domethënë, është një qëndrim i atyre që e kanë formuar komisionin dhe një dyshim, se faturat janë ndikuar nga këta faktorë: rritja e paralajmëruar, vendosja e njehsorëve pas privatizimit, privatizimi, e tjera...

Domethënë, këtu është çështja që të verifikohet, jo privatizimi si proces dhe nuk dëshiroj që këtu të keqkuptohemi. Privatizimi është një proces që është kryer. Por, mënyra e zbatimit të privatizimit dhe sa kjo mënyrë e zbatimit të privatizimit po ndikon në ngritjen e çmimeve.

Mendoj se është në interes jo vetëm që është kjo kërkesë, por është në interes që ky Kuvend dhe kjo shoqëri me kohë t'i precizojnë këto punë rreth zbatimit të privatizimit, që të mos befasonemi me konflikte të mëvonshme, siç ka ndodhur në vende tjera.

Prandaj, është e dobishme që kjo të rregullohet. Unë e kam bërë një projekt të planit të punës, duke u bazuar në këtë kërkesë, se nuk e kam pasur vendimin. Më vonë ka dalë vendimi. Me të vërtetë, ne erdhëm me mendime të ndryshme, sepse vendimi ishte më restriktiv dhe nuk thirrej në kërkesë dhe në arsyetim.

Prandaj, ndoshta duhet të korrigjohet vendimi, të harmonizohet me këtë kërkesë, ose duhet të sqarohet puna, për arsye se ne kemi pengesë në punën e komisionit. Unë dëshiroj që aq sa mund, të jemi objektivë në punën e këtij komisioni, të punojmë në mënyrë konstruktive, t'i evitojmë konfliktet politike brenda, sepse nëse ato vazhdojnë do të kemi hendikep që nga fillimi. Faleminderit!

KRYETARI: Shikoni! Jo, nuk ka më fjalë! Unë edhe një herë dua të sqaroj.

Vendimi ka dalë mbi çështjen që është kërkuar dhe çështja që është kërkuar është kjo: Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me

- faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013.
- Koha e llogaritjes sipas tarifës së lirë,
- Njehsorët digjitalë dhe
- Masat e marra në lidhje me këtë rast.

Tjetër, vendimi është ngritur mbi këtë bazë. Por, pika 3 e vendimit thotë: Komisioni Hetimor Parlamentar, në pajtim me Ligjin për hetimin parlamentar duhet ta hetojë çështjen e ngritur dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin përfundimtar në afat prej 2 muajve, nga dita e themelimit.

Neni 6. për mandatin e Komisionit shkruan, pika 1: Çështja e cila është përcaktuar në pajtim për hetimin parlamentar, me vendim nga Kuvendi, mund të ndryshohet ose të zgjerohet me vendim të Kuvendit më vonë nëse propozuesi për iniciimin e Komisionit është pajtuar me ndryshimin. Unë mendoj që ju keni të drejtë ta bëni këtë dhe të veprohet sipas ligjit. Veprimi sipas ligjit mendoj që nuk e kufizon punën e Komisionit. Veç po e ndërlikoni kot.

Ramiz! Unë jam i bindur se as ti e as Fadili nuk mund të mendoni më mirë se këta që e kanë bërë ligjin. Jo, të mos hajgare tash. Urdhëro, Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Krejt është problemi i fushëveprimit të Komisionit, sepse profesori e ka bërë një plan të veprimit, që të kërkohej listat e privatizimit të KEK-ut, jo për atë që e ka formuar Komisionin. Edhe, kryetar, nëse dëshiron të t’i lexoj krejt listat që kanë kërkuar këta për t’i shqyrtuar, unë po t’i lexoj. Këtu kërkohej privatizimi i KEK-ut, e jo për atë që është formuar Komisioni. Ne u kemi thënë merreni mandatin e seancës, ne edhe privatizimin e hetojmë. Nuk ka asgjë të keqe, por përderisa nuk e kemi atë mandat, nuk do ta hartojmë atë punë. Kjo është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro, Sabri Hamiti! Ju lutem, kërkojeni fjalën kush do ta sqarojë këtë çështje. Ligji e sqaron më së miri.

SABRI HAMITI: Zotëri, po e shoh të nevojshme që sa më qartë duhet t’i them dy fjalë për këtë problem. Së pari, me Kushtetutë dhe me Rregullore dihet që Komisioni Hetimor detyrimisht formohet në Kuvend, pa e pyetur Kuvendin, kalon formalisht kur i ka 40 nënshkrime. Tash këtu është një shtyrje - qysh është formulimi. Është e vërtetë që çështja: në kërkesën e këtij ekipi prej 40 të nënshkruarave shkruan në formulim, njëfarë fjalie e gjatë, e cila në vendim është kthyer në pikën 1 dhe i ka do viza, kishe veprimtari të ndara. Unë mendoj që kjo mund të bëhet pa komplikime të mëdha, të thuhet: Krejt këto çka i kemi njehur prej të parës të fundit, me shtojcën: “shkaqet dhe pasojat”. Ky Komision Hetimor, nëse nuk thuhet kështu, atëherë mund të shkon deri në pakufi, njëri thotë kjo është themelore, kjo nuk është themelore. Pse po e them këtë, zotëri kryetar? Po e them se Komisioni është shumë më i komplikuar që të kërkohej dhe të votohet në Kuvend. Mos i ktheni njerëzit t’i mbledhin edhe një herë 40 firma e ta bëjnë formulimin, se nuk është logjike. E ajo bëhet. Pas dy ditëve t’i mbledh prapë 40 firma, e shkruan pak

a shumë këtë dhe pranohet. Nuk kemi nevojë t'i komplikojmë gjërat. Le të hetohen edhe shkaqet, edhe pasojat. Pikë! Nëse është mirë të thuhet 'shumë mirë është', nëse është keq të thuhet 'është keq'.

KRYETARI. Urdhëro Fadil Demaku, por nuk keni çfarë të thoni më tepër se që thotë ligji.

FADIL DEMAU: Faleminderit, kryetar!

Unë desha që të jem edhe një herë i qartë. Unë i kuptoj qëllimet politike, edhe të zotit Beqiri, edhe të zotit Ymeri, por nuk dua të manipulohet me të vërtetën.

Tendenca që para opinionit të prezantohet se disa deputetë nga pozita nuk kanë dashur që ky Komision Hetimor Parlamentar ta vazhdojë punën këtu, po del sot. Dua të jem i qartë, ne kemi kërkuar që të gjithë anëtarët e Komisionit Hetimor të punojnë në përputhje me vendimin që ka dalë nga Kryesia, me nënshkrimin e kryetarit të Kuvendit, dhe nëse dalim jashtë atij vendimi jemi jashtë mandatit tonë. Ne u kemi thënë në Komision Hetimor Parlamentar. Aty janë edhe transkriptet. Kemi thënë që nëse ndryshon vendimi, jemi në rregull. Ne nuk jemi apriori për asnjë çështje që ta ndalojmë, por mandati i Komisionit Hetimor Parlamentar është i qartë në vendim, ndërsa në planin e veprimit që na është proceduar ishte krejt diçka tjetër dhe ne kemi kërkuar që ose të ndryshohet vendimi, ose ai plan veprimi që na është ofruar nuk mund të zbatohet, sepse ne bëjmë shkelje ligjore. Kjo ka qenë çështja.

KRYETARI: Jo, jo! Unë edhe një herë po ju lexoj, se mendoj se kjo që e tha nënkryetari Sabri Hamiti është në vendim. Unë po ju lexoj edhe një herë të gjitha pikat e vendimit. Kot po e ndërlikoni çështjen. Vendimi është i saktë dhe hapësira e Komisionit nuk është e kufizuar.

(Reagime nga salla)

Po, me vendim nuk është e kufizuar, por unë ju lexoj përsëri vendimin. Dëgjoni, vendimi e thotë shumë qartë.

V E N D I M

Pika një:

1. Themelohet Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013. Koha e llogaritjes sipas tarifës së lirë. Njësoret digjitalë dhe masat e ndërmarra lidhur me këtë rast, që do të thotë janë shkaqet.

Vetëm kush do ta kufizojë hapësirën e Komisionit, përndryshe vendimi nuk e kufizon punën e Komisionit, e këtë nuk e kufizon as ligji.

Kurse pika 3 e thotë shumë mirë: Komisioni Hetimor Parlamentar, në pajtim me Ligjin për hetimin parlamentar, duhet ta hetojë çështjen e ngritur dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime. Unë nuk di çka ka këtu për të ngritur.

(Reagime nga salla)

Me këto sqarime, shkojmë në miratimin e procesverbalit. Kush është për? Kundër? Nuk ka. Pra, miratohet procesverbali. Dhe veprimi i Komisionit Hetimor sipas ligjit dhe vendimit.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për turizmin

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për turizmin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti, që ta arsyetoj raportin me rekomandime. Nuk është. Vazhdojmë.

Në këtë projektligj janë propozuar 25 amendamente.
Të pranishëm 67 deputetë.

Amendamenti 1.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e miratojmë Ligjin në tërësi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Prani fizike 67, me elektronikë 98, bile 99 janë. Votojmë tash!

Me 50 vota për, 7 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për turizmin.

Mirë unë gabova për një, por edhe ashtu ligji është i miratuar.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, nr. 03/L-181 për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut edhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit nuk është këtu. Vazhdojmë. Janë gjithsej 12 amendamente. Votojmë!

Amendamenti 1,

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e miratojmë Ligjin në tërësi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Të pranishëm 69 deputetë, me elektronikë 98. Votojmë tash!

Me 68 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin nr. 03/L-181 për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut.

Në radhë është pika e gjashtë:

6. Debat parlamentar lidhur me statusin e pazgjidhur të punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së dhe rekomandimeve të komisioneve parlamentare

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, në bazë të nenit 15, pika 8 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar debat parlamentar lidhur me statusin e pazgjedhur të punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti 1990 deri në vitin 1999.

Gjithashtu, edhe mësimdhënësit shqiptarë të sistemit arsimor të Kosovës kanë parashtruar kërkesë në Kuvend për pranimin e stazhit dhe zgjidhjen e statusit të tyre për periudhën 1990-1999. Lidhur me këtë, Kryesia e Kuvendit e ka ngarkuar Komisionin për Arsim dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut që ta shqyrtojnë kërkesën e mësimdhënësve dhe Kuvendit ia paraqesin raportin me rekomandime.

Komisioni për Arsim dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut e kanë shqyrtuar kërkesën e mësimdhënësve dhe Kuvendit i kanë parashtruar rekomandimet lidhur me këtë çështje. Meqë materia e dy kërkesave të lartcekura është e njëjtë, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur me 8 prill 2013, ka vendosur që kjo çështje të përfshihet në një pikë për seancën e caktuar për më 11 prill 2013.

Fjala është për deputetin Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, në cilësinë e propozuesit të çështjes.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të dashur mësimdhënës të viteve të '90-ta,

Është nder i veçantë për mua, Lidhjen Demokratike të Kosovës, besoj thellë të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, qytetarët e Kosovës, që sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës kemi debat parlamentar për arsimin shqip të viteve të '90-ta, debat për punën e madhe, kolosale, të armatës së tërë të arsimtarëve tanë, prindërve, nxënësve të atyre viteve, të vuajtjes, dhimbjes, sakrificës, por edhe nderit, krenarisë, viteve ekzistenciale dhe historike, të arsimit shqip në veçanti e popullit tonë, në përgjithësi. Sigurisht duhet kohë e gjatë për ta përshkruar se çfarë ndodhi, si u organizuam në mbijetesën e arsimit shqip, por për libra e fakte historike kanë filluar të merren historianë, njerëz dhe bartës të atyre proceseve, është shkruar, po shkruhet dhe do të shkruhet shumë.

Po mbrohen dhe do të mbrohen edhe tema magistraturash e doktoraturash. Organizimi dhe veprimi aktiv për rezistencë kolektive dhe institucionale kundër pushtetit okupues të Serbisë dhe për ta bërë shtet Kosovën në harmoni me dëshirën e popullit që nga viti 1990-1999 ka qenë veprimtaria dhe puna e mësimdhënësve dhe e të punësuarve tjerë në lëmin e arsimit dhe të edukimit, me të cilin organizim e ruajtën kontinuitetin e shkollës shqipe dhe e krijuan sistemin e pavarur arsimor.

Qysh në vitin 1990, mësimdhënësit dhe veprimtarët tjerë të arsimit, organeve të instaluar të Serbisë në Kosovë me gojë dhe me shkrim u thanë: “JO, nuk do të punojmë me ligje dhe planprograme mësimore të shtetit serb, por do të punojmë me ligje dhe planprograme mësimore të Republikës së Kosovës”. Dhe, për ta thyer këtë vendosmëri, policia dhe shërbimi sekret serb mori me orë dhe me ditë tëra në të ashtuquajtura biseda informative mbi 90% të mësimdhënësve, burgosi dhe rrahu shumë prej tyre, e që sot e ato ditë kanë probleme shëndetësore. Nxjerrja e mësuesve me dhunë nga ora mësimore dhe dërgimi i tyre në stacionet policore nën përcjellje të personave të armatosur dhe kërcënimin fizik dhe tyre, megjithatë ata nuk u dorëzuan dhe nuk nënshkruan deklarata të tilla nënshtruese.

Për veprimtarinë e tyre në arsimin e pavarur shqip shumë mësimdhënës dhe veprimtarë të arsimit ishin dënuar për kundërvajtje me të holla, që në vitin shkollor 1990/91. Në fillim në shënjestër të dënimeve ishin të gjithë mësuesit e klasave të para dhe të pesta të shkollave fillore dhe të gjithë veprimtarët e drejtorët shqiptarë të shkollave, të cilët janë dënuar me të holla kinse për kundërvajtje, por edhe me burg për vepra penale për rezistencë kundër shtrirjes së pushtetit serb në arsimin shqiptar. Por, gjatë aksioneve famëkeqe policore pati edhe mbytje e vrasje, siç ishte rasti i drejtorit të shkollës fillore “Bajram Curri” në Strellc, Haki Povataj, që vdiq nga dhuna policore e ushtruar ndaj tij, në stacionin e policisë në Deçan, më 21 korrik 1992, por ai nuk pranoi të deklarojë se i pranon këto planprograme të Serbisë. Policia, përveç mësimdhënësve, rrihte, burgoste, por edhe vriste edhe nxënës dhe studentë dhe prind, siç ishte vrasja e tre prindërve në Uçë të Istogut, më 31 janar 1992.

Pushteti serb, duke vërejtur se dhuna, dënimet me para, burgje, rrahja dhe vrasjet nuk po jepnin rezultate për jetësimin e legjislacionit asimilues serb në shkollat shqipe, vendosi masat e dhunshme në shkolla, duke emëruar drejtorë serbë në shkolla shqipe, të sjellë

edhe nga Serbia, duke ndërprerë financimin e tërësishëm të arsimit shqiptar nga 1 shtatori, përkatësisht 31 dhjetori 1990 dhe që nga viti shkollor 1991/92 nuk lejoi organizimin e mësimi shqip në objektet shkollore për shkollimin e mesëm dhe të lartë në tërësi, kurse pjesërisht edhe për arsimin fillor. Këto masa represive të Serbisë nuk e thyen vendosmërinë e mësimdhënësve shqiptarë për mospranimin e legjislacionit serb në arsimin shqip në Kosovë dhe kjo vendosmëri ishte kthyer në rezistencë të organizuar kolektive.

Të nderuar deputetë,

Gjendja e krijuar në arsimin shqip i mobilizoi qytetarët e Kosovës, mësimdhënësit, në atë kohë partinë e vetme realisht politike, Lidhjen Demokratike të Kosovës, institucionet e Republikës së Kosovës, të dala nga zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992.

Pa dyshim që presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova dhe LDK-ja ishin bartësit e këtij organizimi të shkëlqyeshëm me një armatë të tërë njerëzish. Në fillim, puna edhe pa pagesë, e më vonë formimi i Këshillit për Financim në nivel qendror, pastaj këshillat komunale në të gjitha komunat e Kosovës, bënë që arsimtarët tanë, qoftë edhe simbolikisht të paguheshin dhe atë nga Buxheti i Qeverisë së Kosovës, që vepronte në ekzil, para këto të mbledhura nga kontributet e qytetarëve tanë anembanë botës.

Organizimi dhe puna institucionale e shkollave shqipe është bërë në harmoni me Deklaratën Kushtetuese, përkatësisht Kushtetutën e Republikës së Kosovës të 7 shtatorit 1990, në bazë të të cilave akte juridike ishin nxjerrë dekretligjet për arsimin fillor e të mesëm dhe për arsimin e lartë, me të cilat ishte krijuar baza ligjore për nxjerrjen e akteve tjera nënligjore, si të planprogrameve mësimore dhe të rregullativës tjetër për punën institucionale të shkollave në kushte të okupimit klasik. Rregullativa e përpiluar dhe e zbatuar në sistemin e pavarur arsimor shqiptar ka qenë shumë funksionale dhe zbatohet nga institucionet arsimore me përpikëri.

Planprogramet dhe tekstet mësimore për lëndët gjuhësore, shoqërore dhe humanitare, për disa shkallë të arsimit edhe nga matematika që nga viti shkollor 1994/95 ishin të përbashkëta me Republikën e Shqipërisë.

Në këtë periudhë janë shqipëruar emrat e shkollave dhe dokumentacioni shkollor: dëftesat dhe diplomat janë lëshuar me preambulë të Republikës së Kosovës, gjithashtu me shqiponjën dykrenore, të cilat dokumente pa hezitim i pranojnë të gjitha shtetet perëndimore, që besonin në të drejtën dhe drejtësinë tonë. Puna e shkollave shqipe ishte nxitëse për internacionalizimin, përkatësisht interesimin e shteteve të mëdha për zgjidhjen e statusit juridik të Kosovës.

Bisedat e para shqiptaro-serbe nën ndërmjetësimin e ndërkombëtarëve janë zhvilluar pikërisht për arsimin.

Në shtator të vitit 1991, sistemi arsimor shqiptar u pezullua. Në shtëpi private hasim klasë

me 40 nxënës, të cilët i mëson mësuesit, arsimtarë e profesorët që nuk paguheshin nga. Në burg gjendeshin në atë kohë në fillim 50 arsimtarë e nxënës. Përkundër vështirësive të mëdha, në Kosovë u organizua procesi mësimor, ku u përfshinë mbi 320 mijë nxënës në arsimin fillor, mbi 65 mijë në arsimin e mesëm, mbi 25 mijë studentë, realisht mbi 400 mijë veta ishin në procesin mësimor, mbi 22 mijë arsimtarë - profesorë punonin me këta nxënës, me këta studentë.

Mësimdhënësit rreth dy vjet punuan pa paga, kurse nga 1 prilli 1992 morën pagë nga 20 DM në atë kohë në muaj, e cila pagë në vitin 1998 e arriti shumën 150 DM, por për çudi sot nuk u pranohet stazhi i punës i asaj kohe, krahasuar me atë të para viteve të '90-ta. Kështu me rastin e pensionimit stazhi po u pranohet vetëm atyre që kanë punuar së paku 15 vjet në organizatat e ish-Jugosllavisë ose Serbisë, prandaj me rastin e pensionimit, shumica e mësimdhënësve e marrin vetëm pensionin e pleqërisë, nga 50 euro në muaj, në vend që ta marrin pensionin nacional, të cilin e meritojnë.

Meqenëse forcat policore serbe nuk lejonin organizimin e mësimi shqip në objekte shkollore, atëherë mësimdhënësit tanë të nderuar që nga 20 janari i vitit 1992, do të thotë për nëntë vjet shkollore mësimin e organizuan në shtëpi private, në shtëpi të lëshuara nga qytetarët, njerëz zemërgjerë në shumë dhe të gjitha pjesët e Kosovës, në lagjet e qytetet tona, që edhe sot meritojnë çdo respekt ata njerëz që kanë rrezikuar çdo gjë, edhe ekzistencën e tyre fizike për arsimin shqip.

Organizimi i mësimi, përkatësisht i punës së institucioneve arsimore në kushte të tilla të represionit mund të them që ka qenë unikat dhe e ka mahnitur botën demokratike. Këtë konstatim e vërtetojnë edhe deklaratimet e shumë delegacioneve që në atë kohë vinin në Kosovë.

Po i përmendi shkurt vetëm disa: “Ju përgëzojmë për organizimin, ju do ta fitoni lirinë”, thuhet nga një delegacion që ishte nga OSBE-ja e atëhershme, që quhej Këshilli Evropian për bashkëpunim dhe siguri, ose Luis Ramajo, që ishte kryetar i UNESCO-s, gjatë vizitës më 6 maj 1993 në Kosovë kishte deklaruar: “Atë që po e bëjnë arsimtarët shqiptarë në Kosovë, është vetë UNESCO”.

Për organizimin e mësimi në shqip në shtëpi-shkolla, gazetarja angleze Melani Fred në gazetën “Gardian”, në prill të vitit 1992, shkruan: “Rejhanja, një arsimtare, në një dhomë të ljer në të bardhë, para 29 nxënësve, mban mësimin. Nxënësit e ulur në dysheme. Një stufë tradicionale ngroh paksa, por aty nuk ka banka, nuk ka karrige, nxënësit i ndajnë librat ndërmjet vete. Në një dhomë të një shtëpie tjetër mësojnë 39 nxënës të ulur në dysheme, të veshur blu-xhins, pranë këmbëve të mësuesit të tyre, i cili flet mbi heroin shqiptar Skënderbeun”...

KRYESUESI: Kryerje, kryeje fjalën!

ISEMET BEQIRI: Faleminderit! Unë ju kërkoj falje edhe ju deputetë të nderuar, ndoshta është pak gjatë, por vërtet mendoj që e meritojnë këta arsimtarë tanë të nderuar. Prandaj,

“nxënësit gjatë orës së mësimi në mes tjerash thoshin: “Kosova është e jona dhe duam pavarësi dhe paqe”.

Ndërkaq Melani, një gazetare tjetër e “Tajms”, shkruante: “Ka njerëz në Britani që do të jepnin pothuaj gjithçka për atë lloj arsimit si në Kosovë”. Mësimi megjithatë ka çmim dhe çmimi është se sistemi arsimor i shqiptarëve për pushtetin serb është i paligjshëm. Arsimitarët rreheshin nga policia vetëm pse mbajnë mësim, kurse prindërit pse përpiqeshin t’i fusnin fëmijët e tyre në lokalet shkollore.

Të nderuar kolegë deputetë,

Zotëri Majkëll Salla, një profesor i Universitetit kombëtar australian, në Kamëra të Australisë thotë: “Intervenimi pa dhunë në konfliktet brendashtetërore”, më lejon ta citoj këtë, që për ne është e rëndësishme, e thotë ai australian: “Ajo që më së shumti më impresionon në Kosovë është sistemi edukativ, të cilin e kanë organizuar shqiptarët. Ky sistem përfshin 276 000 nxënës të shkollave fillore, 60 000 nxënës të shkollave të mesme dhe mbi 20 000 studentë. Ky sistem i pavarur arsimor shqiptar doli si një përgjigje ndaj përpjekjeve të Serbisë për ta aplikuar planprogramin e tyre për shkollat shqiptare”.

Të nderuar kolegë deputetë,

Me një fjali që e thotë profesori i nderuar, e që është domethënëse edhe për ne është shumë e rëndësishme ta them.

“Vazhdimi i funksionimit të institucioneve arsimore konsiderohet si dëshmi se baza institucionale për Republikën e Kosovës ekziston, është e qartë, është e vullnetshme dhe e realizueshme.

Puna institucionale e shkollave i parapriu organizimit të veprimtarive tjera shëndetësore, të sportit, kulturës, shkencës, jetës financiare e të tjera. Shkollat shqipe ishin të vetmet institucione, të cilat me punën e tyre i konkretizuan kërkesat për të drejtën e qytetarëve tanë për shtet të pavarur.

Sigurisht, të nderuar deputetë, trajtim të veçantë ligjor më vonë do të duhej bërë edhe për punëtorët shëndetësorë, mjekët, motrat medicinale, përkatësisht organizimin tonë shëndetësor në Republikën e Kosovës, sepse edhe ata ishin pjesë e rezistencës kolektive ndaj pushtuesit serb.

Puna e shkollave në kushte të okupimit e parandaloi eksodin masiv të popullit shqiptar të Kosovës për në shtetet e Perëndimit, sepse mësimdhënësit me punën e tyre dhanë forcë dhe motiv për jetë Kosovës. Kështu, për shembull, sa nuk punuan shkollat prej 1 shtatorit 1991 deri më 20 janar 1992, për në shtetet e Evropës Perëndimore, sipas një vlerësimi u shpërngulën mbi 18 mijë nxënës dhe mbi 1 mijë arsimtarë, kurse me nisjen e punës së shkollave ky eksod gati ra në normalitet.

Po të mos kishin punuar shkollat në atë dhjetëvjeçar, atëherë, pas çlirimit, në qershor 1999 në klasën e parë, kolegë të nderuar deputetë, të fillores do të uleshin bashkë një 7-

vjeçar dhe një 17-vjeçar dhe popullatën do ta kaplonte analfabetizmi dhe çrregullimet e mëdha jetësore do të ishin me pasoja katastrofale.

Veprimtaria e arsimit krijoi edhe terren të volitshëm për krijimin dhe veprimin e UÇK-së, në radhët e së cilës u rreshtuan shumë nxënës, studentë, mësimdhënës, e me qindra ranë edhe në fushat e betejave.

Mësimdhënësit dhe veprimtarët e arsimit 1990-1999 në mënyrë direkte dhe indirekte kanë udhëhequr mbi një milion qytetarë të Kosovës, po të numëroheshin nxënësit, studentët dhe familjet e tyre.

Pjesë e sistemit arsimor të viteve të '90-ta, më lejoni ta them edhe këtë, kanë qenë edhe deputetë të nderuar, edhe ata që sot nuk janë në mesin tonë. Unë po i përmendi vetëm dy, duke mos më keqkuptuar të tjerët, kryetari i Parlamentit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi, ka qenë mësimdhënës, zëvendësdyrëtor shkollë, kryetar i Këshillit Komunal të Financimit në komunën e Gllogocit, deputet i Parlamentit të vitit 1992; akademik Sabri Hamiti ka qenë profesor universitar, mes tjerash përpilues planprogramesh e teksteve të përbashkëta Kosovë-Shqipëri dhe deputet i të gjitha legjislativave që nga viti 1992 e këtej. Sigurisht që edhe shumë të tjerë që nuk janë këtu janë pjesë e kësaj pune, duke përfshirë profesor Bajramin dhe shumë të tjerë, edhe profesor Muhametin. Thashë, më falni, se dalin shumë, edhe të mos them studentë, nxënës të tjerë. E di që e kam mirëkuptimin tuaj që të mos i them emrat e të gjithëve, sepse jeni pjesë e kësaj rrite dhe i këtij zhvillimi të arsimit shqip.

Të nderuar deputetë

Te mësimdhënësit e asaj periudhe ka lindur me drejte dyshimi se organet legjislative të Republikës së Kosovës nuk e pranojnë validitetin e arsimit, përkatësisht sistemit arsimor të asaj kohe, sepse po ta kishin pranuar do ta kishin njohur përvojën e tyre të punës dhe punën e atyre arsimtarëve do ta shpërblenin në mënyrë të dinjitetshme e nuk do t'i lënin në gjendjen çfarë i kanë lënë.

Të nderuar deputetë

Më lejoni, para se t'i lexoj rekomandimet, zoti kryesues, vetëm t'i falënderoj edhe një herë të gjithë ata arsimtarë, qytetarë të Kosovës, pronarë të shtëpive shkolla, institucionet e atëhershme të Republikës të Kosovës, të udhëhequra nga presidenti Rugova, t'i falënderoj nga zemra që nuk na lanë analfabet, që na e shtuan shpresën për jetë, na mobilizuan e frymëzuan dhe së bashku mbijetuan falë punës së tyre dhe veprës madhore, falë luftës së UÇK-së dhe ndihmës se aleatëve tanë, sigurisht sot jemi këtu ku jemi.

Në fund do t'i lexoj tri rekomandime që i kemi për Kuvendin e Republikës së Kosovës:

1. Të nxirret ligji i veçantë për statusin e punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, në bazë të të cilit statusi i tyre barazohet me statusin e personave të merituar në formimin dhe ndërtimin e shtetit të Republikës së Kosovës.

2. Ky ligj të përfshijë, në mes tjerash, rregullimin e statusit të mësimdhënësve, personelit udhëheqës dhe personelit tjetër të punësuar në shkolla-universitet, të punësuarve në sekretariatet-këshilla komunale të arsimit, entet pedagogjike komunale dhe republikane, si dhe në Ministrinë e Arsimit të Republikës së Kosovës, të punësuarve në këshillat e financimit, të pronarëve shtëpi-shkolla dhe

3. Qeveria e Republikës së Kosovës të jetë bartëse e hartimit të këtij ligji në afatin kohor prej tre muajsh dhe ta sjellë për miratim këtë ligj në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Duke qenë i bindur se këto janë rekomandime realisht të të gjithë deputetëve, sepse të gjithë jemi pjesë e këtyre zhvillimeve, unë ju lus dhe në fund të debatit, zoti kryesues, shpresoj dhe besoj dhe ju lus që t'i votojmë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Unë besoj që për të gjitha rekomandimet të gjithë janë dakord. Sidoqoftë, lista e diskutuesve është shumë e gjatë. Besoj se të gjithë janë paraqitur. Në qoftë se vazhdojmë të diskutojmë gjatë, se e di që secili ka interes që të zgjidhet ky problem dhe të gjithë jemi të interesuar që ta zgjidhim. Mirë është t'i kufizojmë diskutimet sa më shumë dhe kryetarët e grupeve parlamentare ndoshta kanë çka flasin më shumë se të tjerët. Fjala është e zotit Idriz Vehapi, kryetar i Komisionit për Arsim.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit, Të nderuar deputetë, Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 20 mars 2013, e shqyrtoi përfundimin e Kryesisë, me numër 04/P-140 të datës 4 mars 2013, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R E K O M A N D I M

- T'u njihet përvoja e punës mësimdhënësve dhe personelit të punësuar në arsim shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.

Në Komision ka pasur debat dhe të gjithë anëtarët e Komisionit janë pajtuar njëzëri që të rekomandohet kjo, sepse është një fakt i cili ka ndodhur dhe mësimdhënësit e kësaj periudhe e meritojnë këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Suzan Novobërdaliu, kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut.

SUZANA NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues! Natyrisht se e përkrahim këtë iniciativë të LDK-së dhe rekomandimet e propozuara.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, Arsim Bajrami është në radhë.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Nuk ka dilemë që ky debat që sot po e bëjmë është një respekt për një periudhë mjaft të ndritur të historisë sonë dhe ne po i bëjmë respekt gjithë asaj armate të profesorëve të popullit, të studentëve, të nxënësve që mbijetuan në një periudhë, kur Kosovës i përgatitej gjenocidi. Nuk ka dilemë që periudha '90, '98, e '99 është një periudhë kur populli u homogjenizua nëpërmjet shkollës, nëpërmjet arsimit dhe arsimit e tregoi vitalitetin e mbijetesës në kushtet kur popullit të Kosovës i kanosej një shfarosje dhe kurdo që shkruhet në mënyrë neutrale historia e re e Kosovës nga historianët realë, kjo është një periudhë shumë e ndritur, një periudhë kur shkolla e mbijetoi dhunën dhe kur populli u homogjenizua, u bashkua, gjë që nuk kishte vetëm efekte edukative dhe arsimore, por kishte edhe efekte politike, sepse u homogjenizua në idenë e Republikës së Kosovës, në idenë e një shteti të ardhshëm, i cili po lindte.

Të nderuar kolegë,

Me këtë rast duhet t'i rikujtojmë dhe të shprehim si Kuvend falënderimin e gjithë asaj armate të popullit që e ndihmoi arsimin, që i hapi shkollat, që hapi universitetet, por në mënyrë të veçantë falënderimi shkon për një armatë të mësimdhënësve, profesorëve, studentëve, nxënësve, të cilët mbijetuan në kushte, duke i organizuar shkollat. Unë nuk do ta quaj arsim paralel, sepse ne në fjalorin tonë politik bëjmë shpeshherë gabime të pafalshme, duke e quajtur atë periudhë të veprimit paralel, thuaja se veprimi okupues ka qenë veprim legjitim. Ajo nuk ka qenë një periudhë e arsimit paralel, por e arsimit legjitim të persekutuar nga objektet shkollore.

Jo rrallë herë i dëgjojmë politikanët tanë duke bërë gabime të pafalshme duke e quajtur periudhë e veprimit paralel, thuajse populli është pajtuar me okupimin serb, thuaja se okupimi serb ka qenë legjitim. Mendoj se pikërisht organizimi i arsimit në atë kohë, ai arsim që ne e kemi mbajtur mbi supe, ka qenë arsim legjitim, kurse shkollat tona kanë qenë të okupuara dhe aftësi ynë ka qenë i persekutuar dhe i bartur në shkollat shqipe.

Të nderuar kolegë,

Me këtë rast, duhet ta kujtojmë patjetër faktin se mbijetesa e Universitetit të Prishtinës, duke qenë edhe vetë një nga protagonistët e kësaj mbijetese dhe udhëheqës në këtë periudhë, ka qenë, jo vetëm një mbijetese e një universiteti, por ka qenë edhe një trampolinë mbi të cilën është ndërtuar ideja e rezistencës aktive, ideja e një rezistence të armatosur, ideja e përfundimit të këtij gjenocidi dhe nga kjo ka dalë edhe lëvizja çlirimtare, ka dalë Ushtria Çlirimtare e Kosovës pikërisht nga gjenerata e artë e studentëve, e cila më pastaj edhe e ndërroi historinë e re politike të Kosovës.

Përpjekjet titanike që i ka bërë ish-rektori Statovci duke implementuar, ndoshta i vetmi apo me pak segmente idenë e Republikës së Kosovës nëpërmjet legjislacionit të Republikës së Kosovës, është shembulli më i mirë i sakrificës së intelektualit për kauzën kombëtare.

Të nderuar kolegë,

Dhe Rektori Statovci, në vitin '92, e miratoi dekretligjin për arsimin e lartë dhe i homogjenizoi studentët në idenë e Republikës së Kosovës dhe studentët e asaj gjenerate u bënë një forcë motorike, e cila e shtyri procesin politik dhe e cila e krijoi bazamentin e një rezistence të armatosur, e cila kulminoi me luftë çlirimtare.

Si profesor i asaj kohe, mund të them që më shumë ka pasur përgjegjësi, rregullsi dhe rregull në atë kohë, kur ne kemi qenë të okupuar, kemi punuar në shkolla pa drita, në shkolla me qirinj, sesa ndoshta sot nëpër kolegjet private dhe në universitetet tona. Do të thotë ka pasur një lloj vetëpërmbytje, ka pasur një moral te profesorët, te studentët, që nuk po bëjnë vetëm një veprimtari akademike dhe mësimore, por edhe një kontribut drejt një kauze kombëtare dhe për herë të parë profesorët dhe studentët u bënë bashkë dhe praktikisht e sfiduan edhe armikun, edhe mbijetesën, dhe Lëvizja studentore e viteve të '90-ta ishte një lëvizje historike, e cila mund të krahasohet me të gjitha lëvizjet që e kanë ndërtuar histori politike të vendit.

Me këtë rast, unë i pashë rekomandimet që i ka propozuar Grupi i LDK-së. Ato rekomandime duhet të përkrahen pa kurrfarë dileme, por unë do ta shtoj edhe një rekomandim. Çfarë ne po bëjmë ne me këtë debat? Ne po e rikujtojmë kujtesën tonë të një periudhe shumë të artë të popullit tonë. Ne po kërkojmë më tepër satisfaksion moral për këta njerëz, sesa satisfaksion material, sepse stazhi i punës te ne nuk paguhet, por është me rëndësi që Kuvendi i Kosovës dhe një ligj i veçantë ta njohë këtë punë, ta njohë stazhin e punës, ta njohë kontributin në mënyrë që vërtet të eliminohen nganjëherë të gjitha ato gënjeshtra se në atë kohë vetëm është e improvizuar me mësim, apo vetëm është mbajtur mësimi i ashtuquajtur paralel.

Të nderuar kolegë,

Ka ekzistuar një armatë, zoti Beqiri i përmendi dy-tre persona, por ne nëse nisim t'i përmendim, është një armatë e njerëzve. Merita më e madhe për mbijetesën e arsimit i shkon popullit, u shkon atyre që i liruan objektet familjare për shkolla, u shkon në mënyrë të veçantë atyre që s'janë sot në mesin tonë. Kështu që unë, përpos rekomandimeve, në kapacitetin personal, jo në emër të Grupit Parlamentar, do të propozoja që t'ia japim edhe një rekomandim Presidentes së Republikës së Kosovës, që në kuadër të autorizimeve të saj kushtetuese për kontributin dhe për mbijetesën e arsimit në mësim dhe vetëm për mbijetesën në arsim në të gjitha nivelet ta dekorojë në mënyrë të veçantë akademik Gazmend Zajmin, që ka qenë akademik dhe rektor në periudhën e vitit 1981 dhe ndër intelektualët e paktë që i ka përkrahur atëherë kërkesat e drejta të studentëve. Ndoshta për mua kjo është pak edhe emocionale, sepse asokohe kam qenë asistent i profesorit, rektorin historik të Kosovës, doktor Ejup Statovcin, për kontributin e veçantë në mbrojtjen e Universitetit të Prishtinës dhe në funksionalizmin e legjislacionit në Republikën e Kosovës, që është një rast i rrallë kur një universitet bëhet shembull se si duhet të mbrohet përcaktimi për Republikën e Kosovës dhe Kushtetuta e Kaçanikut dhe Deklarata Kushtetuese të 2 korrikut, akademik Fehmi Agani, një nga shtyllat e inteligjencës dhe shtylla e arsimit kosovar, akademik Eshref Ademaj, një nga personalitetet kryesore që e mbajti gjallë organizimin sindikal të profesorëve dhe asistentëve, profesorin Ukshin Hoti, profesorin e nderuar dhe të respektuar, i cili

fatkeqësisht disa herë u dëbua padrejhtësisht nga Universiteti, u dëbua pikërisht për shkak të qëndrimeve politike intelektuale dhe kombëtare, duke qenë ndër të rrallët - bashkë me profesor Zajmin, që u vu në mbrojtje të studentëve pikërisht në kohën kur shumica e profesorëve i diferenconin studentët. Pastaj, profesorin e ndjerë Bardhyl Çausi, dhe së fundi edhe akademikun e ndjerë, zotin Ali Podrimja.

Disa prej këtyre janë dekoruar nga Presidenca. Janë dekoruar për aktivitete tjera, edhe kombëtare, por në qoftë se ne dëshirojmë si Parlament të lëmë gjurmë në këtë periudhë, atëherë së paku figurat emblematike, sepse edhe thuhet në rekomandimin e LDK-së për personat që kanë qenë në pozita udhëheqëse. Nuk po i përmendim tash rektorët e gjallë, por po mendoj për personalitetet dhe në mënyrë të veçantë për kontributin në arsimin fillor e të mesëm, zoti Shaban Jashari, që është pishtar i arsimit në zonën e Drenicës, pastaj mësuesi Halit Geci, vrasja e të cilit u bë shkas për masivizimin e plotë të UÇK-së dhe pa dyshim zotin Xhavit Ahmeti, i cili e ka mbajtur gjallë organizimin e edukimit dhe arsimit shqip.

Tash sigurisht me këtë propozim që është personal, unë mund t'u hyj në hak shumë njerëzve, që ndoshta janë edhe më të merituar, por ne duhet t'i dekorojmë këta njerëz për kontribut, sepse kontributi i tyre në atë kohë, në kohën e mbijetesës, ka qenë po aq i njëjtë sa kontributi i shumë njerëzve që pastaj e ndërtuan historinë e re politike të Kosovës dhe ne nuk guxojmë ta shlyejmë kujtesën dhe kontributi më i madh i këtij Kuvendi do të ishte që jo vetëm të miratohet ky ligj, po këto figura ta marrin një satisfaksion, një mirënjohje shtetërore e morale për tërë sakrificën që ata e kanë bërë.

Nëse e shohim sot, gjendja e arsimit është krejt në një situatë dhe në një kontekst tjetër, edhe real, edhe akademik.

Unë mendoj se ka ardhur koha që sidomos arsimi i lartë, nuk po flas për arsimin fillor dhe të mesëm, tani t'i kthehet vërtet arsimit dhe edukimit dhe të lirohet nga komponenti politik, që e ka pasur nga e '68-ta, sepse Universitetit nga '68-ta e deri te shpallja e pavarësisë i është imponuar edhe misioni politik, misioni i rezistencës, i mospajtimit, apo misioni i çuarjes së proceseve përpara. Tani është koha që arsimi t'i kthehet misionit të vërtetë, edukimit me standarde evropiane, dhe jo sot, por një ditë do të diskutoj edhe për disa dukuri shqetësuese në arsimin e lartë, ku seriozisht po rrezikohen standardet në kolegjet private, por edhe në shumë universitete publike që po hapim për t'u mundësuar njerëzve qasje në arsim të lartë.

Ne duhet ta kemi një program të mbrojtjes së standardeve kombëtare në arsimin e lartë, sepse jemi deklaruar si pretendent për të hyrë në zonën evropiane të arsimit të lartë, në proceset e Bolonjës, por fatkeqësisht nuk kemi standarde kombëtare të arsimit të lartë.

Fatkeqësisht kemi pengesa brenda subjekteve të arsimit të lartë, kështu që duke e kujtuar me pietet kontributin e gjithë njerëzve që kanë kontribuar në periudhën '90, '98, '99, ne kemi obligim në kushtet e lirisë, në kushtet e shtetit tonë të ndërtojmë një arsim me vlera, një arsim evropian, një arsim konkurrent që do t'i mundësojë Kosovës dhe të rinjve tanë

që të integrohen brenda Bashkimit Evropian dhe brenda zonës evropiane të arsimit të lartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar punëtorë të arsimit që jeni sot këtu të pranishëm, dhe ju që na ndiqni nëpërmjet mjeteve të informimit, në qoftë se ka transmetim të drejtpërdrejtë, Zhvillimi i arsimit në Kosovë, në veçanti deri në ditët e sotme, ka kaluar nëpër kohë të ndryshme, të rënda, të cilat karakterizohen me specifikat e natyrës politike, ekonomike, historike, sociale e tjerë, e tjerë.

Ndër periudhat e ndryshme më të veçanta është ajo e dekadës së fundit të shekullit XX, e në veçanti vitet 1989-1999. Pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1989, Serbia me forma të ndryshme juridike policore filloi ta rrënojë totalisht sistemin arsimor në të gjitha nivelet, prej atij parashkollor deri te ai universitar.

Po atë vit, administrata shtetërore e Serbisë i hoqi drejtorët shqiptarë nëpër shkolla dhe i zëvendësoi ata me të dhunshmit. I futi masat e dhunshme në institucionet edukativo-arsimore dhe filloi dëbimin e nxënësve nga objektet shkollore.

Krahas kësaj, filloi vrasja, burgosja, ndjekjet penale, arrestimet, kërcënimet dhe presionet më të rënda, si dhe ndërprerja e financimit në të gjitha nivelet.

Duke u gjendur para një sfide të tillë, të rëndë, faktori politik i asaj kohe, i përkrahur nga populli i Kosovës, brenda dhe jashtë, e filloi mobilizimin për t'u organizuar për ndërtimin e një sistemi të pavarur të arsimit, që do të thotë organizimin e vetëfinancimit. Financimi bëhej nga puna vullnetare dhe ndihmat që e jepnin Diaspora dhe popullata shqiptare, të cilat këtë sistem e shihnin si hapin e parë të shtetësisë së Kosovës.

Filloi ndryshimi i plan-programeve, botimi i teksteve mësimore, organizimi i mësimi në shtëpi- shkolla dhe masat tjera.

Andaj, shkollat e fakultetet nuk ishin më streha e foleja e nxënësve, e studentëve dhe mësuesve - profesorëve shqiptarë. Këtë fole e zëvendësuan shtëpitë.

Sakrificën që e kanë bërë punëtorët e arsimit nuk e ka bërë askush në Kosovë, përveç luftëtarëve që falë gjakut të tyre ne jemi të lirë. Punëtorët e arsimit vunë themelet e para të shtetësisë së Kosovës dhe ajo periudhë u ujit me lot e gjak, ashtu siç do të thoshte shkrimtari Artur Graf - arsimi është një bimë kryeneqe, e cila nuk gjelbëron, e as që lidh kokërr, në qoftë se nuk ujitet me lot e gjak.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Vezët e gështenjat në prushin e tangarit të parët ia kanë futur serbit arsimtarët shqiptarë. Pra, pushkën e parë kundër pushtuesve serbë e kanë bërë mësuesit tanë.

Në vend se sot të debatojmë në këtë seancë dhe ta kemi një seancë solemne dhe të jemi mirënjohës për ata punëtorë që e kanë dhënë gjithë këtë kontribut për një dekadë, ne sot debatojmë që t'u njihet përvoja e punës punëtorëve të arsimit gjatë viteve në fjalë.

Unë kam menduar që sot do të jetë i pranishëm edhe ministri këtu, por fatkeqësisht, si shumë herë të tjera, si shumë debate të tjera, bëhen pa praninë e qeveritarëve.

Andaj, unë do t'i bëja pyetje zotit ministrit, por së pari do ta lexoj një vendim, që është nxjerrë në vitin 2008.

“Miratohet iniciativa që t'u njihet stazhi i punës të gjithë mësimitdhënësve, stafit administrativ dhe teknik në institucionet arsimore, të cilët kanë punuar në periudhën që nga 1990 deri në 1999. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që t'i fillojë përgatitjet ligjore dhe ta hartojë një raport detaj lidhur me numrin e mësimitdhënësve që kanë punuar në këtë kohë në institucionet shkollore të Kosovës. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”.

Andaj, a është hartuar ky raport detaj lidhur me numrin e mësimitdhënësve që kanë punuar në këtë kohë në institucionet shkollore? Në çfarë baze duhet t'i kesh 15 vjet pune para '99-tës për t'u njohur kjo përvojë? Këta fanarë të arsimit meritojnë shumë më shumë se kaq. Ata do të duhej të kishin edhe benificione të tjera, si shumë kategori të tjera të vendit.

Këtë fushë të rëndësishme të zhvillimit, ndër më të rëndësishmet, po e përcjellin defekte të shumta dhe mendoj se do të kishte vlerë që ne së shpejti ta ngremë edhe një debat tjetër pikërisht për arsimin, por për arsimin prej viteve 2000 e këtej, sepse kemi defekte të shumta, si në cilësinë e arsimit, infrastrukturën shkollore, kontratat e punës që janë të shumëllojshme bazuar në komuna të ndryshme, se disa komuna kanë kontrata njëvjeçare, disa kanë më shumëvjeçare, e kështu me radhë.

Unë, zotëri sekretar, do të ta jap këtë vendim të vitit 2008, të nënshkruar nga kryeministri i atëhershëm, i cili edhe sot është kryeministër, sepse po të nënshkruhej nga ndonjë ministër nuk do të ishte shumë çudi që të mos ia respektonte ministri pasardhës, mirëpo kryeministri i atij viti dhe i sotmi është i njëjti që e ka nxjerrë këtë vendim, dhe kjo Ministri nuk e zbaton vendimin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Debati që po diskutojmë sot prek njërën nga çështjet më fundamentale të shoqërisë shqiptare në Kosovë.

Ky diskutim për organizimin e shkollës shqipe gjatë viteve të '90-ta, si dhe njohja e përvojës së punës së mësimdhënësve shqiptarë gjatë asaj kohe përbën njërin nga çështjet me kyçe të historisë sonë të re.

Është e ditur se tani edhe 14 vjet pas luftës, mësimdhënësit e pensionuar e marrin vetëm pensionin bazë, ose ndihmë sociale nga institucionet, e nuk u llogariten si vite pune ato vite të vështira, kur nën shtypjen më të egër mbërritën ta mbajnë gjallë arsimin shqip. Pajtohem se, edhe pse ekziston një vendim i Qeverisë së Kosovës për njohjen e këtyre viteve si stazh pune, vendimi 2/20 i majit të vitit 2008, ai nuk po gjen ende zbatim. Pra, ashtu si shumë vendime të kësaj Qeverie, që lidhen me këtë sferë, edhe ky vendim ka mbetur vetëm në vazhden e deklaratave mediale e për konsum historik.

Ndërkaq është e ditur në anën tjetër draftligji për pensionet nuk e specifikon njohjen e viteve të punës gjatë '90-'99. Neni 8, pika 1.2, thotë se të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat që kanë së paku 15 vjet stazh pensional para datës 1.1.1999, prej të cilave 7 vjet e 7 muaj duhet të kenë stazh pune në Kosovë, por këtu nuk thuhet që hyjnë edhe vitet e punës në vitet '90. Pos tjerash, në bazë të këtij përkufizimi, të drejtë pensioni do të mund të kenë njësoj edhe policët serbë që kanë rrahur në atë kohë.

Se skema pensionale në Kosovë është tërësisht e çoroditur, kjo nuk është tanimë ndonjë risi. Edhe se është tmerrësisht e fragmentuar në mënyrë që të mbytet organizimi, po ashtu nuk është ndonjë risi. Se gjeneratat që kanë kontribuar në të kaluarën janë të anashkaluara nga sistemi aktual pensional, edhe kjo nuk është ndonjë risi. Pra, të gjitha këto janë thënë, e ndoshta edhe stërthënë.

Por, ajo çka ka mbetur e paproblematizuar në 13 vjetët e fundit - është trajtimi i atyre që kanë punuar në arsim gjatë viteve 1991-1999. Të gjithë këtyre mësimdhënësve këto vite punë nuk u llogariten në kalkulimin që bëhet për pension.

Kështu sot e kësaj dite ka mbetur pa mbështetje institucionale dhe ligjore pikërisht ajo shtresë që ka qenë ndër më meritoret në rezistencën e organizuar politike kundër pushtimit të Kosovës nga Milosheviqi dhe në refuzimin e sistemit të tij shtypës mbi shqiptarët e Kosovës.

Prandaj, ne pajtohemi plotësisht edhe me vizionin e kryetarit të SBASHK-ut se këto vite të punës duhet të njihen në mënyrë që mësimdhënësit ta kenë një pensionim të dinjitetshëm dhe të mos paguhen si vite të zakonshme, por të ketë pagesë të favorizuar, pasi ato vite kanë qenë vite të rezistencës së tyre dhe duhet të paguhen dyfish.

Gjatë kësaj përpjekjeje për ta mbajtur gjallë shkollën shqipe edhe gjatë atyre viteve të vështira, shumë mësues, arsimtarë e profesorë shqiptarë janë përndjekur, rrahur e torturuar nga pushtuesi serb për këtë veprimtari. Me shumë mund, vullnet dhe sakrificë, ata mësimdhënës dhanë shumëçka për t'i rezistuar intelektualisht pushtuesit, duke e luftuar analfabetizmin, duke e ruajtur dhe përcjellë gjuhën shqipe te brezat e rinj.

Natyrishit për këtë përpjekje kolosale ata edhe u ndëshkuan kolektivisht. Thua se ndoshta nuk ka ndonjë shembull tjetër në histori të një ndëshkimi të tillë total. Me këtë rast, për një kohë shumë të shkurtër dëbohen nga puna. Kështu mbi 5000 arsimtarë të shkollave të mesme dëbohen nga puna dhe nga lokalet e tyre të mësimi, më se 850 profesorë universitarë po ashtu e përjetuan të njëjtin fat, dëbohen nga lokalet shkollore me llogari që të mos mund ta vijnë fare shkollimin mbi 20 000 studentë, e rreth 60 000 mijë nxënës të shkollave të mesme. Po ashtu, në të njëjtën kohë u ndërpre paga edhe të gjithë mësuesve shqiptarë të shkollave fillore, gjithsej rreth 18 000 sish.

Pra, se çfarë ishin përmasat e këtij brutaliteti, ndoshta këtu edhe nuk është nevoja të zgjatemi shumë.

Me lejoni, të nderuar deputetë, që këtu ta përmend vetëm një rast që një arsimtarë e asaj kohe kujton për vështirësitë me të cilat atëbotë u përballuan. Në rrëfimet e saj, ajo mësuese thotë: “Ne, mësuesve shqiptarë na vinte rëndë, por kishte mësues me nga 4-5 fëmijë, që punonin vetëm dhe që kurrë s’mund të pritnin datën 1 të muajit, ditën e rrogës, pa borxhe të mëdha. Dhe këtyre t’u thuhet se s’ka dhe s’do të ketë paga për ta, pa iu përgjnjur Serbisë, ishte vërtetë gjë e tmerrshme. Dhe, për çudi asnjëri prej tyre, nuk manifestoi asnjë shenjë dobësie. Bile krenoheshin që në këtë mënyrë po i rezistojnë Beogradit dhe regjimit të Milosheviqit”.

Besoj se asgjë me shumë se sa ky fakt nuk e pasqyron punën e arsimtarëve tonë në atë kohë, të cilët ishin bartësit kryesorë të rezistencës në fushën e arsimit.

Pa dyshim mbetet më se e qartë se Serbia donte ta përdorte presionin mbi shkollën shqipe për ta çrregulluar shkollimin e shqiptarëve, për të krijuar situatë të pashpresë për shqiptarët në Kosovë dhe për ta demotivuar qëndrimin e tyre të mëtutjeshëm në Kosovë. Por, mbi të gjitha, ajo donte të bënte presion nëpërmjet shkollës, që ta pranojmë Serbinë dhe pushtimin e saj.

Mirëpo, pikërisht me këtë rezistencë të tyre ndaj atij okupimi të egër, kjo kategori e shoqërisë, krahas mbijetesës së shkollës shqipe, arriti që me sukses ta demaskonte edhe karakterin represiv të regjimit të Milosheviqit. Sepse, siç ka thënë filozofi i njohur Rousseau, “edhe më i forti nuk është aq i fortë për ta përjetësuar sundimin e vet po nuk e shndërroi në të drejtë, kurse nënshtrimin në detyrë”. Dhe, pikërisht me këtë kontestim dhe refuzim që shtresa e mësimeve shqiptarë bëri ndaj sistemit të Milosheviqit, ia arriti që të mos e lejojë ta shndërrojë forcën në ligj dhe të mos e njohë sundimin serb veçse si dhunë.

Në këtë kontekst, shihet qartë se ai regjim pikërisht nuk e kishte llogaritur mirë një gjë; organizimin e shkollës, qoftë edhe jashtë objekteve shkollore. Dhe, është pikërisht ky vetorganizim mahnitës i shkollës shqipe që e ruajti tërë strukturën e shkollimit, pa u shuar asnjë shkollë, asnjë fakultet, asnjë degë, asnjë seksion apo katedër, që e shpëtuan mësimin në gjuhën shqipe. Madje, në sajë të kësaj pune, shumë nxënës dhe studentë, në sajë të dëftësive dhe diplomave të lëshuara nga Republika e Kosovës në atë kohë arritën t’i vijnë studimet e tyre edhe në vendet e ndryshme të Bashkimit Evropian dhe në

Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pra, pikërisht me këtë punë mësimdhënësit shqiptarë të asaj kohe u bënë simbol i rezistencës sonë kolektive, e penguan eksodin masiv të shqiptarëve të Kosovës, si dhe krijuan terren për luftën çlirimtare, luftë në të cilën shumë prej tyre e dhanë edhe jetën.

Gjykuar mbi këto fakte, Lëvizja “Vetëvendosje” e përkrah këtë debat dhe pa dyshim do t’i votojë rekomandimet e parashtruara në tekstin e kërkesës për debat. Sepse në këtë mënyrë ne e njohim karakterin legal të institucioneve tona dhe e denoncojmë karakterin ilegal të shtetit të Serbisë.

Ndërkaq edhe këto rekomandime i shohim të ngjashme me frymën e tekstit të rezolutës së propozuar nga Lëvizja “Vetëvendosje” lidhur me tjetërsimin e pronës publike dhe shoqërore nga regjimi i Milosheviqit, por që u refuzua dje nga ky Kuvend.

Prandaj, për ne është absurde se si disa deputetë të këtij Kuvendi dje nuk e miratuan tekstin e asaj rezolute.

Në fund të fundit, refuzimi i atij sistemi dhunues nuk mund bëhet parciaisht, por universalisht si një e keqe totale. Sepse vetëm me këtë refuzim të përgjithshëm ndaj çdo vendimi të atij regjimi, ne mund t’i japim kuptim asaj formulës së sipërcekur të Rusos për ta penguar shndërrimin e sundimit në të drejtë dhe nënshtrimin në detyrë. Dhe, nëse qytetarët e Kosovës, për një dekadë i qëndruan konsekuent këtij parimi, dhe atë veçanërisht punonjësit e arsimit, fatkeqësisht ky Kuvend dje dështoi ta mishërojë këtë sentencë fundamentale politike dhe etike, universalisht të vlefshme, e cila për një dekadë ishte motivi kryesor i rezistencës sonë politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar e respektuar të gjithë mësimdhënësit, e në veçanti mësimdhënësit e viteve ‘90-’99,

Sot kur po mbajmë një debat për të diskutuar për një çështje shumë elementare, shumë thelbësore, një e drejtë e mohuar nga kjo Qeveri edhe me mospraninë sot këtu, edhe pse do të ishte e vonuar, por edhe një herë ka qenë shumë më mirë që sot të mbahej një seancë solemne për ta nderuar sakrificën e gjithë këtyre mësimdhënësve, por gjithsesi edhe të gjithë qytetarëve, të cilët dhanë gjithçka nga vetja, duke i lëshuar edhe shtëpitë e tyre, pra për ta mbajtur arsimin gjallë në Kosovë.

Edhe pse po bëhen plot 14 vjet që nga përfundimi i luftës në Kosovë, dhe 5 vjet nga shpallja e pavarësisë, kërkesat e arsimtarëve shqiptarë të Republikës së Kosovës, të cilët punuan që nga viti shkollor ‘99 e deri në vitin shkollor ‘98/’99 për zgjidhjen e stazhit të punës që realizuan këtë sistem arsimor dhe barazimi i statusit të tyre me personat e merituar për rezistencë kundër pushtetit okupues të Serbisë, fatkeqësisht edhe sot e kësaj dite po mbetet në vesh të shurdhër dhe si i tillë i pazgjidhur.

Punëtorët e arsimit shqiptar të këtyre viteve ishin ndër hallkat e para jashtëzakonisht të rëndësishme të rezistencës gjithëpopullore dhe bartës të fillimit të krijimit dhe veprimit institucional, para së gjithash ndaj represionit, dhunës dhe okupimit të Kosovës në atë kohë.

Përkundër këtij fakti të pamohueshëm, në këto rrethana tepër të vështira, punëtorët e arsimit të këtyre ditëve dhe problemi arsimor në tërësi pothuaj se funksionoi për mrekulli dhe falë këtij kontributi e dhanë shembullin më të mirë në organizimin e jetës arsimore në rrethana okupimi klasik, kur qenë mbyllur të gjitha shkollat e ngritura me shumë mund e sakrificë.

Historia më e re e Kosovës nuk mund të shkruhet pa këtë angazhim mbinjerëzor dhe pa këtë sakrificë të të gjithë arsimtarëve, që në mënyrë të drejtpërdrejtë po e sfidonin regjimin e dhunshëm të Milosheviqit.

Bartja e dokumenteve nga shkollat, nga drejtorët dhe mësimdhënësit dhe lidhja e tyre me Ministrinë e Arsimit, dhënia dhe mbushja e dëftesave në mënyrë të fshehtë dhe dhënia atyre nxënësve sot për ta rikujtuar më rrëqeth.

Përkundër këtyre rrethanave shumë të vështira, falë vullnetit të jashtëzakonshëm të këtyre arsimtarëve, edhe cilësia arsimore ishte në nivelin e duhur, sepse bartësit e arsimit shqip në Kosovë ishin shumë të vetëdijshëm, sepse vetëm të ditur e të shkolluar mund bashkërisht ta sfidonin regjimin e egër të pushtuesit dhe të marshojmë kah e ardhmja me vizion të qartë.

Është tepër e rëndësishme të themi se interesi financiar nuk u diskutua për asnjëherë gjatë atyre viteve, sepse interesat e vendit ishin parësore në raport me ato personale.

Kjo punë e palodhshme bëri që ne sot të mos kemi gjenerata të tilla analfabetësh, ndonëse u punua pra edhe pa pagesë deri në vitin 1992, por edhe kur filluan të paguheshin, atëherë në baza vullnetare nga qytetarët e nderuar të vendit tonë, ajo pagë ishte tepër simbolike, përballë rreziqeve permanente të përditshme në misionin e shenjtë që po e kryenin me devotshmëri dhe përkushtim të lartë.

Si është e mundur që e gjithë kjo sakrificë e mësimdhënësve shqiptarë të neglizhohet në këtë masë, për të mos thënë po injorohet skajshmërisht. Si është e mundur që të tjerët që punuan në organet apo institucionet e Serbisë së paku 15 vjet t'u pranohet përvoja e punës, ndërsa arsimtarëve shqiptarë - kësaj pjese më të nderuar të shoqërisë sonë dje dhe sot, nuk u pranohet për 10 vjet asgjë.

Kjo, të nderuar kolegë deputetë, është e papranueshme. Ky fakt duhet të trokasë në ndërgjegjen e secilit prej nesh.

Edhe sot e kësaj dite ekziston një vendim i Qeverisë së Kosovës, pra i marrë më 20 shkurt 2008, kur është njohur formalisht stazhi i punës për këto vite, por obligimet nga Ministria e Arsimit nuk u përmbushën asnjëherë.

Ne si Aleancë vazhdimisht e kemi përkrahur dhe do t'i mbështetim punëtorët e arsimit të këtyre viteve dhe konsiderojmë se është momenti i fundit që kjo Qeveri ta bëjë gjënë e duhur dhe të ndërmarrë hapa konkretë drejt zgjidhjes së kësaj çështjeje jetike për të gjithë ata mësimdhënës.

Konsiderojmë se është më se e domosdoshme që të vlerësohet validiteti i sistemit arsimor të Republikës së Kosovës për këto vite, të zgjidhet statusi i të punësuarve në sistemin arsimor shqiptar të Republikës së Kosovës, të personelit udhëheqës dhe personelit tjetër të punësuar në shkolla, të punësuarve në sekretariatet e këshillat komunale të arsimit, enteve pedagogjike komunale e republikane, si dhe në Ministrinë e Arsimit të Republikës së Kosovës, t'u pranohet të gjithë qytetarëve që lëshuan shkollat-shtëpi, pra të punësuar në këshillat e financimit, e kështu me radhë.

Arsyet për një gjë të tillë s'do mend se janë të shumta, sepse para së gjithash ata me punën që e kanë bërë gjatë kësaj kohe në ruajtjen e gjuhës, parandalimin e eksodit masiv të popullit shqiptar në Kosovë, punën vullnetare, e meritojnë që kjo çështje të zgjidhet sa më parë që të jetë e mundur.

Ne si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës i përkrahim rekomandimet, sepse kjo, para së gjithash, është më e pakta që mund ta bëjmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit Kosova e Re, kryetarja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të arsimit të viteve '90-'98,

Duke marrë parasysh debatin, i cili është kërkuar nga Lidhja Demokratike për statusin e pazgjedhur të punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës që nga viti shkollor '90/'91 e deri në vitin shkollor '98-'99, mund të themi se gjithë qytetarët e Kosovës, që nga vitet '90, '91 dhe deri në përfundimin e luftës janë ata të cilët i kanë bërë rezistencë pushtuesit serb.

Në rast se e shohim punën e sektorit të arsimit në këtë periudhë, mund të themi se këtu ka filluar rezistenca më e mirë, për arsye të shkollimit të gjeneratave të ardhshme, të cilat janë zhvilluar në atë situatë.

Çështja e këtyre punëtorëve të arsimit dhe të gjithë profesorëve, nxënësve e studentëve, është për lëvdatë, të cilët ia kanë borxh Kosovës, pavarësisht a është arsimtar, mësues apo profesor i fakultetit, nxënës, student, të gjithë ia kemi borxh vendit të punojnë për të, mirëpo në bazë të infrastrukturës ligjore edhe Qeveria duhet t'i marrë obligimet e rekomandimeve, të cilat dalin nga ky debat, e aë kemi një ligj për punëtorët e arsimit të këtyre viteve.

Me këtë rast i kisha falënderuar edhe qytetarët tanë në Diasporë, të cilët u mundësuan profesorëve e arsimtarëve tanë që ta kenë një pagë simbolike për arsye se edhe ata me rezistencën e tyre nga Diaspora u mundësuan qytetarëve të Kosovës, të cilët ishin nën

okupim, që të mundësojnë edhe sistemin e arsimit në atë mënyrë çfarë kanë mundur ata të punojnë.

Në përgjithësi, Koalicioni për Kosovë të Re i përkrah rekomandimet e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe Komisionit Parlamentar, mirëpo kërkojmë që jo vetëm arsimtarët, nxënësit dhe profesorët, por edhe qytetarët e Diasporës ta marrin një lëvdatë për punën, të cilën e kanë bërë me financimin e fondit për këta arsimtarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të grupeve parlamentare, nuk ka tjerë të paraqitur. Fjalën e ka zoti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë nuk desha të përmend emra këtu, por zoti Bajrami e përmendi një listë të emrave, të cilët kërkojnë që të dekorohen nga Presidentja dhe sigurisht nuk e ka në kujtesë atë që rektori i parë i Universitetit të Prishtinës dy mandate ka qenë akademiku i nderuar zoti Dervish Rozhaja, dhe nuk e përmendi që të jetë në këtë listë, e sigurisht se edhe emra tjerë e meritojnë dhe s'di a pati nevojë të tregojë se asistent i kujt kush ka qenë, por sido që të jetë, le t'i mbetet secilit në ndërgjegjen e tij.

Sot, kur po debatojmë për njohjen e përvijës së punës për mësimdhënësit që ishin kyçur në procesin mësimor në vitet '90-'99, e dimë se kjo ishte periudha më e vështirë e ekzistimit të arsimit shqip në Kosovë. Ishte periudha kur arsimi mori goditje të rëndë nga pushteti represiv serb, duke i përzënë me forcë nxënësit, studentët dhe mësimdhënësit nga objektet e veta arsimore, kohë kur u ndërpre edhe financimi i sistemit të arsimit shqip.

Të gjithë ne e kemi përjetuar në një formë apo tjetër këtë periudhë të arsimit, por shumë shkurt do të doja ta rikujtoj këtë periudhë.

Sistemi i arsimit shqip në këtë periudhë ishte vazhdimësi e natyrshme dhe spontane e arsimit, e sistemit të arsimit të pavarur të Kosovës. Në atë kohë, populli i Kosovës dhe mësimdhënësit vendosën që të mos i zbatojnë ligjet e Serbisë, të cilat ishin diskriminuese dhe në kundërshtim të plotë me konventat ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Duke mos i zbatuar këto ligje, në maj të vitit 1990 u vendos që për vitin shkollor '90/'91 të zbatohen plan-programet ekzistuese mësimore, e jo planprogramet e projektuara nga Serbia në atë kohë.

Këtë vendim, Serbia e përdori si alibi për të ndërhyrë me masa represive. Kështu u përjashtuan të gjithë punëtorët shqiptarë nga puna dhe u suprimuan të gjitha institucionet e sistemit të arsimit.

Në vitin 1990 dhe në fillim të vitit 1991, të ardhurat personale u ndalën për të gjithë arsimtarët shqiptarë. Kështu, rreth 20 000 arsimtarë shqiptarë mbetën pa të ardhura. Në këtë kohë u vendos të formohet Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë, e cila e mori nën udhëheqje sistemin e arsimit shqip, duke iu përgjigjur kështu veprimeve rrënuese serbe.

Në fillim të vitit shkollor '91/'92, policia serbe u vendosën para ndërtesave shkollore me qëllim të ndalimit të mësimi në gjuhën shqipe. Mësimi në gjuhën shqipe në arsimin parauniversitar u ndalua tërësisht. Kjo ndodhi edhe me studentët dhe pedagogët universitarë në fillim të vitit '91/'92.

Në një takim të mbajtur në tetor të vitit 1991, institucionet e arsimit të Kosovës dolën me propozim që të bëhen përgatitjet për fillimin e vitit të ri nëpër shtëpitë-shkolla. Në këtë mënyrë filloi rimëkëmbja për mbijetesën e arsimit shqip.

Deri në shkurt të vitit 1992, punën në shtëpi private apo në shkolla, sipas varianteve të parapara, e kishin filluar të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës. Kështu me qëllim të krijimit të kushteve minimale për punë të suksesshme, drejtuesit e atëhershëm të arsimit shqip në Kosovë iniciuan punën për hartimin e një strategjie për vetëfinancimin e arsimit në gjuhën shqipe. Nga kjo strategji doli Këshilli Qendror dhe këshillat komunale të financimit, nëpërmjet të cilëve u mundësua që arsimtarët shqiptarë nga maji i vitit '92 të paguheshin me shuma simbolike të parave. Të gjithë e dimë se pagesat fillestare ishin nga 20 marka gjermane.

Në këtë drejtim, përveç përpjekjeve për organizim brenda shoqërisë shqiptare në Kosovë për sigurim të fondeve ishte Diaspora shqiptare, ajo që dha kontributin e vet shumë të madh. Gjatë kësaj periudhe, barra më e rëndë sigurisht mbeti ta bartnin arsimtarët. Falë vetëmohimit të arsimtarëve, arsimi në Kosovë mbijetoi edhe në këto kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme. U organizua zhvillimi i mësimi në të gjitha nivelet në rreth 3 200 shtëpi private.

Të nderua deputetë,

Nëse kjo nuk do të ndodhte, çfarë mund t'u ndodhte familjeve shqiptare në Kosovë nëse fëmijët e tyre për një dekenie do të mbeteshin pa u shkolluar. Sigurisht se në këto rrethana vështirë se do të kishte motiv për të qëndruar në këto troje. Kështu, Kosova do të braktisej nga popullata shqiptare, që ishte edhe qëllimi politik i sistemit represiv serb.

Prandaj, ky brez i arsimtarëve ishte mrekullia e rezistencës shqiptare në Kosovë, sepse ishte rezistenca më sfiduese që e komprometoi politikën serbe për Kosovën dhe e ruajti substancën kombëtare shqiptare në këto troje. Për gjithë këtë sakrificë, vetëmohim e durim, për ta ruajtur e zhvilluar arsimin shqip në Kosovë, mësimdhënësve duhet t'u njohet përvoja e punës gjatë viteve '90 - '99.

Prandaj, për ne deputetët e Kuvendit të Kosovës, marrja e vendimit për njohjen e përvojës së punës mësimdhënësve për këtë periudhë është jo vetëm një akt moral, por edhe emocional, ndërsa për këta mësimdhënës është një falënderim që ata gjithsesi e meritojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Afërdita Berisha-Shaqiri. Nuk qenka këtu Afërdita! Bahri Thaçi, nëse është këtu? Nuk dëshiron! Afërdita, e keni fjalën! Unë të vetmen rrugë e kam, nëse ju e bëni listën si grup dhe e dorëzoni, që ta shoh renditjen, sepse nuk kam preferencë. Zonja Berisha-Shaqiri e ka fjalën.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar mësimdhënës, të pranishëm në sallë,

Të nderuar qytetarë,

Arsimi e luan një rol qendror në zhvillimin dhe përhapjen e vlerave themelore të njeriut. Mu për këtë, pushteti i atëhershëm nacionalist serb u angazhua me tërë forcën e tij ushtarake për ndryshimin dhe ndalimin e shkollës shqipe në Kosovë, sepse atë e shihte si rrezikun më të madh.

Shkolla shqipe për ta ishte arma që të vret pa plumb. E shihte si rrezikun më të madh, sepse po shkolloheshin gjenerata të reja, sepse tanimë kishte ardhur koha t'i themi mjaft këtij regjimi dhe do të bëheshim zot të shtëpisë sonë.

Në këtë kohë, shkolla shqipe në Kosovë, në veçanti Universiteti i Prishtinës, mori goditje të mëdha që çuan deri në rrezikimin më serioz me përmasat e shkatërrimit. Krahës gjendjes së vështirë sociale dhe ekonomike, largimit të vazhdueshëm nga puna në gjithë Kosovën, erdhi duke u përkeqësuar edhe gjendja në shkolla dhe në Universitet. Regjimi i asaj kohe, më 26 qershor 1991 vendosi masat e dhunshme në Universitetin e Prishtinës. Mirëpo, më 17 shkurt 1992, politikëbërësit e asaj kohe morën vendimin për fillimin e vitit akademik në shtëpitë-fakultete. Kishin kaluar më shumë se 7 muaj që ne po prisnim një fillim të ri, po prisnim vazhdimin e studimeve, të cilat na u ndërprejnë si në asnjë vend në botë. Në qendër të Evropës, fëmijëve dhe studentëve shqiptarë po u mohohet një e drejtë elementare, vetëm se ishin shqiptarë, vetëm se donin të ishin si të tjerët. Po na ndalonin të shkonim në shkollat që prindërit tanë i kishin ndërtuar me shumë mund.

Në këtë kohë të vështirë, si askund në botë, mësimdhënësit kosovarë dhanë provimin e jetës, duke punuar nëpër shtëpi-shkolla, nganjëherë në dhoma mësimi pa dritare, shpeshherë duke udhëtuar në të ftohtë, të frikësuar dhe të kërcënuar, nën vëzhgimin e pandërprerë të forcave policore, nën presionin psikologjik dhe biseda informative, si i gjithë populli i Kosovës në atë kohë, por ata nuk u mposhtën, vazhduan të punojnë, duke sakrifikuar jetën dhe shëndetin. Ata e bënë pra një punë madhore, pothuaj të pashembullt, duke e organizuar sistemin shkollor brenda një shteti policor. Ata punuan për fëmijët, rininë, popullin e Kosovës. Ata e mbrojtën dinjitetin qytetar dhe kombëtar, ata ndikuan dhe mobilizuan energji qëndresa të njerëzve të këtij vendi dhe e trasuan fatin e së ardhmes së këtij vendi. Ata e bënë një rrugëtim të vështirë, duke i dhënë Kosovës një rilindje të paparë prej Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Dhe, kjo nuk zgjati një muaj apo një vit, apo dy vjet, por zgjati plot një dekadë. Arsimitarët, nxënësit e studentët që u shkolluan në këtë kohë nuk e harrojnë këtë periudhë. Nuk e harrojnë as ata që i hapën shtëpitë e tyre, duke kthyer në shtëpi-shkolla. Këtë periudhë nuk e harron asnjëherë krejt populli i Kosovës.

Mësimdhënësit pra e bënë punën e tyre në kohën e duhur. Ata e krijuan embrionin e shtetit të Kosovës. E të tjerët, duhet ta vlerësojnë, a duhet të çmohet dhe si duhet të çmohet kjo sakrificë e madhe dhe pothuaj e pamatshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Albana Gashi e ka radhën.

ALBANA GASHI: Faleminderit kryesues!

Skema pensionale në Kosovë është tërësisht e çoroditur dhe është tmerrësisht e fragmentuar, duke e mbytur në këtë mënyrë organizimin. Gjenerata të tëra që kanë kontribuar në të kaluarën, janë anashkaluar nga sistemi aktual pensional. Për 14 vjet rresht pas luftës, punëtorëve në sistemin arsimor që kishin punuar gjatë viteve shkollore 1990/91 deri në 1998/99 nuk u llogariten si vite pune në kalkulimin që bëhet për pensione.

Sot, mësimdhënësit e pensionuar marrin vetëm pensionin bazë shkaku i moshës së tyre ose si ndihmë sociale, për shkak të kushteve ekonomike, por jo edhe pensione pune. Mësimdhënësit shqiptarë të asaj kohe, pas largimit të dhunshëm nga objektet shkollore dhe pas ndalimit të mësimi shqip, e organizuan sistemin legjitim të arsimit shqip në të gjitha nivelet, fshehurazi nëpër shtëpi e bodrume për pothuajse 10 vjet, duke i rezistuar kështu intelektualisht pushtuesit, duke e luftuar analfabetizmin, e duke e ruajtur dhe duke e përcjellë gjuhën shqipe te brezat e rinj.

Ata u organizuan në Lidhjen e Arsimitarëve Shqiptarë. Vitin e parë punuan pa rroga, pastaj merrnin vetëm 20 marka gjermane si rrogë mujore dhe vetëm me kalimin e viteve ata filluan të merrnin rroga të rregullta, edhe atëherë shumë të ulëta.

Vitet e punës, në periudhat më të vështira të popullit shqiptar, nën shtypjen e egër, në periudhën kur ata arritën ta mbajnë gjallë arsimin në gjuhën shqipe, nuk po u njihen. Kjo është një mosmirënjohje për sakrificën që ata bënë.

Draftligji për pensionet nuk e specifikon njohjen e viteve të punës gjatë viteve '90-'99. Mësimdhënësit e pakënaqur me këtë, së bashku me Sindikatën e Bashkuar të Arsimit të Kosovës kanë mbledhur mbi 12 mijë nënshkrime, nëpërmjet të cilave kërkojnë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që ta vlerësojë validitetin e sistemit arsimor të Republikës së Kosovës në periudhën 1990/91-1998/99; ta zgjidhë statusin e të punësuarve në sistemin arsimor shqiptar të Republikës së Kosovës gjatë asaj periudhe; që statusi i të punësuarve në arsimin shqiptar të Republikës së Kosovës gjatë periudhës '90-'91 dhe '98-'99 të barazohet me statusin e personave të merituar në rezistencën kundër pushtuesit serb dhe ky status të rregullohet me një ligj të veçantë.

Trajtimi që pushteti aktual në Kosovë po ia bën kësaj kategorie, është i papranueshëm.

Lufta e tyre nuk përfundoi me mbarimin e luftës. Ata sot janë të detyruar të vazhdojnë të luftojnë për njohjen e punës së tyre dhe për ruajtjen e dinjitetit të tyre.

Kjo qasje, sikur edhe e gjithë orvatja e këtyre qeverisjeve të pasluftës me sistemin pensional, është tërësisht e padrejtë dhe nënçmuese ndaj punës dhe rezistencës së sektorit arsimor gjatë këtyre viteve.

Politikat pensionale duhet të jenë të integruara, në përputhje me nevojat dhe në të njëjtën kohë edhe me rrethanat historike të vendit.

Për sa kohë Qeveria zgjedh ta harrojë kontributin e tyre, mbetet detyrë e gjithë shoqërisë sonë që t'i mbështesë këta mësues në betejën për ta fituar të drejtën e pensionit edhe për vitet e ilegalitetit, e për ta fituar një trajtim dinjitoz e njerëzor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tanë bëjmë pauzë deri në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pasdite

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: A ia fillojmë debatit, a jeni të përgatitur? Kush është i pari?

Unë gjinisë femërore dua t'i jap përparësi. Vazhdojmë. Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Kryetar, në mënyrë të singertë po e them, nëse ka ndonjë deputet, i cili ka më shumë se 5 minuta për të diskutuar, unë besoj që ju do të keni mirëkuptim. Mirëpo, unë kisha propozuar që të jetë diskutimi 5 minutash, nëse jo është ok-ej.

(Reagimi nga salla)

Zoti kryetar, unë e thashë , ne mund ta bëjmë si të doni, nuk ka problem.

KRYETARI: A po e qesim në votim propozimin tuaj? Po ai ka të drejtë të kërkojë së është kërkuar i debatit. Po nuk paske kuorum për votim. Vazhdojmë. Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministër,

Të nderuar deputetë,

Sa i përket debatit parlamentar lidhur me statusin e pazgjidhur të punëtorëve të arsimit, i propozuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës, ne kemi gjetur mbështetje edhe nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit të Kosovës, përmes një peticioni që e ka dërguar më 12 000 nënshkrime, të cilët kanë kërkuar barazim të statusit me personat e merituar për rezistencë kundër pushtetit okupues të Serbisë. Përveç kësaj, atyre duhet t'u rregullohet dhe t'u vlerësohet kontributi i tyre dhe të vlerësohet vlefshmëria e sistemit arsimor 1990-1999, e që duhet të rregullohet me ligj të veçantë.

Në rast se dikujt iu ka mohuar kontributi ose të them janë përbuzur skajshmërisht, janë pikërisht mësimdhënësit të cilët arritën të mbajnë arsimin shqip gjallë nën një okupim të tmerrshëm. Por, parashtrohet pyetja se cili është fati i tyre sot, ose sa hise të meritokracisë u njihet sot atyre ose a kanë ndonjë privilegj të shkruar ata? Ata sot në vend se të paktën

të bëjnë një jetë të qetë dhe të përcjellin dije tek gjeneratat e reja, ata sot janë të diskriminuar, të spikatur para pensionit se a do të arrijnë t'i ruajnë vendet e tyre të punës, sepse Ministria e lirisë, pra Ministria e Arsimit, sot ua ka imponuar që edhe njëherë të rikualifikohet kjo kategori edhe pse një numër i konsiderueshëm i tyre, qysh në vitet e '90-ta kanë qenë të kualifikuar.

Dua të them edhe diçka, sepse jo vetëm kategoria e mësimdhënësve, por të gjithë atyre qytetarëve që si pasojë e masave të dhunshme të atëhershme kanë dal nga puna, duhet t'ju njihet e drejta e kontributit, sepse ajo ka qenë e vetmja rezistencë e mirëfilltë që ka shpënë këtu pra ku jemi sot. Dhe për të mos ndodhur e kundërta, ata të cilët kanë punuar gjatë atyre masave të dhunshme, sot prapëseprapë njihen si kontribut-pagues dhe njëherit po ashtu po dalin më fitimtar se kjo kategoria tjetër të cilës nuk i njihet kontributi i tyre. Andaj që të mos bëhet ky farë diskriminimi, unë kërkoj nga Parlamenti, po ashtu edhe nga deputetët e të gjitha partive politike, që t'i votojmë të gjitha rekomandimet e Lidhjes Demokratike të Kosovës, që të përfshihen edhe qytetarët tjerë që kanë dal si pasojë e masave të dhunshme nga puna, sepse sot ata të cilët kanë punuar në ato masa të dhunshme, ata janë shumë më përfitues se sa punëtorët të cilët janë diskriminuar në atë kohë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit!

I nderuar Krasniqi, kryetar i Parlamentit të Kosovës,

Të nderuar deputetët,

Ju falënderoj shumë për këtë mundësi të debatit që të diskutojmë për çështjen e stazhit të mësimdhënësve kosovarë, aq sa jam i informuar është kërkesë e Lidhjes Demokratike të Kosovës, që kjo çështje të diskutohet, të debatohet dhe pastaj edhe të respektohen rekomandimet. Unë ndihem tepër mirë si kryeministër i Kosovës që sot të diskutojmë për këtë çështje më në fund të pranueshme edhe nga Lidhja Demokratike e Kosovës, diçka që Qeveria e Kosovës ka filluar herët të punojë, ka marrë edhe vendime dhe jemi në fazën përfundimtare. Unë dëshiroj vetëm të theksoj se Qeveria e Kosovës, më 15 maj 2008, ka marrë vendim për aplikimin e gjithë mësimdhënësve kosovarë kur kemi qenë në koalicion, pra bashkë, pastaj jeni vonuar, më 15 maj 2008, ka marrë vendim Qeveria e Republikës së Kosovës që të respektojë stazhin e punës për të gjithë mësimdhënësit universitar, shkollave të mesme, filllore dhe kategorive të tjera. Prandaj që të jemi transparent, unë dëshiroj ta lexoj edhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, pra Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2008, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet iniciativa që t'u njihet stazhi i punës të gjithë mësimdhënësve, stafit administrativ dhe teknik në institucionet arsimore të cilët kanë punuar në periudhën që nga viti 1990 deri më 1999.

2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që të fillojë përgatitjet ligjore dhe të hartojë një raport detal lidhur me numrin e mësimitdhënësve që kanë punuar në këtë kohë në institucionet shkollore të Kosovës.

Tani ky proces është në fazën finale dhe unë dëshiroj që të theksoj se kjo problematikë do të rregullohet me ligj dhe jo me rekomandime, kështu që i falënderoj për mbështetjen edhe sot që po jepni, por unë ju ftoj në vend të rekomandimeve, t'i jepni mbështetje zgjidhjes të kësaj problematike përmes ligjit dhe ftoj Lidhjen Demokratike ta përkrahë Qeverinë e Kosovës në këtë çështje.

Gjithashtu dëshiroj të theksoj se jemi duke punuar që stazhin e punës ta rrallojmë edhe për të gjithë punëtorët e shëndetësisë të Kosovës, pra nga viti 1990 deri 1999, të gjithë shërbyesit civilë, policët e Kosovës dhe kategoritë tjera, minatorët dhe kategoritë tjera që kanë punuar, që kanë qenë të përjashtuar nga Serbia, në vitin 1990 deri në vitin 1999. Prandaj, unë dëshiroj që edhe një herë ta ftoj Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ta përkrahni vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për t'u njohur stazhi i punës për të gjithë mësimitdhënësit. Nëse keni gabuar që nuk e keni përkrahur vendimin e Qeverisë së Kosovës, për t'i rritur pagat e mësimitdhënësve në vitin 2011 për 50%, atëherë ju ftoj tash ta përkrahni Qeverinë e Kosovës, në njohjen e stazhit të gjithë punëtorëve të arsimit,

pra nga viti 1990-1999, gjithashtu të përkrahni Qeverinë edhe në vendimet që do të pasojnë për njohjen e stazhit për të gjithë punëtorët e shëndetësisë nga viti 1990-1999, gjithashtu për të gjithë shërbyesit civilë, policët, minatorët dhe kategoritë e tjera. Ju ftoj për përkrahje. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj që zoti Thaçi si zakonisht është kah bën fushatë dhe po bën fushatë dhe lojë me vendime të veta. Mendoj këtë që e tha, është një përrallë që ka zgjatur 5 vjet, nëse e keni marrë vendimin, pse nuk e keni zbatuar gjer me tani dhe kjo është kërkesë e punëtorëve të arsimit, ne e kemi proceduar një vullnet, një kërkesë të tyre. Atyre që 5 vjet nuk u realizohet kjo ose më mirë të them që 13 vjet pas luftës nuk i realizohet, vendimi qenka, ne asgjë nuk kemi kërkuar më shumë se sa të nxirret, nuk e di a e keni lexuar, si duket po flisni përmendësh, rekomandimet nuk kemi thënë ne që kjo punë të rregullohet me rekomandime, por rekomandimi ynë është pikërisht me ligj kjo të bëhet, dhe kjo nuk është bërë. Prandaj, nuk është mirë nga ana e juaj që me një cinizëm si zakonisht që po e bën, edhe këtë po e bënë, këndeju thua që është një debat i mirë e tjera e tjera, ndërkaq në anën tjetër vërtet silleni që nuk do të dëshironim të sillat kështu vërtet në mënyrë ironike flisni për diçka që e kemi ngritur si shqetësim të 12 000 e sa nënshkruesve, zoti kryeministër, ajo punë nuk është kryer. Unë e besoj që është vendimi, por nuk është kryer puna dhe procedura siç thoni ju, mund të gjasë edhe 5 vjet tjera dhe ne asgjë nuk kemi kërkuar më shumë se sa që me ligj të rregullohet kjo e drejtë që ju veç ua paskeni mundësuar me fjalë, por jo edhe konkretisht. Nuk ka asgjë prej asaj pune gjerë më tani.

Rregullojeni, njihjani këtë të drejtë, jepjani edhe lekët që u takon njerëzve dhe mesazh dhe u krye, ne këtu jemi ok-ej, por këto që po i thoni, po i thoni vetëm sa për të thënë, vërtet për të devalvuar ose tentuar për të denigruar edhe një iniciativë shumë korrekte edhe një debat që ishte jashtëzakonisht korrekt i deputetëve ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro, kryeministër! Kundër-replikë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Është më tepër sqarim për, tash edhe më i nderuari zoti kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri, më tepër sqarim dhe për ta prezantuar transparencën e plotë të këtij procesi, unë e ritheksoj edhe një herë.

Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilën e udhëheq unë, ka marr vendim për njohjen e stazhit të punës për të gjithë mësimdhënësit kosovarë dhe këtu është vendimi, 15 maj 2008 dhe ky vendim, të lutem ky vendim është marr menjëherë pas formimit të Qeverisë. Ju, kërkon rekmandime, unë theksoj kjo çështje duhet të rregullohet me ligj dhe jo me vullnet politik.

Ne do t'i respektojmë të gjitha procedurat, do t'i respektojmë të gjitha hapësirat ligjore, do të punojmë në bazë të ligjshmërisë dhe jo të vullnetit politik, sepse kjo çështje nuk u rregullua lehtë, sot secili mësimdhënës ju pyet juve i nderuari Ismet Beqiri, pse nuk e keni rregulluar nga viti 2000 kur e keni pasur pushtetin deri në vitin 2007? Nuk e keni rregulluar dhe sot secili mësimdhënës, ju pyet juve, sepse ju e keni pasur Qeverinë, ju i keni fituar zgjedhjet, ju nuk e keni rregulluar.

Sa i përket asaj se pse nuk janë dhënë ende lekët, ju e dini se ju u keni borxh ende mësimdhënësve në periudhën '90-'99 dhe ju keni goxha shumë, ndërsa në të njëjtën kohë ju ftoj që ta përkrahni implementimin e këtij vendimi të Qeverisë se nuk do të jetë edhe e lehtë. Unë e theksoj edhe një herë dhe dëshiroj që të jem shumë i qartë, Qeveria që e udhëheq unë, do t'ia njohë stazhin jo vetëm mësimdhënësve, por të gjithë punëtorëve kosovarë të dëbuar nga Serbia nga viti 1990 deri në vitin 1999. Ju ftoj për përkrahje. Faleminderit!

KRYETARI: Një minutë, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar i Kuvendit, po ia rikujtoj zotit Thaçi që LDK-ja asnjëherë nuk e ka udhëhequr Qeverinë. Ky si duket nuk është kësajde, asnjëherë nuk e ka udhëhequr Qeverinë dhe prej vitit 2000, ju e dini që ka qenë UNMIK-u, ju e dini që prej vitit 2001 e keni pasur ju Qeverinë zoti Thaçi, PDK-ja dhe asnjëherë LDK-ja, sidoqoftë nuk ka rëndësi kjo, sepse e dimë që nuk e keni bërë ju këtë, dhe ju e dini po ashtu që është nxjerr edhe Ligji për pensionistët, financim të pensionistëve dhe ai stazh në atë ligj, zoti Thaçi nuk i është pranuar këtyre.

Ne asgjë nuk po kërkojmë më shumë dhe nuk po kërkojmë me rekomandime, por po kërkojmë ligj të veçantë që t'u njihet. Nëse është ai ligj që ju po e thoni, që nuk është, ju thoni kam marrë vendim, por ligj nuk ka, na po kërkojmë ligj dhe jo me rekomandime, por po rekomandojmë Qeveria të bënë ligjin dhe është në nderin e juaj, pra bëjeni. Ju jeni kryeministër, ju jeni Qeveri, bëjeni. Ne asgjë nuk po themi më tepër, po kërkojmë që ky Kuvend t'i obligojë ta bëni ligjin edhe t'u njihet ky stazh në baza të vendimit që e paskeni ju, se gjer më tani nuk është njohur. Kjo është e tëra. Prandaj, kush e ka udhëhequr Qeverinë, e dimë ne.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti Beqiri, unë ju pyeta sa i përket edhe parave dhe pagave. Sot secili mësimdhënës kosovar ju pyet juve për borxhin që ua keni mësimdhënësve kosovarë nga 1990 deri në vitin 1999, borxhet që u keni mbetur. Në anën tjetër, e theksoj edhe një herë, nëse nuk e keni udhëhequr Qeverinë, është paaftësia e juaj, qytetarët ju kanë besuar për ta udhëhequr Kosovën, nuk keni pasur guxim ta udhëhiqni Kosovën, ia keni dorëzuar pushtetin të tjerëve...

(Reagime)

...nejse tash kështu ka qenë, keni qenë të paaftë, i keni fituar zgjedhjet, qytetarët ju kanë besuar, nuk keni marrë vendime për ta udhëhequr vendin, ua keni dorëzuar pushtetin të tjerëve, është papërgjegjësi e partisë suaj, paaftësi e partisë suaj, prandaj përsëri ndonjëherë nëse i fitoni zgjedhjet, dorëzoheni përsëri...

(Reagime)

...ka plot që e marrin, plot ka që i marrin dhe duke pritur janë. Në anën tjetër...

(Reagime)

...po nuk keni për t'i fituar, e di. Në anën tjetër, e theksoj edhe një herë ju po kërkonit rekomandime, ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me Sindikatën e Arsimit, ne kemi vendim të cilin e kam nënshkruar unë, i qëndroj mbrapa dhe do ta implementoj, jo vetëm për mësimdhënësit kosovarë, por për të gjithë punëtorët kosovarë që do t'u njihet stazhi nga viti 1990 deri në vitin 1999, e përmenda me punëtorë të shëndetësisë, të arsimit, të policisë, minatorëve dhe të gjitha kategorive. Ndërsa, sa i përket përsëri pagesës së tyre, unë ju ftoj përsëri theksoj ju keni fituar zgjedhjet 2000-2007 dhe asnjëherë nuk keni marrë vendim për rritjen e pagave për mësimdhënësit, bile kur i kam rritur pagat në vitin 2010-2011, ju keni votuar kundër për buxhetin që shkonte për rritjen e pagave për punëtorët kosovarë, në veçanti për mësimdhënësit. Dhe unë këtu i kam edhe emrat e deputetëve që kanë votuar kundër atij vendimi për rritjen e pagave duke prirë nga Sabri Hamiti, Ismet Beqiri, Arben Gashi, Lutfi Haziri, Naser Osmani, Anton Çuni, Hashim Deshishku, Bahri Thaçi, Ali Sadriu, Vjosa Osmani, Haki Demolli, Salih Morina, Nazane

Breca, Sadri Ferati, Rita Hajzeraj, Teuta Sahatqija, Lirije Kajtazi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Afërdita Berisha, Vjosa Krasniqi, të gjithë keni votuar kundër vendimit për aprovimin e buxhetit për rritjen e pagave për mësimdhënësit kosovarë për policët kosovarë, për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës, dhe për të gjitha kategoritë që tjera që ua përmenda. Urdhëro, ky është procesverbali i votimit, për vendimin kur është marrë për rritjen e pagave për mësimdhënësit të buxhetit të vitit 2011.

Prandaj të jemi korrekt, të jemi të sinqertë dhe transparent me opinionin publik, keni votuar edhe kundër rritjes së pagave për mësimdhënësit e lere që keni menduar për stazhin e mësimdhënësve. Faleminderit!. Ky është dokument shtetëror, nuk është një dokument imi, është dokument i Kuvendit të Republikës së Kosovës që udhëheq këtë proces të votimit, nga akademik i nderuar, zoti Hamiti.

KRYETARI: Replikë, Naser Osmani e ka fjalën.

(Reagime)

NASER OSMANI: Kryeministër, nuk është as institucionale as rregull për t' u manipuluar masa nëpërmjet mundësisë të daljes në foltore që ua lejon Rregullorja sa herë që ju të doni. E vërteta është që ne kemi votuar, dhe a e ke parë sa kompakt kemi votuar, krejt jo, por jo i kemi thënë buxhetin të cilin ti e ki pru në këtë Parlament, por jo ne nuk e kemi votuar parcialisht çështjen e rritjes të pagave, por buxhetin edhe le ta dijë ky millet që ne kemi qenë kundër politikave buxhetore që ti ke ofruar në këtë Parlament dhe kjo është e vërteta, e jo ajo që ju e prezantoni.

KRYETARI: Unë e kam një kërkesë.

(Reagime)

Pra, po ju pyes juve, a doni të zhvillohet debat, a doni të kalojmë veç në replikë? Po atëherë, ju lutem, e vazhdojmë debatin. Regjia, fjalën kryeministrit

KRYETARI: Fjalën e ka kryeministri Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari Hamiti, ne duhet ta respektojmë procedurën dhe natyrisht Rregulloren e punës së Kuvendit dhe ju e dini se si funksionon, por natyrisht se duhet ta respektojmë edhe kur na konvenon edhe kur nuk na konvenon, prandaj respektoje. Është çështje e jote, ju e keni votuar personalisht ke votuar kundër, qe ku e ke emrin që e prin po edhe një herë e ritheksoj është me rëndësi që natyrisht zhvillojmë debat, por unë ju ftoj për përkrahje që kjo çështje të rregullohet përmes ligjeve dhe jo me rekomandime, jo po e them, por do ta them edhe njëqind herë derisa te kryejmë.

Në anën tjetër vendimi i Qeverisë është, është në fazën e fundit implementuese. Ju ftoj që të na mbështetni edhe në projektet tjera që i kemi, do të thotë për njohjen e stazhit për të gjithë punëtorët kosovarë nga viti 1990 deri në vitin 1999. Sa i përket pagave, e theksoj

edhe një herë a keni votuar në mënyrë unike a jo, këtu është lista unë nuk dëshiroj tash t'ua lexoj ju e dini vet, nuk jeni bash unik dhe ju e dini shumë mirë, ndërsa e theksoj edhe një herë nëse bëjmë krahasime çfarë ju po dëshironi t'i bëni, shikoni vendimet që i keni marrë deri në vitin 2007 dhe vendimet që kemi marrë ne. Asnjë vendim nuk e keni që e keni marrë për rritjen e pagave për mësimdhënësit kosovarë. Prandaj vendimet tona janë shumë të fuqishme, kur ka qenë momenti për të votuar për rritjen e pagave për të gjithë për mësimdhënësit, për pjesëtarët e FSK-së, shërbyesit civilë, punëtorët e shëndetësisë, invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve, ja ku e keni dokumentin, keni votuar kundër. Ne do t'i marrim vendimet tjera tash për rritjen e pagave për punëtorët kosovarë, ju ftoj të votoni për. Faleminderit, zoti Hamiti.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Lumnije Morina.

LUMNIJE MORINA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuari kryeministër,

Ministër,

Të nderuar deputetë,

Nuk është hera e parë që në Kuvendin e Kosovës debatohet për problemin e pensionistëve të Kosovës, më saktësisht për pensionet e pensionistëve të Kosovës, e ku nuk është prekur edhe problemi i atyre pensionistëve të cilëve nuk ju njihet stazhi apo përvoja e punës për periudhën kohore 1990-1999. Debatet lidhur me këtë problem, mendoj se ka ndikuar që problemi i pensionistëve të Kosovës, të trajtohet me Ligjin për pensionet e financuara nga shteti.

Rregullimi me ligj i problemit të pensionistëve, të punëtorëve të arsimit shqiptarë të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990-1991 deri në vitin shkollor 1998-99, është minimumi që ne duhet të bëjmë për këta punëtorë në këtë moment. Ata e meritojnë të trajtohen në mënyrë të dinjitetshme, sepse ata kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në ruajtjen e vazhdimësisë në arsimimin dhe edukimin në gjuhën shqipe ku i njëjti ishte ndaluar nga regjimi pushtues serb.

Punëtorët e arsimit e organizuan dhe e zbatuan procesin e arsimimit dhe edukimit mbi baza kombëtare dhe i refuzuan plan-programet nënshtruese serbe. Ata u ndoqën dhe pësuan në mënyra të ndryshme nga regjimi serb mu për shkakun se nuk iu nënshtruan atij regjimi. Ata shpeshherë punuan edhe pa pagesë dhe ishin të gatshëm të sakrifikonin gjithçka vetëm për ta mbajtur gjallë arsimimin shqip në Kosovë, ndërsa sot ata janë në pozita diskriminuese, sepse nuk mund ta gëzojnë pensionin si pensionist kontribut dhënës por pensionin e pleqërisë njësoj sikurse të gjithë qytetarët tjerë që nuk e kanë dhënë asnjë ditë pune, por që e fitojnë të drejtën e pensionit vetëm në bazë të moshë së pleqërisë. Mendoj se është momenti i fundit pra që vendimi i 15 majit i Qeverisë, domethënë i vitit 2008, të nisë të zbatohet, dhe në fund dua ta përsëris prapë atë që e kam thënë njëherë për këtë kategori të nderuar të qytetarëve të Kosovës, se për ta kryer ashtu si duhet obligimin tonë institucional, shtetëror dhe kombëtar, ndaj kësaj kategorie të nderuar të shoqërisë sonë, atyre duhet t'ju njihet stazhi, përvoja e punës e benificuar, po e përsëris edhe një herë e benificuar për periudhën kohore 1990-1999, sepse me këtë veprim ne jo vetëm do

ta nderojmë dhe respektojmë këtë kategori të nderuar të shoqërisë sonë, por do t'i nderojmë edhe institucionet tona, shtetin edhe kombin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Sot pas 23 vjetëve që nga fillimi i rezistencës gjithë populllore kundër regjimit të Milosheviqit, që për 10 vjet u zhvillua në mënyrë paqësore dhe në vitin '98/'99, në rezistencë të armatosur në një luftë të drejtë, në mes të forcave të pabarabarta, është për të ardhur keq që Kuvendi i Republikës së Kosovës diskuton një diskriminim që i është bërë tash e 14 vjet të pasluftës ndaj një shtrese të punëtorëve që u angazhuan gjatë 10 vjetëve të rezistencës kundër aparitit ndaj popullit shqiptar.

Nuk ka dyshim se diskriminimi më së shumti i goditi punëtorët e arsimit të cilët e dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm për organizimin e jetës publike në atë kohë, e ku frytet e punës së tyre i vjelim edhe sot.

Shumë edhe nga ne sot që jemi prezent, jemi produkt i një sistemi arsimor të organizuar po nga këta punëtorë të arsimit që e mbrojtën me gjithë qenien e tyre këtë sistem publik, i cili kontribuoi shumë në sferën e publike që ishte në kohën e okupimit nga kolonia e Milosheviqit. Është neveritëse sot, të gjitha qeveritë e deritashme, duke vënë në tekst qeveritë e dy mandateve të fundit, nuk kanë bërë asgjë, e përkundrazi në këtë veprim pasiv diskriminuan punëtorët e arsimit e të shëndetësisë duke mos ua njohur stazhi i punës gjatë viteve të 90-ta. Kjo mosnjohje jo vetëm se është poshtëruese, por është edhe përdhosje e sakrificës të këtij populli të cilit vuajtjet nuk i pushuan ende nga ballafaqimi me aparatit e gjenocidit serb. Edhe sot ky aparat nuk i ndali ambiciet për të përdorur çdo metodë vetëm e vetëm për të defunksionuar shoqërinë tonë duke i depopulluar territoret shqiptare për të kurorëzuar të gjithë këtë në një proces të padrejtë të negociatave që kanë për qëllim copëtimin e tokës së Kosovës.

E gjithë kjo shprehet në një neglizhencë të qëllimshme të cilën e shfaq Qeveria ndaj qytetarëve të vet. Stazhi i punës nuk është asgjë tjetër përveç se pjesë fundamentale e së drejtës në punë, që është kategori e të drejtave elementare të njeriut e mbrojtur edhe me konventa ndërkombëtare.

Stazhi i punës është historiku i punës si mjet kryesor dhe legjitim i çdo qytetari për të siguruar mirëqenien në bazë të të cilit qytetari i lind e drejta me një përkujdesje shoqërore si rezultat i jetës së tij të dinjitetshme të sajuar me punë, e drejta në punë, si e drejtë e kategorisë së të drejtave elementare, nuk shkelet dhe nuk cenohet vetëm me veprime konkrete, por botërisht dihet se deri te shkelja vjen edhe si pasojë e mohimit të asaj të drejte.

Zaten mohimi i një të drejte është edhe më i rëndë se shkelja e saj ngase me mohim ajo nuk njihet fare dhe mohimi ka karakter absolut në raport me të drejtën e cila është mohuar, përderisa të shkelja kemi një relativitet në raport me të drejtën në fjalë. Sot mosnjohja e kësaj të drejte është ekuivalente me mosnjohjen e Serbisë dhe trajtimin e

njëjtë të punëtorëve të arsimit dhe shëndetësisë që e bënte gjatë viteve të 90-ta. Ne mendojmë që është shumë e rëndësishme që me ligj të veçantë të njihet stazhi i të gjithë atyre që kontribuuan në kuadër të jetës publike të dalë nga referendumi i 18 dhe 19 tetorit 1991, ku populli i Kosovës shprehu qartë determinizmin e vet. Pra, mendoj që kjo çështje duhet të rregullohet për të gjitha kategoritë duke përfshirë këtu edhe ata shëndetësorë të cilët u angazhuan nëpër ambulanca që vepronin në kuadër të shoqatës humanitare “Nëna Terezë”, e që gjatë gjithë kësaj periudhe ofruan shërbime e kujdes shëndetësor për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Pra, meqë po diskutojmë për periudhën e njëjtë, duhet të shtohet edhe një rekomandim i cili përfshin edhe punëtorët shëndetësorë, pasi që lënie anash pra jashtë rregullimit ligjor të punëtorëve shëndetësorë nga e drejta në njohje të stazhit për periudhën e viteve të 90-ta, është diskriminuese dhe e padrejtë, kjo ngase ne këtu nuk jemi duke e zgjedhur problemin, por vetëm jemi duke ia transformuar formën. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Kymete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot do të fokusohem në çështjen të cilën në njërën nga seancat e kam ngritur si çështje dhe nuk kam marrë përgjigje nga Qeveria edhe pse sot kryeministri u mundua të japë përgjigje. Pse vendimi i kryeministrit i datës 15.5.2008, nuk u zbatua për njohjen e stazhit të punëtorëve arsimorë për vitin 90-99? Cila nga ministratë nuk e zbatuar vendimin e kryeministrit dhe nuk i ka filluar procedurat për realizmin e këtij vendimi, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale apo Ministria e Arsimit e cila ishte e obliguar që ta zbatonte këtë vendim?

I kujt është faji? I mësimdhënësve jo, sepse ata i kanë besuar vendimit të kryeministrit. Sot në Kuvend po debatojmë për çështjen e cila është dashur të debatohet në vitin 2008. Kjo vonesë prej 5 vjetësh ka shkaktuar pasoja ekonomike dhe emocionale tek ata të cilët përplot 9 vjet kontribuuan dhe mbajtën gjallë shpirtin e këtij populli, sakrifikuan dhe krijuan optimizëm për rezistencë aktive. Kërkoj nga kryeministri dhe ministrat e Kabinetit qeveritar që të jenë më të përgjegjshëm kur të marrin vendime dhe t’i zbatojnë ato, sepse vendimi i datës 15.5.2008, nuk është vendimi i vetëm i kryeministrit i cili nuk është zbatuar. Vendimi numër 01/151, i datës 6.1.2011, të zbatohet në plotëni për pagesën e ndryshimit të dy pagave të cilat Qeveria iu ka mbetur borxh mësimdhënësve.

Sistemi arsimor i viteve ‘90-‘99 është zhvilluar në pajtim me plan-programet mësimore sipas ligjeve dhe Kushtetutës. Andaj, në bazë të kësaj, Kuvendit i rekomandojmë që mësimdhënësve dhe personelit të punësuar në arsim t’i njihet stazhi i punës nga viti shkollor 1990 deri në 1999 dhe të obligohet Qeveria e Kosovës të nxjerrë akt ligjor për zbatimin e këtyre rekomandimeve. Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Emin Gërbeshi.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryetar!

Unë mbështes rekomandimet e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe këtë debat që po bëhet sot rreth njohjes të stazhit të punës për arsimtarët nga viti 90-91 deri në 89-99, por shpreh gjithashtu shqetësimin tim se tani 14 vjet pas luftës, bisedojmë për një çështje e cila është dashur të rregullohet shumë më herët, sepse vitet e 90-ta, ne e dimë që kanë qenë vite të sakrificës dhe në mesin e atyre që kanë sakrifikuar më së shumti janë arsimtarët, profesorët që kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në mbajtjen e arsimit shqip dhe në avancimin e vlerave të arsimit.

Megjithatë, dëshiroj të flas pak fjalë edhe rreth vendimit të Qeverisë dhe të them se nëse Qeveria ka marrë një vendim në vitin 2008, dhe një vendim i tillë nuk është zbatuar, dëshmon se Qeveria është jo shumë serioze, Qeveria jo për të parën herë nuk respekton vendimet e veta, dhe na dëshmon edhe një herë se asnjë çështje, madje siç është çështja e arsimit, por edhe çështjet tjera, nuk merren me krejt seriozitetin dhe nuk merren ashtu si duhet të merren.

Megjithatë unë shpresoj se pas këtij debati dhe pas votimit të këtyre rekomandimeve, Qeveria do të detyrohet ta zbatojë vendimin e vetë pra që e paska marrë, e unë nuk kama qenë i njohur për këtë dhe shpresojmë se vendime të tilla kur merren edhe duhet të respektohen. Edhe një herë them që ky debat duhet t'i kontribuojë asaj që të arrihet efekti pozitiv, nuk më pëlqeu paraqitja e tillë e kryeministrit i cili u mundua t'i ikë përgjegjësisë së vet dhe u mundua ta degradojë debatin, megjithatë po them që ka vlera pozitive ky debat dhe po dëshmon edhe një herë se Parlamenti po e kryen në përgjithësi detyrën e vet. Prandaj, do ose nuk do Qeveria duhet të obligohet që t'i kryejë detyrat me përgjegjësi. Faleminderit!

KRYETARI: Bahri Thaçi, urdhëro, e ke fjalën.

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryetar i Parlamentit!

Tash unë dua t'ia ndërroj pak diskutimin tim pas fjalës kryeministrit për hir të opinionit, sepse këtu e kam Ligjin për pensionet e financuara nga shteti ku neni 8 thotë: "Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontribut-pagues të moshës. Të drejtën në pension kontribut pagues të moshës i realizojnë të gjithë personat të cilët kanë mbushur moshën 65 vjeçare. Dua të ketë së paku 15 vjet stazh pensional para datës 1.1.99 e cila së paku 7 vjet e 7 muaj të jenë stazh pune në Republikën e Kosovës.

Po ofrojmë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor numër 011-24/83, Gazeta Zyrtare e Krahinës socialiste Autonome e Kosovës, numër 2683 para datës 1.1.99, dhe kjo tash na krijoi pak një huti me ligjin i cili thoni se është aprovuar me 15.5.2008 dhe asnjëherë nuk është vu në funksion. Gjithashtu këtu sot kemi debatin lidhur me statusin për punëtorë të arsimit, por nuk janë vetëm punëtorët e arsimit, por janë edhe punëtorë të tjerë si punëtorë shëndetësisë shqiptare, të administratës, shërbyes civilë e tjerë që u përmenden sot gjatë diskutimit. Andaj mendoj se me të drejtë është që ky debat të jetë debat për statusin e pazgjidhur të punëtorëve kosovarë të larguar me dhunë apo të përjashtuar si tepricë teknologjike nga '90 deri në vitin '99. Këto padrejtësisht nuk janë përfshirë në skemën pensionale të financiar nga shteti në Grupin e kontribut-paguesve.

Vetë fjala “kontribut- pagues” dhe “jokontribut-pagues” e ofendon shumë këtë kategori. Ndoshta, dikush mund t’i akuzojë se nuk janë kontribut- pagues. Vërtet, ata nuk kanë qenë kontribut- pagues për xhepin e vet, por për shtetin e Kosovës kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm, për të cilin kontribut duhet t’u jemi gjithmonë mirënjohës.

Pas luftës, disa vite ka funksionuar ndarja lineare e pensioneve, për të cilën unë me të drejtë kisha thënë, nuk kanë qenë pensione, por kanë qenë ndihma sociale dhe, mendoj se kjo ndarje ka qenë e drejtë, sepse nuk ka ekzistuar fondi pensional. Pas disa vitesh u bë ndarja në kontribut-pagues dhe jokontribut-pagues. Mendoj se në atë kohë ministër ka qenë Ahmet Isufi dhe mendoj, që mundet t’i japë sot një shpjegim këtij Parlamenti, se përse ka ndodh kjo kështu.

Do të thotë, pas disa vjetësh u bë ndarja në kontribut- pagues dhe jokontribut-pagues, ku edhe u bë shkelje e rëndë ligjore ndaj kësaj kategorie. Kjo ndarje do të ishte normale, sikur të ekzistonte ai fond i kontribut- paguesve në vendin tonë, por ku është sot ai fond? Ai fond është vjedhur nga Serbia dhe padrejtësisht mbahet atje e ne padrejtësisht i ndajmë pensionistët në kontribut-pagues dhe jokontribut-pagues.

Dihet botërisht se në vitet ‘90 - ‘99 nga shteti serb është shkelur çdo e drejtë e qytetarit jo serb të Republikës së Kosovës, që nga fëmija në bark të nënës e gjer te plaku më i vjetër, në mënyrë më brutale është shkalur çdo e drejtë të punësuarve, që me dhunë nxirreshin nga vendet e punës. Në atë kohë u imponua dhe LDK-ja organizoi jetën institucionale në çdo segment. Ishte një shembull unik në botë, ku me gjithë këta njerëz që u përjashtuan nga puna, u ndërtuan institucionet paralele. Këto institucione funksionuan në mënyrë perfekt për kohën.

Andaj, këtyre njerëzve ne u kemi obligim moral, po në radhë të parë ligjor, që ato vite të mos ua shpallim vite të humbura, sepse të gjithë ne e dimë dhe e gjithë bota e din, se ato vite ishin vite të lavdishme të shtet ndërtimit të Kosovës.

Sot këta njerëz nuk kërkojnë shumë nga ne, nuk kërkojnë shumë edhe nga shteti, që ndërtuan, janë modest dhe kërkojnë tepër pak. Kërkojnë që mos t’u themi se nuk janë kontribut- pagues gjatë viteve ’90-‘99 dhe t’u numërohet stazhi i punës për vitet ’90-‘99. Nëse nuk e bëjmë këtë, i diskriminojmë edhe njëherë, por sot ata lëndohen shumë më tepër.

Që të mos diskutojmë në një seancë tjetër për këto kategori, kërkoj që në rekomandime të shtohet edhe një pikë - të zgjidhet statusi i pazgjidhur i të gjithë punëtorëve kosovarë, të larguar me dhunë apo të përjashtuar si tepërc teknologjike gjatë viteve ’90-‘99. Kërkoj dhe i lus deputetët, që rekomandimet e Grupit Parlamentar të LDK-së, t’i votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Salihe Mustafa e ka fjalën

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!
Përsëndetje për ministrin!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk kam përgatitur diçka të them, sepse shumica u tha nga kolegët. Por, e çmoj kontributin e punëtorëve të arsimit si të gjithë ju, pajtohem, sepse ata meritojnë shumë, por unë e mora fjalën për të sqaruar se gjatë shqyrtimit të Ligjit për pensionet e financuara nga shteti në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë dhe duke e ditur edhe vendimin e Qeverisë për njohjen e stazhit të punëtorëve të arsimit, ne në Komision kemi shtuar një paragraf të ri nën 8, kemi shtuar paragrafin 5, i cili thotë: “E drejta dhe përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për pension kontribut-pagues të moshës, për punëtorët e Kosovës të larguar me dhunë nga puna, apo të shpallur si tepricë teknologjike pa bazë ligjore në vitet 1989 deri më 31 korrik 2002, do të rregullohet me akt ligjor apo nënligjor të veçantë, deri më 1 korrik 2014”.

Dua të cek, ne kemi shtuar edhe 3 vjet prej ‘99-ës deri në vitin 2002, kur ka filluar të funksionojë fondi i kursimeve pensionale, jemi kujdesur që të mos mbetet edhe ajo periudhë pa mbulesë. Kështu që, duke pasur parasysh kontributin e punëtorëve të arsimit, ne kemi pasur parasysh edhe kontributin e të gjithë punëtorëve të Republikës së Kosovës, të larguar në mënyrë të paligjshme në ato vite.

Unë e mora fjalën vetëm sa për të sqaruar këtë. Projektligji për pensionet e financuara nga shteti ka kaluar në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, tani është në komisionet e përhershme në shqyrtim dhe do të vijë prapë para nesh e atëherë ju ftoj që ta votojmë dhe me ligj t’ua njohim të drejtat të gjithë këtyre punëtorëve. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk Konjufca e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Siç dihet, më 23 mars 1989 Kosovës do t’i suprimohet me dhunë autonomia, liritë dhe të drejtat e kufizuara, që ata i gëzonin në bazë të kësaj autonomie. dhe për Kosovën do të vinte një dekadë aparteidi dhe shqiptarët e Kosovës do të largoheshin nga çfarëdo sistemi, arsimor, shoqëror, kulturor, shëndetësor, do të ndalohej përdorimi i gjuhës shqipe, ata do të përjashtoheshin nga vendet e tyre të punës, do të largoheshin nga institucionet arsimore, do të mbylleshin mjetet e informimit, qoftë ato të shkruara apo vizuale.

Gjatë këtyre viteve nën aparteid dhe në këto kushte të tmerrshme për mbijetesë, shqiptarët prapë nuk do të dorëzohen para Serbisë, ata megjithatë, do të arrijnë të krijojnë një sistem paralel dhe pse i kufizuar, pothuajse vetëm në shtyllën e arsimit dhe shëndetësisë.

Megjithatë, vitet kalonin e jeta po bëhej gjithnjë e më e vështirë dhe të ekspozuar ndaj këtyre rrethanave me mijëra shqiptarë do të braktisin Kosovën në kërkim të një jete më të dinjitetshme për qenien njeri.

Edhe në këto kushte dhe rrethana shqiptarët ditën të organizoheshin për të mbijetuar, në radhë të parë, por në të njëjtën kohë për të organizuar sistemin paralel të arsimit e të

shëndetësisë. Ky organizim arsimor, ku shtëpitë u bënë shkolla, mundësuan që gjenerata të tëra të rinjve të mos mbesin analfabetë. Ata punuan pa pagesë dhe të rrezikuar në çdo moment nga ndërhyrja e policisë dhe paramilitarëve serë, u organizuam por edhe mbijetuam.

Ndërsa, shëndetësia u organizua nëpërmes shoqatës “Nënë Tereza”, të cilat kanë funksionuar në tërë territorin e Kosovës. Edhe pse në kushte të rënda, pa objekte të mira spitalore e as ambulanca, arritëm që popullsisë në ato kushte t’i ofrojmë shërbime shëndetësore deri në fillimin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne i përkrahim këto iniciativa dhe këto rekomandime, por kërkojmë që në këto rekomandime të përfshihen edhe punëtorët shëndetësorë të cilët kanë qenë të angazhuar gjatë këtyre vjetëve. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Gjatë dekadës së fundit të shekullit 20, kur nacional shovinizmi serb ndërmoi masat më radikale ndaj popullit shqiptar, në Kosovë dhe ish- Jugosllavi në tërësi, përmes suprimimit formalo-juridik të rendit kushtetues të Kosovës, duke dëbuar nga puna me qindra mijëra punëtorë shqiptarë, duke detyruar që të shpërngulen në shtetet e Evropës Perëndimore me qindra mijëra të tjerë, punëtorët të arsimit të Kosovës vendosën t’i kundërvihen politikës hegjemoniste serbe, duke organizuar sistemin e arsimit në gjuhën shqipe.

Të gjithë aktorët e këtij sistemi duke filluar nga rektori, dekanët, drejtorët e shkollave, profesorët, arsimtarët, mësuesit, studentët, nxënësit, personeli administrativ e deri te punëtorët ndihmës teknik, vendosën që të mos i zbatojnë ligjet ilegale antishqiptare të politikës serbe, duke zbatuar dhe respektuar me vite të tëra vetëm ligjet dhe vendimet e organeve legjitime dhe legale të Republikës së Kosovës.

Në këtë mënyrë sistemi arsimor i viteve të ‘90-ta, jo që paraqet gurthemelin, por vërtet është bazamenti i fortë dhe i qëndrueshëm mbi të cilin do të vendoset shteti i sotëm i Republikës së Kosovës.

Ngjarjet më të rëndësishme, për të mos thënë përcaktuese për themelimin e sistemit të arsimit në gjuhën shqipe, u zhvilluan në vitin 1990, kur pas suprimimit formal të Kushtetutës së Kosovës, organet e atëhershme të Kosovës si Dhoma e Bashkuar e Kuvendit të Kosovës, Enti Pedagogjik i Kosovës, vendosën që për vitin 1990/91 të zbatohen planprogramet e hartuara në Kosovë e jo plan-programet e imponuara nga Serbia, të cilat ishin diskriminuese, sikurse për nxënësit dhe studentët shqiptarë, ashtu edhe për tërë popullatën shqiptare që jetonte në Kosovë.

Pas vendimit të organeve të Kosovës, që të mos i pranojnë ndryshimet e dhunshme dhe antikushtetuese të Serbisë, Serbia ndërmerr masa dhe ligje tjera represive. Kështu, me aprovimin e Ligjit për rrethana të veçanta që është një ligj diskriminues dhe antikushtetues, Serbia krijoi bazën e kundërligjshme juridike, për dëbimin e punëtorëve shqiptarë nga puna dhe suprimimin e të gjitha institucioneve të sistemit të arsimit shqip.

Në një situatë të tillë tejte të rëndë, në gushtin e vitit 1990 sistemi i arsimit në Kosovë ndahet në dy sisteme: në atë serb dhe në atë shqiptar. Kjo ndarje në dy sisteme u bë pas presionit dhe diktatit të politikës hegjemoniste serbe, në njërën anë dhe vendosmërisë së arsimtarëve dhe popullit shqiptar në përgjithësi, për ta mbrojtur pavarësinë e arsimit dhe shkollës shqipe në Kosovë.

Rezistenca aktive e arsimit shqip, kushtimisht thënë, ndikoi në përshpejtimin dhe sforcimin e dhunës së politikës serbe mbi arsimin shqip, duke zbatuar masa të shumta administrative, pastaj masat e dhunës policore-ushtarake duke thelluar diskriminimin racor dhe aparteidin në Kosovë. Kështu, gjatë vjeshtës së vitit 1990 shteti serb filloi t'ua ndalte të ardhurat personale personelit arsimor nëpër shkollat shqipe në Kosovë e pastaj edhe të dëbonte nxënësit dhe arsimtarët e shkollave të mesme dhe fillore në Kosovë, si dhe të dëbonte udhëheqësit dhe personelin e institucioneve edukative-arsimore në gjuhën shqipe e në vend të tyre silleshin drejtorë të dhunshëm serbë nga Beogradi.

Faktikisht, deri në gjysmën e vitit 1991 afro 20 mijë arsimtarë shqiptarë mbetën pa pagat e tyre mujore, pra mbetën pa mjetet për ekzistencën minimale për jetesë.

Në fillim të vitit akademik 1991/92 të gjithë profesorët dhe studentët e Universitetit të Prishtinës, arsimtarët dhe nxënësit që punonin dhe mësonin e studionin në gjuhën shqipe, u dëbuan nga objektet e tyre universitare dhe shkollore. Ishte ky një veprim i kundërligjshëm dhe kundër kushtetues, që zbatohet në një vend evropian në fund të shekullit XX, sepse siç dihej arsimi fillor edhe sipas vetë ligjeve serbe, ishte i obligueshëm. Kështu, shkollat dhe Universiteti i Kosovës u shndërruan në pengje politike, në duar të regjimit politik të Serbisë dhe ish-Republikës Federale të ish-Jugosllavisë.

Në një situatë të këtillë, personeli i arsimit shqip, si rrugëdalje dhe zgjedhje të vetme gjeti vazhdimin e procesit mësimor nëpër shtëpi private. Vërtet, populli ynë tregoi në vepër solidaritetin për mësimin shqip, duke hapur dyert e shtëpive, odave, lokaleve dhe objekteve tjera, për nevojat e mësimin shqip, për çka meritojnë një falënderim jo vetëm të këtij Kuvendi dhe të gjitha institucioneve kosovare, por edhe nga gjithë populli shqiptar kudo që ndodhet.

Nga nëntori i vitit 1991 deri në shkurt të vitit 1992 të gjitha shkollat fillore, të mesme dhe fakultetet e Universitetit të Prishtinës filluan procesin mësimor sipas planprogrameve në gjuhën shqipe që zhvillohej kryesisht nëpër shtëpi private.

I tërë ky angazhim dhe kjo sakrificë e arsimtarëve shqiptarë kishte një qëllim kryesor, që të mos shuheshin vatrat e arsimit dhe edukimit në gjuhën shqipe, që fëmijëve dhe të

rinjve kosovarë edhe në kushte tejte të rënda t'u ofrohej dija, arsimi dhe edukimi. Me këtë ritëm, në rrethana shumë të rënda, me pagesa simbolike, nën presionin e dhunës dhe terrorit të regjimit ushtarako-policor serb, arsimtarët kosovarë punuan deri në fillimin e vitit 1999.

Gjatë kësaj periudhe janë vrarë, rrahur, maltretuar, burgosur dhe dënuar në forma të ndryshme me qindra arsimtarë dhe studentë kosovarë. Andaj, duke pasur parasysh kontributin, angazhimin dhe sakrificën e arsimtarëve shqiptarë gjatë viteve të '90-ta, në mbajtjen në jetë të arsimit shqip në arsimimin dhe edukimin e brezave të rinjve në kushte dhe rrethana të rënda ekonomiko-politike, pastaj kontributi në vetëdijesimin dhe mobilizimin e popullit shqiptar për rezistencën dhe vetëmbrojtjen, në ruajtjen dhe shpëtimin e substancës kombëtare në Kosovë, si dhe në vënien e bazamentit të shtetit të sotëm të Kosovës, përkrahu rekomandimet e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e në veçanti përkrahu përgatitjen dhe aprovimin e Ligjit të veçantë për statusin e punëtorëve të arsimit shqip në Kosovë nga viti 1990-1999, me të cilin ligj statusi i punëtorëve të arsimit do të Faleminderit të barazohet me statusin e personave të merituar në formimin dhe ndërtimin e shtetit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nënkyetar, e do fjalën? Fjalën e ka Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Nuk është mirë ta bëjnë Kuvendin miting. Mitingashët profesionistë e dinë, që ai që e sundon tavolinën e mikrofonit e sundon masën. Ne këtu jemi në Kuvend, kemi Rregullore.

Ajo që unë ju sugjerova ty dhe interpretuesve tuaj që i ke pranë, desha t'ju them që çdo deputet me Rregulloren tonë, kur e kërkon fjalën për punë të zbatimit të Rregullores e merr fjalën. Kaq! Le të jetë për hera tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuari kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Siç e tha edhe kryeministri i Kosovës, se ka një vendim të Qeverisë së Kosovës, marrë më datë 15 maj 2008, për respektimin e stazhit të punës të gjithë mësimdhënësve dhe stafit të tij, për periudhën 1990-1999. Me këtë vendim punëtorëve të arsimit, iu ka njohur në fakt statusi i personave të merituar, në formimin dhe ndërtimin e shtetit të Republikës së Kosovës.

Konsideroj, se edhe iniciativa e LDK-së në këtë drejtim për të bërë një ligj sa më shpejtë, duhet përshëndetur.

Mësimdhënësit kosovarë ishin shtyllë e rezistencës sonë kundër ish-regjimit okupues të Beogradit. Shumë prej tyre më pas ishin pjesë aktive e luftës sonë për liri. Një pjesë ranë

edhe dëshmorë gjithkrah fronteve të Kosovës. Ata ajanë heronj dhe heroina të kësaj lufte dhe të gjitha përpjekjeve tona për liri e pavarësi.

Të nderuar deputetë, unë do të propozoja këtu, që krahas këtij ligji të procedojmë edhe me ligje e iniciativa tjera për njohjen e statusit meritore edhe të disa kategorive tjera të shoqërisë sonë edhe shumë personave që po ashtu konsideroj se janë meritore për rrugën tonë të vështirë e plotë sakrifica, deri te shteti dhe liria.

Secili që nuk iu nënshtroi regjimit të Serbisë pushtuese është meritore më vete për luftën dhe përpjekjet tona. Andaj, duke iu referuar edhe rekomandimeve që dalin nga Komisioni Parlamentar për Financa Publike dhe nga Komisioni Parlamentar i të Drejtave të Njeriut, konsideroj që ne duhet të procedojmë pa humbur kohë edhe shumë projektligje për njohjen apo pranimin e përvojës së punës për të gjitha kategoritë e shoqërisë sonë, që ishin pjesë e administratës publike të Kosovës.

Këtu do të duhej përfshirë të gjithë ata punonjës fabrikash apo të gjitha organizatave publike, të cilët dhunshëm u nxorën nga puna në fillim të viteve të 90-ta, kur regjimi okupues i Beogradit instaloi masat e dhunshme në Kosovë. Këto masa u ndërmorën edhe ndaj pjesëtarëve të policisë së Kosovës dhe shumë të tjerë, që vetëm pse nuk i njohën masat dhunshme të Beogradit, humbën vendet e tyre të punës.

Njëjtë propozoj që përvoja e punës në këtë periudhë t'u njihet nga shteti ynë edhe të gjithë eprorëve ushtarak shqiptarë, që pas shpërbërjes së ish- Jugosllavisë nuk pranuan dhe nuk morën pjesë në luftërat dhe krimet kundër popujve jo serbë në ish -Jugosllavi përgjatë gjithë dekadës së fundit të viteve të 90-ta.

Propozoj po ashtu, që t'u njihet status i veçantë edhe të gjithë kontribut-dhënësve që financuan arsimin në Kosovë, siç janë mërgimtarët tanë, pa të cilët nuk do të ishte i mundur zhvillimi i arsimit shqip në Kosovë.

Mendoj se këto do të ishin iniciativat e duhura, sepse jo vetëm një kategori e vendit tonë është meritorë për lirinë dhe shtetin, aty hyjnë të gjithë. Dhe, jam dakord që të procedohet me Ligjin për mësimdhënësit shqiptarë qysh tani, por që të mos harrohen po ashtu edhe këto kategoritë tjera, këta njerëz të fuqishëm, të ndershëm e të panënshtuar kurrë ndaj ish- regjimit. I tërë kombi ynë ishte rezistencë më vete, secili nuk iu nënshtroi Serbisë dhe humbi vendin e tij të punës, është meritore që t'i njihet përvoja e periudhës nga viti 1990-1999. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri Ramë Buja e ka fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së që ka ngritur këtë çështje, unë kam falënderime për të gjithë, për debatin që u zhvillua gjer më tani dhe besoj, është shumë kontribut-dhënës dhe besoj

edhe ky që të pasojë mbas, do të jetë po kështu dhe nuk e besoj që ka debat që nxjerr të këqija, por nxjerr të mira në shesh. Edhe ky, gjithsesi do të nxjerrë të mira në shesh.

Dhe, unë do të përpiqem që të mos flas hiç me politikë dhe hiç me patetikë, do të flas sot me argumente duke mos dashur që ju të vazhdoni, në kuptimin pozitiv të fjalës ma merrni, për të thënë gjëra të cilat tanimë po thuaj janë bërë, sepse unë po ju them që Projektligji për këtë kategori 90-99 të arsimtarëve, pothuajse është gati dhe do të procedohet për Qeveri.

Kështu që, si punë e tillë unë nuk desha t'ju ngas e t'ju prish rendin e diskutimit, por ajo së shpejti do vijë në Qeveri dhe kjo gjë do të rregullohet me ligj, jo me asnjë rekomandim të caktuar.

Është një e vërtetë po kështu, që këtë kategori të arsimtarëve dhe këtë listë të arsimtarëve të 19 komunave, jo të gjitha komunave, e kemi përcjell tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, por nuk është faji atje, sepse në fakt ligji s'ka përcaktuar se si do të definohet kjo gjë.

Unë po ju them që kjo kategori e mësimdhënësve, pa dalluar nivelet, unë po dua më fal se s'e kam hiç zakon, por po e citoj veten, në raste të caktuara ju kam thënë: "jeni liri bërës". Dhe s'e kam thënë rastësisht, sepse në fakt këtu ka në sallë arsimtarë, të cilët kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm. Vetë kam qenë njëri nga arsimtarët e asaj kohe dhe natyrisht, që këta arsimtarë kanë bërë ata djem dhe vajza, të cilët kanë lënë jetën, kokën për lirinë e Kosovës.

Dhe, të thuhet tash për shembull, se janë arsimtarët skajshmërisht të përbuzur, më besoni është jokorrekte dhe fyese për ta, të thuhet se janë të diskriminuar, po kështu është fyese, po të thuhet se s'kemi bërë boll për ta dhe duhet të bëjmë akoma më shumë, shumë korrekte, tepër korrekte. Dhe, po ju them sinqerisht, jetësisht jam i interesuar si ministër, Ministria e Arsimit, dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, që jo vetëm për këtë kategori, por të bëjë për të gjitha kategoritë, që vërtet kanë qenë meritore që kanë mbajtur jetën gjallë, por në veçanti mësuesit, për faktin që e dimë bashkë, sepse ata na i kanë mbajtur fëmijët aty ku duhet mbajtur, i kanë pajisur me njohuri që duhet pajisur dhe natyrisht, unë e them pak me shaka, por ma merrni për të drejtë, se kemi luajtur shkollash, por kemi luajtur mirë.

Mos harroni një gjë, studentët tanë që i kanë mbaruar fakultetet po këtyre podrumëve dhe kauçëve të ndryshme, sot kanë rezultate të jashtëzakonshme në universitetet më prestigjioze të botës. Unë po ju them veç një shembull, kam qenë në Universitetin e Kembrixhit dhe kur i kam përmendur studentët tanë me emra, të cilët kanë qenë aty, më besoni profesorët janë ngritur në këmbë me shumë respekt.

Andaj, këta arsimtarë janë që kanë bërë këto kuadro për të bërë atë, që në fakt për ne është prestigjioze dhe për ne është e nderës dhe diçka e veçantë.

Nganjëherë dimë të hedhim baltë mbi veten, po mirë nganjëherë është edhe e kuptueshme për në kohë fushatash. Këtu fushata s'ka filluar as për lokalet hala as për parlamentare, por e kuptoj. Unë sinjerisht po ju them si ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, krejt detyrën time kam për ta bërë për të realizuar këtë gjë, sepse në fakt janë shumë meritore këta njerëz, janë shumë meritore kjo kategori dhe kemi borxh ndaj tyre dhe do ta lajmë, më besoni, jam shumë i sigurt. Faleminderit!

KRYETARI: Rita Hajzeraj- Beqaj, replikë.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, kryetar,

Unë e thashë që janë kategoritë e cila ka mbetur skajshmërisht e përbuzur në kontekstin e asaj se ka ardhur Ligji për pensionet e financuara nga shteti. Të gjitha kategoritë tjera janë përfshirë këtu, LDK-ja e ka dhënë propozimin e saj që të përfshihet edhe kjo kategori, pra kam folur për këtë kategori dhe jemi jashtëzakonisht krenar, që jemi edhe ne si nxënës, unë kam qenë nxënëse në atë kohë të okupimit dhe i kemi provuar këto edhe i njohim mësuesit e arsimtarët, dikush ka qenë mësues, dikush arsimtar, kështu që jemi të gjithë pjesëmarrës në atë kohë.

Andaj, shqetësimi ynë është pse amendamenti nuk po hyn në këtë ligj? Amendamenti në këtë ligj ka hyrë që do të bëhet me një udhëzim administrativ, apo me një akt nënligjor? Kjo çështje nuk rregullohet me akte nënligjore, por rregullohet me ligj të veçantë. Dhe, këtë po e kërkojmë, asgjë tjetër.

Në këtë kontekst, unë mendoj se këta kanë qenë të përbuzur, sa i përket edhe përfshirjes së tyre si kategori në këtë ligj, po edhe trajtimit ndaj tyre.

KRYETARI: Kundër -replikë, ministri Ramë Buja.

MINISTRI RAMË BUJA: Të sqaroj, e nderuar!

Çështja është që të përbuzur skajshmërisht u përdor, por unë nuk desha të polemizoj as s'përmenda emër, por thashë që do të ishte fyese për ta që t'i thuash kështu, sepse nuk janë të përbuzur të tillë, ne po bëjmë ligj jo akt nënligjor, për të realizuar ashtu si duhet realizuar kjo kategori e atyre që vërtet ishin shumë meritore.

Andaj, këtë po e bëjmë ligj dhe ajo është thjesht në fund të punës për ta bërë dhe së shpejti do ta procedojmë në Qeveri.

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Rashiq.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poštovani gospodine premijeru,

Poštovani ministre,

Takođe i ja samo za pojašnjenje, ja bih vas zamolio. Kao što znate zakon za penzije finansiran od strane države je počeo i stigao je u Parlamentu u februaru prošle godine.

Tad sam rekao prvi put, pa sam ponovio opet kad ste vi iz LDK-a-vratili zakon na “ryshqyrtim”, ili na razmatranje da će podzakonski akti biti usvojeni u periodu od godinu do godinu i po dana, vi ne možete sad, pošto je jedan razmak finansijski, koji bi trebao da bude po našoj proceni, najmanje oko 5 miliona, da ubacujete kao amandmane, jer to bi stvarno izgledalo toliko neprofesionalno i neozbiljno i sa strane Vlade i sa strane vaše, da takav jedan utrošak bude uvećan za toliki iznos.

Zato smo mi više puta ponavljali da je to stvar tehnike. Kad kažem to mislim da vi svakome kome date pravo da aplicira za određenu beneficiju, mora da ima određeni vremenski rok. Mora da postoji određena tehnička grupa, koju će utvrditi ko je u stvari stvarno bio, bilo nastavnik, profesor, bilo radio u zdravstvu, a ko nije? Jer, je normalno da će svi ljudi uz dužno poštovanje svima njima, da se prijave da jesu bili neki od korisnika. A s druge strane znamo da to nije tačno. Nisu svi bili nastavnici, nisu svi bili učenici, nisu svi bili doktori. Mi moramo da izvršimo selekciju.

Da bi izvršili selekciju treba nam tehnička grupa, treba nam „afati kohor“ ili vremenski rok. Kad se to obavi i završi, pošto sam siguran da i vi želite da to bude po zasluži ne blanko svima nego po zasluži, eh tad možemo da usvojimo tu listu i taj dodatni utrošak, koji će biti takođe opet pred vama prikazan.

Podsećujem još jednom, da dok smo došli do finalne verzije zakona je trajalo stvarno dugo, pogotovo period pregovora i sa svetskom bankom i sa međunarodnim monetarnim fondom. A sigurno je da svaki ministar, svaka vlada mora da zna koliko su to bitni faktori, ukoliko hoćete da imate održivu mikrofiskalnu ili makrofiskalnu politiku.

Prema tome, mi smo išli putem koji je bio neophodan, neizbežan i ovim što stalno obećavamo da ćemo podzakonskim aktima da rešimo njihov problem, uvek i jeste istina. A s druge strane, računajući februar od prošle godine, do april ove godine da smo ga tada usvojili zakon, kao što sam molio, verovatno bi već u narednih tri meseca mogli da imamo i te podzakonske akte, po koje podrazumevaju računanje svih radnika koji su radili u priodu 1990 - 2002 sad što čujem kao predlog i takođe kategorizacija penzionera koji su računati oni koji su bili u “kontributpaguesit” ili koji su uplaćali doprinos.

Ja sam samo tražio i tada i opet tražim malo strpljenja da vam pokažemo da posle usvajanja zakona godinu i po dana period rekao sam godinu do godinu i po, nek bude godinu i po da ne pogrešim, posle toga možete absolutno da kritikujete, pre svega mene zbog toga što nismo ispoštovali ono što smo rekli da ćemo ispoštovati. E to je sva da nazovem tako, polemika ovde. Samo usvojen zakon može da stvori tehničku predosnovu ili tehničku platformu, da usvojimo sve druge podzakonske akte, koje su nam potrebne. Hvala!

KRYETARI: Kundër replikë, një minutë, Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Për ministrin e Arsimit, unë thashë që kanë qenë të diskriminuar dhe e dhashë arsytimin, sepse ata prapë po hyjnë në rikualifikim e që i kanë për pesë vjet përpara se të dalin në pension, që nuk është fer ndaj tyre.

Sa i përket ministrit Rashiq, mua po më vjen keq që i qiti në ujë edhe fjalën e kryeministrit edhe fjalën e ministrit të Arsimit, sepse ministri Rashiq e pranoi faktin që nuk ka para për këtë kategori të caktuar, ndërsa kryeministri tha që veç është gati platforma, ndërsa ministri i Arsimit tha që veç ligji është gati dhe do të vjen në Parlament.

Tash, nuk po dimë kujt t'i besojmë, a t'i besojmë ministrit, i cili e ka sjellë apo juve, kjo po i bie që asnjëra nuk është e vërtetë, as nga ana e të dy të parëve, as nga ana e ministrit, të fundit.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Rashiq.

MINISTRI NENAD RASHIQ: Faleminderit, kryetar!

Absolutisht nuk është e vërtetë që kam thënë që Qeveria nuk ka para. Kam thënë se është jashtëzakonisht joserioze, që të prezantohet një ligj i cili ka domethënë diferencën prej 5 milionëshe, që vlerësohet që kjo është eventualisht shuma e cila na nevojitet, sa i përket inkuadrimin të gjitha skemave.

Por, dëgjoni në propozimin e ligjit thotë: pas periudhës kohore e planifikuar për aprovim të akteve nënligjore, do të sigurohen dhe do të planifikohen mjetet të cilat do ta përmbushin këtë vrimë, duhet thënë, në këtë rast që po thoni ju, sepse nuk mundet as secili do debat në këtë moment ta zgjidh këtë çështje, mundet vetëm të krijojë një disbalancë ndërmjet propozimeve të Qeverisë dhe propozimeve të Kuvendit.

Që do të thotë, pas aprovimit të ligjit, po përsëris edhe një herë, do të kemi bazën ligjore, që ta vazhdojmë me këtë projektligj apo me akte nënligjore. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro kryeministër, e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete,

Kishit paqartësi, unë përsëri dëshiroj të ju qartësoj juve personalisht, por dhe grupin tuaj parlamentar, por para së gjithash opinionin tuaj publik, i nderuar zoti Hamiti.

Ju thatë që punësoria kosovare apo më mirë të themi mësimdhënësit janë në gjendje të mjerë.

Unë dëshiroj t'ju theksoj juve se kur ne kemi marrë mandatin për të udhëhequr Qeverinë e Republikës së Kosovës, mësimdhënësit dhe punësoria kosovare kanë qenë në një gjendje të pagesës të asistencës sociale. Në anën tjetër, i nderuari zoti Beqiri, ne nxënësit i kemi gjetur në kontejnerë. 37 shkolla i kemi gjetur në kontejnerë duke u mërdhi fëmijët e Kosovës.

Në anën tjetër, kemi arritur që prej periudhës që kemi marrë Qeverinë, për punëtorët universitarë të rrisim pagat mbi 100%, për mësimdhënësit e shkollave të mesme dhe

filllore mbi 50% deri në 70%, për punëtorët e shëndetësisë mbi 50%, shërbyesit civilë mbi 50%, policët mbi 50%, FSK-ja vetëm vitin e kaluar 40%, familjet e dëshmorëve rreth 70%, invalidët 70%, në të njëjtën kohë zjarrfikësit mbi 50%. Dhe, vetëm për pensionistët e Kosovës vitin e kaluar 40%, ndërsa për prokurorët dhe gjyqtarët mbi 100%.

Në anën tjetër jemi kujdesur që të bëjmë aplikimin dhe marrjen e përgjegjësiwe institucionale shtetërore, për të gjithë veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ani pse dikush po thotë janë shumë 57 mijë, por unë i ftoj përsëri, le të aplikojnë të gjithë, as edhe një sakrificë më e vogël kujt nuk do t'i shkojë huq. Shteti ka obligime.

Në anën tjetër ndjehem tepër mirë që u rregullua edhe çështja e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës dhe të gjithë të burgosurve politikë mbi 3 mijë dhe do të vazhdojmë që t'i kryejmë ato obligime dhe të marrim vendime tjera shtesë, në përputhshmëri me realitetet që i kemi, që pagat e punëtorisë kosovare të jenë paga të punëtorit, të standardit evropian.

Ndërsa, ju kujtojeni vetë angazhimin tuaj, çfarë vendimesh keni marrë në momente të caktuara kur i kemi rritur pagat e në të njëjtën kohë kur kemi marrë vendime të rëndësishme edhe për reformën në arsim dhe hapjen e universiteteve publike, që gjithashtu jeni deklaruar kundër, qoftë për hapjen e Universitetit Publik në Prizren, qoftë hapjes së Universitetit në Pejë, në Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë dhe Ferizaj.

Prandaj, edhe opinioni prej këtyre qyteteve ju pyet, pse jeni kundër hapjes së universiteteve publike në këto qytete e në të njëjtën kohë dhe votimin tuaj, zoti Beqiri si Grup Parlamentar që keni marrë kundër rritjes së pagave për këto kategori që i përmenda. Prandaj, edhe një herë e theksoj, e di që duhet bërë edhe më tepër, por kemi arritur të bëjmë atë e cila nuk është bërë në dhjetë vjetët e kaluara.

Sa i përket infrastrukturës e këto, ju e dini që edhe në Vranjevcin e zotit Beqiri kemi ndërtuar dhe kemi investuar më tepër se sa Prishtina 15 vjet. Faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri, replikë.

ISMET BEQIRI: Unë, zoti kryetar, kërkoj në emër të Grupit, ose do të sillet ky njeri mirë, se s'di me u sjellë dhe absolutisht, s'ka edukatë politike, më vjen keq, sillet me këtë demagogji, ose ne po e lëshojmë seancën, le të vazhdojë ky, ky s'e di ku është Vranjevci, hiq, qe me çka merret. Ky merret me kopalla. Po, çka ka investua ky? Po mos, se është, je kryeministër i vendit, vërtet, je kah më befason. Po, ti s'e di ku është Vranjevci, një cent s'e ke qit, që me çka merresh.

Nuk është e vërtetë, që LDK-ja ka qenë kundër hapjes së universiteteve, mos, se nuk ka kuptim. Unë e kuptoj fushatën, por lodhesh, kot e ke, mos, mos se universitet ka qenë Vranjevci në kohën kur ti je shëtitur jashtë, e i kanë mësuar po këta arsimtarë, sot që kemi debat, atje kanë qenë tri shkolla filllore, ka pasur edhe Universitet, e din zoti Bajrami, e di zoti Kuçi. Mos u merrni me këto, sepse nuk është në rregull për të thënë diçka që s'ka thënë LDK-ja.

Kur kemi qenë kundër hapjes së universiteteve, nuk është në rregull kjo Dhe, nuk di çka, nëse ne kemi kërkuar që me ligj të rregullohet, ju po thoni: jemi në rrugë të mbarë, po bëjeni, ne s'po kërkojmë kurrëgjë tjetër.

Zoti ministër, thotë: është në përfundim ligji. A e kemi pasur strategji? Unë s'e kam parë që e kemi pasur strategji legjislativë për këtë vit. Tregona. Nuk është. Nëse s'është, shumë mirë që po ardhka. Ne asgjë, s'po kërkojmë më tepër.

Dhe, pse po ia ndërroni kahen gjithë debatit? Unë po ju lus, zoti kryetar, në emër të Grupit Parlamentar, unë kërkoj sepse ky është një provokator, i cili vazhdimisht po e provokon Grupin Parlamentar, unë lus nga deputetët e Grupit tim parlamentar, të mos ia kthejnë asnjë fjalë, le të kënaqet, le të vazhdojë, zoti kryetar. Unë në emër të Grupit Parlamentar po kërkoj, jemi jashtëzakonisht korrekt, serioz, ne e kemi qar kërkesën, është diçka normale, asgjë s'po kërkojmë, që nuk është, që edhe këtu po përkrahet, po në formën qysh kanë dëshirë këta ta thonë. Ne asgjë s'po kërkojmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro, kryeministër! Veç një minutë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti Beqiri,

Se ku është Kodra e Trimave, ju e dini se unë e di shumë mirë, kam qenë... i Universitetit, kur ju gravitonit edhe ju aty dhe edhe kam studiuar edhe kam punuar aty dhe e njoh pëllëmbë për pëllëmbë, ndoshta edhe më mirë. Ti e njeh në kuptimin elektorale, unë e njoh kuptimin e substancës kombëtare.

Por, dëshiroj të theksoj se investimet tona edhe në Kodër të Trimave janë më të fuqishme se sa investimet tuaja 15-vjeçare. Ju krenoheni se është bastion elektorale Kodra e Trimave për Lidhjen Demokratike të Kosovës, unë ju them që ju ke shumë borxh atyre njerëzve që nuk ke investuar as në kanalizime, as në ujësjellës, as në krijimin e hapësirave të gjelbërimit dhe e keni kthyer Kodrën e Trimave në një gjendje më të rëndë siç ka qenë edhe më herët dhe keni përgjegjësinë dhe personalisht edhe ju që pretendoni të jeni si përfaqësues i tyre. Kështu që me Kodrën e Trimave të gjithë jemi krenuar dhe krenohemi me atë angazhim, sakrificë, me ato përpjekje, me ato demonstrata që kemi marrë pjesë të gjithë si studentë e shpesh ke munguar. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Ramë Buja.

MINISTRI RAMË BUJA: E nderuara deputete Hajzeraj,

Rikualifikimi është pritur aq dashamirësisht dhe mirë prej arsimtarëve sa "mend e zarar" që ju po e quani diskriminim. Mirë. Ju lutem, unë po ju them që ky diskriminim i juaji atje kërkohet aq shumë, sepse dihet që ata njerëz që bëjnë fakultetin nga shkollat e larta edhe pensionin e kanë më të mirë, edhe cilësinë në arsim e kanë më të mirë dhe e kanë pritur me shumë dashamirësi, që ju po e quani, nuk dua të polemizoj këtu, merre mikrofonin pastaj thuaj. Dhe mund ta quani diskriminim ju edhe aftësimin e arsimtarëve me ISDL që kanë matur 12 mijë e 963 arsimtarë për t'u përgatitur për shekullin XXI ku

jemi me teknologji informative, po kjo s' është diskriminim e nderuar, kjo është privilegj që ju kemi krijuar arsimitarëve tanë. Andaj, ju mund të thoni çfarë të doni, por unë e përgëzoj kryeministrin që ka arritur t'ju nervozoj mirë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KYESUESI: Zoti Jakup Krasniqi e ka fjalën.

KRYETARI: Unë po e lexoj rendin e ditës.

Për rend dite kemi debat parlamentar lidhur me statusin e pazgjedhur të punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës për vitin 1900/91 deri në vitin shkollor 1998/99, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së dhe rekomandimeve të komisioneve parlamentare, edhe pse iniciimi për këtë çështje ka ardhur nga një petition.

Unë para se t'i them disa fjalë, dua të jua tregoj një tregim popullor. "Malësori i Malësisë së Gjakovës ishte vonuar një ditë pazari për të hyrë në Gjakovë, dhe duke ardhur nga Malësia në Gjakovë e takon malësin tjetër që kishte qenë në Gjakovë dhe po kthehej në Malësi. E po i thotë: A kishte bukë në Gjakovë? Ishte uritur shumë. Iu përgjigj: Po kishte. Po sa ishin? Ai i tregoi me të përafërt, duke ia vizatuar në pluhur. I thotë lëshoma, bëje pak më të madhe. Ai i thotë unë këtu në pluhur po ta lëshoj sa të duash, por atje në furrë ishte pak më e vogël".

Duke dëgjuar debate dhe shtirjen e kërkesave vërtet shtrohet pyetja- Për çka gjatë gjithë një shekulli populli ynë ka luftuar, për të vendosur një shtet ligjor, një shtet të drejtë dhe të barabartëve apo një shtet të privilegjuarëve? Ne kemi obligim për gjithë qytetarët e Kosovës se këtu dikush e tha veç për shqiptarët, jo si institucione kemi obligime për gjithë qytetarët e Kosovës, që gjithë qytetarët e Kosovës ta kenë një jetë të dinjitetshme.

Por, ne e patëm një debat dje, por pa e vendosur një rend dhe një ligj për zhvillimin e vendit, për politika ekonomike dhe për politika fiskale dhe pa i kryer të gjithë njerëzit që fitojnë nga kjo Kosovë, obligimet e veta për ta bërë një buxhet të dinjitetshëm, ne mund të flasim për t'ia plotësuar dëshirën çdo arsimitar, çdo ushtaraku, çdo administratori e çdo qytetari tjetër, mos t'i përmendi me profesione, minatori, punëtori e krejt. Mirëpo për të shpërblyer në mënyrën më të dinjitetshme duhet vërtet të kemi ku t'i marrim ato mjete.

Një herë ne duhet ta formësojmë një buxhet të dinjitetshëm për ta ndarë pastaj atë në mënyrë të drejtë dhe dinjitetshëm për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Prandaj, lutja ime është se si duket vërtet po afrohet fushata dhe secili po donë ta përdorë foltoren e Kuvendit për të bërë fushatë edhe kjo është e drejtë e politikës për të bërë një gjë të tillë, por ne si deputetë kemi për obligim vërtet ta ruajmë dinjitetin e kësaj ndërtese. E kam fjalën të shtëpisë së demokracisë, shtëpisë së përfaqësuesve të qytetarëve të Kosovës dhe unë po më duket se jo shpeshherë nuk jemi kah e kemi parasysh ruajtjen e dinjitetit si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës dhe në vend se vërtetë të diskutojmë, të

debatojmë dhe të dimë e të nxjerrim përfundime për të mirën e qytetarëve, ne gati veç po e shndërrojmë këtë ndërtesë në pazar dhe me këtë nuk nderojmë as ata që përfaqësojmë, nuk e nderojmë as vetveten për angazhimet tona që i kemi pasur vazhdimisht për të ndryshuar jetën për së miri.

Prandaj, unë kisha kërkuar, ne e kemi një debat shumë konkret, me qenë se, me qenë se për të qenë real, unë dua të them që nuk kanë qenë vetëm mësuesit që janë financuar nga Këshilli Qendror Financiar i Kosovës, janë financuar edhe mjekët edhe mendoj që mund të ekzistojnë ato regjistra, janë financuar edhe njerëzit që kanë punuar edhe në Këshillin e Arsimit, edhe në Këshillin e Financimit edhe këta duhet shikohen si kategori që megjithatë kanë rrezikuar dhe nganjëherë më shumë kemi rrezikuar ne që s'kemi qenë drejtpërdrejtë në procesin e arsimit se sa ata që kanë qenë drejtpërdrejt. Por edhe një gjë duhet ta dimë, ne e dimë se atëherë qytetarët e Kosovës kanë dhënë mjete për këto çështje, dhe e dimë se fundi i luftës i ka zënë diku 500 milionë më së paku atëherë kanë qenë marka gjermane dhe realisht janë dhënë për ato kategori dhe askush kur s'ka dhënë llogari edhe kjo është një çështje tjetër. Por ne duhet të përpiqemi që të krijojmë një jetë të dinjitetshme për të gjithë qytetarët, por në mënyrë të veçantë ndoshta me fjalë të mira, me mundësi që kemi, natyrisht për të dhënë edhe kontributin e atyre që kanë dhënë, dhe fundi i fundit çdo qytetar që ka ndejtë në Kosovë dhe gjithë këto vuajta që i ka vuajtur e meriton një jetë më të dinjitetshme, se jo vetëm ata që kanë punuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar, nënkryetar, kryeministër,

Kolegë deputetë,

Jo, unë do të flas shumë shkurt dhe pikë së pari do të falënderoj që edhe në emër të komunitetit egjiptian që shumë fëmijë në atë kohë kanë mësuar në gjuhën shqipe dhe pa asnjë problem kanë pasur integrimin e tyre në të gjitha nivelet e arsimit edhe në shkollë fillore, edhe të mesmen, por edhe në studime që shpeshherë them më kualitet kanë dalë në atë kohë se sa sot.

Ndërsa do t'i falënderoj përveç profesorëve që janë në këtë tempull të demokracisë dhe që kanë dhënë kontributin si profesor Hamiti, kryeparlamentari Krasniqi dhe të tjerë, janë edhe profesorë tjerë jashtë këtij Kuvendi, por edhe kolegët deputetë të komunitetit egjiptas duke filluar nga profesor Fahri Zeqiri, historiani Osman Raci, Adem Raci dhe shumë gra e burra që kanë kontribuar bashkërisht me komunitetin shumicë në një kohë shumë të vështirë.

Prandaj, si anëtar i këtij Kuvendi, por edhe anëtari i Komisionit të Buxhetit do të kontribuojmë që këta njerëz të jetojnë dinjitetshëm dhe mundësitë ligjore edhe rekomandimet, edhe ligji ose çka do të është kjo që për këta njerëz të ndihen të dinjitetshëm dhe të mos jenë të harruar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ishin vitet 1990 deri në ato 1999, ku shënuan fillimin e përpjekjeve të pandashme serbe për të shkatërruar arsimin fillor, të mesëm dhe atë të lartë në Kosovë.

Shkolla shqipe në Kosovë, në veçanti Universiteti i Prishtinës, mori goditje të mëdha që quhen deri në rrezikimin serioz të përmasave të shkatërrimit të arsimit shqip në të gjitha nivelet nga pushteti i atëhershëm nacionalist serb i cili u angazhua për ndryshimin dhe ndalimin e shkollës shqipe në Kosovë.

Gjendja në universitete u përkeqësua dukshëm krahas gjendjes së përgjithshme në Kosovë, pra qendra universitare nuk kishte më strehë e studentëve dhe as e profesorëve shqiptarë, porsa u mbyll semestri verior i vitit akademik 1990/1991, më 28 qershor të vitit 1991, Kuvendi i Serbisë vendosi masa të dhunshme në Universitetin e Prishtinës, pra gjatë vitit të ri akademik udhëheqja e dhunshme të udhëhequr nga profesor serbë rritën numrin e studentëve serbë të sjell nga viset e ndryshme të Serbisë me qëllimin që shqiptarët mos të punojnë në universitetet e tyre.

Më 21 gusht të vitit 1991, grupi i Helsinkit në Vjenë lëshoi një deklaratë ku konstatoi se arsimi shqiptar në Kosovë u shkatërrua nga politika nacionaliste serbe.

Por se në fillimin e vitit 1992 filloi organizimi nga Lidhja Demokratike e Kosovës si parti e vetme politike nga profesorët dhe studentët për të gjetur mundësi dhe formë që shkolla shqipe të fillojë të jetë aktive, pra më 14 shkurt të vitit 1992 Universiteti i Prishtinës njoftoi studentët dhe mësimdhënësit se do të fillojë mësimi në nivel universitar.

Ndërsa, më 17 shkurt të vitit 1992 filloi viti akademik universitar nëpër shtëpi, fakultete. Andaj me të drejtë Këshilli iniciues i mësimdhënësve, veteranët e Kosovës kërkuan që të njihet vadiliteti i sistemit arsimor për vitin 1990/1999 dhe njëherësh të zgjidhjes së statusit të gjithë punëtorëve që kanë punuar në të gjitha nivelet e arsimit gjatë kësaj periudhe.

Edhe pse kryeministri i Kosovës që nga viti 2008, siç e tha edhe më herët, ka nënshkruar një vendim që t'u njihet statusi të gjithë mësimdhënësve të Republikës së Kosovës për periudhën 10-vjeçare të kaluara gjatë kohës së okupimit ai ende nuk është filluar së zbatuari. Pra, ky vendim që nga viti 2008 dhe tash jemi në vitin 2013 nuk është zbatuar.

Dhe përgjegjësia është bartur prej Ministrisë së Arsimit në atë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe kjo e fundit thotë se Ministria e Arsimit është dashur t'i sjell të gjitha emrat e mësimdhënësve të atyre viteve.

Unë konsideroj se ato vite ishin vërtet vite të shkollës shqipe në Kosovë, ishte periudha më meritore e arsimit shqip, ishin ato vite të rezistencës së shqiptarëve ku të gjithë u bënë bashkë: nxënës, prind, mësimdhënës, në një fond të përbashkët për të mbrojtur librin dhe gjuhën shqipe. Andaj, të merituar janë të gjithë ata që kontribuan në forma të ndryshme

si mësimdhënësit në radhë të parë që punuan pa paga me të vetmin qëllim që të funksionojë arsimi në Kosovë në të gjitha nivelet.

Të gjithë pronarët e shtëpive që lejuan shtëpitë e tyre të shndërrohen në fakultete dhe në shërbim të studentëve dhe mësimdhënësve, të gjithë ata qytetarë të Kosovës, si brenda dhe jashtë Kosovës, ku vlen të veçohet diaspora që kontribuan materialisht dhe po ashtu financiarisht me të vetmin qëllim që arsimi në Kosovë në ato vite të jetë funksional.

Pra, edhe unë mbështes rekomandimin të cilin e ka dhënë Lidhja Demokratike dhe ftoj dhe lus deputetët t'i votojnë rekomandimet e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë dhe deputete të Parlamentit të Kosovës,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar ministër,

Sot po trajtojmë një temë e cila u përket të gjithëve të cilës i detyrohem të gjithë të rinë gatitur, ta respektojnë të gjithë dhe është një temë që na inspiron të gjithëve, na obligon të gjithëve që ta dëgjojmë e të përkushtohemi dhe na imponohet për respekt të gjithëve për shumë arsye. Disa aspekte nga këto arsye do të mundohem t'i veçoj.

Po flitet për një temë të cilën unë për veten time do ta falënderoj Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike edhe ka respektin Grupi Parlamentar për këtë temë, sepse ia kam edhe zili që e ka kap dhe e ka sjell në Parlament e jo Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, që ka investimet e veta, që ka përkushtimin e vet, që ka pasur respekt për këtë temë, por i angazhuar me angazhime tjera, me tema tjera, i ka ra në hise Lidhjes Demokratike që ta sjell në këtë Parlament të tillë dhe tash neve me shumë respekt do t'i qasemi edhe me shumë konsideratë edhe për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike edhe për temën të cilën e kemi këtu për trajtim.

Po flitet për vitet '90 që neve të gjithëve gjeneratës tonë bashkërisht sa jemi këtu, na kujtojnë shumë gjera të përbashkëta ku fillon, zë fill një unitet i pashembullt në historinë e popullit tonë dhe të këtij vendi.

Është një unitet i përgjithshëm për përkushtim në arsim, është një unitet i përgjithshëm për të filluar një rezistencë të përbashkët, është një përkushtim frontal i këtij populli, është një gatishmëri për flijime të këtij populli, por së pari zë fill tek arsimdashësit, tek arsimtarët dhe gjithë punonjësit e arsimit të cilët meritojnë respektin e veçantë dhe meritojnë meritat e veçanta të gjithë ato që i njeh dhe ka mundësi t'i respektojë korniza ligjore.

Mua më kujtohet në Malishevën time se si ka filluar ky përkushtim. Në mungesë të institucioneve shtetërore filloi mobilizimi i popullsisë me moton: "Një lirë për arsimin" dhe të gjitha gratë e Malishevës hoqën nga stolitë e tyre një lirë për arsimin për ta

financuar, sepse u ndërpre financimi institucional i arsimit dhe këtu zë fill një mentalitet, zë fill një iniciativë, fillon, ideohet një koncept, i cili ma kujtonte kohën e Skënderbeut kur duhej të farkohej shpata dhe që ishte i vetmi mjet për ta luftuar armikun dhe i njëjti koncept filloi të zë vend atëherë si shpatë, si armë kundër okupatorit të asaj kohe, i cili i nxori mësimdhënësit dhe nxënësit e tyre nga institucionet shkollore. Dhe, këtu filloi të materializohet e të konceptohet një ide e cila ishte ilozore që arsimit të bëhej me vetorganizim dhe arsimtarët të mobilizoheshin edhe më shumë me pagat e ulëta për të cilët filloi të interesohej i gjithë punësoria e Kosovës, brenda dhe jashtë, sidomos kapitull të veçantë respekti meriton emigracioni jonë i cili filloi të organizohet e të sistemohet në grumbullimin e nevojave për të shpërblyer dhe paguar punën e arsimtarëve dhe gjithë mësimdhënësve të cilët ishin me përkushtim permanent dhe të veçantë.

Unë për veten time respekt do të ndaj edhe për të gjithë ata mërgimtarë të cilët kanë ndarë nga paga e tyre sistematikisht për çdo muaj në mënyrë të rregullt, me shumë vullnet, të ardhurat, të hyra nga pagat e tyre me punën e rëndë që kanë bërë atje në kantieret e punës në Perëndim. Gjithë ai përkushtim, gjithë ajo punë që është bërë në grumbullimin e këtyre mjeteve kurë nuk është kërkuar shpërblim dhe kurrë nuk është kërkuar respekt nga ata, por që përherë nuk do t'ju mungoj respekti dhe gjithherë do të kenë konsiderata të veçanta gjithë ata që kanë dhënë kontribut në grumbullimin e këtyre të ardhurave që u janë shpërndarë pastaj punëtorëve të arsimit.

Unë për veten time dëgjova nga kryetari i nderuar, kusha im i dashur këtu që foli për një shumë prej 500 milionë markash, që i ka gjetur paslufta në një fond, atëherë zakonisht kanë kaluar për xhirollogarinë e “Daradania Bankës”, dhe unë jam shumë i interesuar, e kam shumë simpatik kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike dhe është njëri nga bashkëpunëtorët e mi, kolegët e mi të nderuar si shumë nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, që më gëzojnë respekt edhe sot dhe unë jam shumë i interesuar që edhe ky të bëjë hulumtime se ku kanë shkuar këto, ku kanë ngelur këto para dhe a janë kthyer aty ku duhet dhe a kanë destinacionin, natyrisht të merituar ashtu siç duhet?

Unë për veten time nuk e kam ditur këtë shumë që ka qenë e tillë, por e dëgjova me shumë përgjegjësi dhe kusha im është shumë i përgjegjshëm kur e përmendi tani, kryetari i Parlamentit të tashëm, i joni, i juaji i të gjithëve që ai na tha dhe na solli këtu.

Unë për veten time do të veçoj edhe diçka që është shumë ekzaltuese dhe natyrisht që nuk duhet t'u ngelim në hak gjithë asaj armate të mësimdhënësve të cilët kanë sakrifikuar, kanë flijuar dhe janë përballur me dhunën e pushtetit të atëhershëm vetëm e vetëm për të shpërndarë diturinë e tyre tek nxënësit, te ai brez i ri i cili siç e solli edhe një shembull ministri i Arsimit, kanë qenë edhe në universitetet prestigjioze shembull në mesin e studentëve të cilët i kanë mbaruar shkollimet në tyre në mënyrë të rregullt.

Kështu edhe për fakt që brezi i nxënësve të asaj kohe ka marrë dijen nga brezi i mësimdhënësve të asaj kohe, natyrisht në një nivel i cili ka lënë mbresa dhe ka krijuar shembull në universitetet prestigjioze siç ishte ai shembulli i Universiteti Kembrixhit edhe për këtë arsye ata meritojnë respekt, meritojnë konsiderata të veçanta dhe natyrisht

që meritojnë mbështetje buxhetore ashtu siç do të duhet dhe ashtu siç do të kërkohej nga ata.

Edhe një herë respektin më të madh për gjithë ata që sot janë gjallë, por konsiderata të veçanta për gjithë arsimtarët dëshmorë të cilët do të nisesha nga Adem Morina, që është një nga bashkëpunëtorët e mi dhe nga Xhevë Lladrovci që është një nga mësimdhënëset e fshatit tim, vendlindjes sime, kushërirë e imja e cila përveç se kishte brumosur gjithë nxënësit e saj me ideale të lirisë, me atë koncept, me atë ideal të lirisë, rroki pushkën si një intelektuale e mirëfilltë dhe ra dëshmor siç e meritojnë të gjithë dëshmorët mësimdhënës edhe te komunat tjera, respektin e veçantë dhe status të veçantë duke u ndalur deri te ai mësimdhënës që e ngriti familjen e saj në tempull lirie dhe mobilizim dhe front kundër armikut, siç ishte edhe mësimdhënësi i nderuar Shaban Jashari.

Gjithë mësimdhënësit dëshmorë, gjithë mësimdhënësit kontribuues, të gjithë të këtij fronti të organizimit të arsimtarëve të asaj kohe, respekt e konsiderata të veçanta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është mirë kur diskutohet për tema të rëndësishme që ka ndodhur në periudhë të caktuar kohore, të rëndësishme edhe për historinë e vendit tonë, po të rëndësishme po ashtu edhe për edukimin tonë edhe personal, por edhe për kontributin e disa prej kolegë dhe këtu deputetë që kanë dhënë në edukimin tonë.

Mirëpo, në të njëjtën kohë kalimi në demagogji dhe frika dhe diskutimi i hapur për atë çka ka ndodhur vitet '90/99, mënyra se si është administruar jeta publike e organizuar nga institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në atë kohë, të kryesuara nga Lidhja Demokratike e Kosovës, pjesë të cilës kanë qenë kolegë deputetë që tashmë janë edhe në parti tjera, po ka qenë pjesë e rëndësishme e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe kontribuues- dhënës të rëndësishëm në proceset e shtet-ndërtimit të Kosovës dhe sidomos në ndërtimin e sistemit paralel të arsimit.

Çështja është shumë e thjeshtë, pse arsimit ose punëtorët e arsimit vitet '90-99 kontributin që e kanë dhënë nuk njihet si kontribut apo përvojë e punës dhe nuk njihet si stazh i punës në mënyrë që ata të paktën në një koncept të sotëm ata do të fitonin 40 euro më shumë, ndoshta pension. Është një kompensim i vogël material, por nuk është qëllimi kompensimi material, qëllimi është kompensimi moral, se sa ne e njohim atë aktivitet që është zhvillua për ato 10 vjet, se sa e njohim atë kontribut që është dhënë për ato 10 vjet, se sa e njohim ne atë sakrificë që është dhënë për ato 10 vjet. Fakti që kryeministri nuk ka qenë pjesë e atij organizimi, nuk është faji i tij pse ka qenë i ri apo pse ka qenë i vjetër, apo pse ka qenë jashtë apo pse ka qenë diku tjetër, sepse kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ka qenë në atë kohë mësimdhënës në Negroc dhe mësimdhënës i rëndësishëm, po edhe plot kolegë tjerë mund të mburren për aktivitetin që e kanë dhënë.

Unë mbaj në mend si fëmijë në shkollë atëherë sakrificën e mësimdhënësve tanë kur Policia e Serbisë erdhi dhe e rrethoi shkollën, mësuesit dolën për t'i mbrojtur nxënësit dhe mësuesit u rrahën dhe u përgjakën edhe nxënësit shpëtuan. Ajo ka qenë, ajo është njëra ndër pamjet që na ka mbetur gjithë neve si nxënës në memorien tonë, dhe ne kemi si obligim moral dhe familjar që ta pranojmë atë kontribut. Nëse ne nuk e pranojmë atë kontribut, ne nuk duhet t'i pranojmë diplomat tona, as të shkollës fillore, as shkollës së mesme, as të fakultetit, as mbas fakultetit, magjistraturat, doktoratat , sepse ne po e mohojmë një kontribut dhjetëvjeçar dhe ne duhet t'i mohojmë edhe diplomat tona dhe për pasojë shohim çfarë efekti jep në jetën tonë personale, sepse ne po ndikojmë në jetën e dikujt tjetër duke mos ja njohur kontributin që e ka dhënë për dhjetë vjet. Atëherë të mos i pranojmë edhe ne diplomat tona dhe çfarë ndikimi po ka në jetën tonë.

Prandaj, mendoj që se është shumë e ndershme prej neve që të jemi të qartë, të thjeshtë dhe direkt dhe të vijmë në konkluzionin që e ka Lidhja Demokratike e Kosovës, që është, i rekomandohet apo i kërkohet Qeverisë që në afat më të shpejtë ta sjellë ligjin për njohjen e kontributeve të dhëna gjatë viteve '90-99 shumë e thjeshtë.

Kryeministri po thotë që e paska nxjerr një vendim Qeveria në vitin 2008, vendimi i cili nuk është zbatuar kurrë, jemi në vitin 2013, pesë vjet. Cila është pasojë juridike që ka dhënë ai vendim, pak rëndësi ka? Nuk jam këtu për të replikuar me kryeministrin se çka ka bërë e çka s'ka bërë, e rëndësishme është që ne të njohim këtë kontribut dhe me kaq mbyllet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

E kam kërkuar pak më vonë fjalën që të mos ketë transmetim drejtpërdrejtë kur flas me qëllim.

Para disa kohe e kemi pasur një debat në Kuvendin e Kosovës edhe në atë debat kanë folur po ashtu njëjtë diku nja 50 deputetë, për një temë për të cilën janë pajtuar të gjithë.

Mendoj se është parlamentarizëm i çuditshëm ku kanë nevojë të flasin 50 deputetë edhe të gjithë pajtohem me temën.

Sikur unë të isha mësimdhënës sot edhe e kisha parë debatin esencialisht do të më ishte fyer intelijenca, se po del që secili deputet në Kuvendin e Kosovës krejt çka po provon të bëjë, është të thurë lavde edhe të provojë ta fitojë ndonjë votë. Krejt çka duhet të ndodhë në këto debate kur të gjithë pajtohen është të flas nga një përfaqësues i grupit parlamentar dhe për të votuar për ose kundër, të tregoni a jeni për a kundër, përderisa mënyra se qysh po bëhen këto debate me të vërtetë një njeri me inteligjencë mesatare e gjithë mësimdhënësit e kanë për mi aq bile, ju fyer intelijenca. Kujt po donë për t' ia mbushur mendjen për diçka? Nëse po donë t' ia mbushin mendjen njeri- tjetrit që është mirë, po të gjithë po themi që është mirë, nëse po dom t' ia mbushim mendjen njeri-tjetrit që po mendojmë ndryshe, atëherë është temë tjetër. Debatimi me kaq shumë diskutues

ka kuptim nëse ka grupe pro e contra edhe mendoj se është dashur për t'u deklaruar grupet a janë pro a contra këtij mocioni edhe të shkojnë më tutje.

Me të vërtetë po më duket që nuk është bash normal edhe po foli kështu po ju them edhe një herë se e di që s'ka transmetim edhe e kam lyp fjalën mbas transmetimit për t' i thënë këto fjalë. Nuk është hera e parë që po ndodh kështu, krejt po flasim njësoj, secili po provon të kallëzojë sa mësues i njeh, t'ua përmend emrat , të provojë me iu tha ndonjë votë, mani bre se nuk bënë kështu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja, zonja Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Po le ta di që jemi pa transmetim dhe nuk më bën shumë përshtypje a ka apo nuk ka transmetim.

I nderuari kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Rregullimi i statutit të mësuesve të cilët nuk e ndërprejnë punën nga viti 1990/91 e deri në '98/'99 është për t'u përshëndetur nga të gjithë pa përjashtim, megjithatë mësuesi duhet të shihen si një kategori e veçantë nga persona tjerë të cilët edhe janë pagur mirë apo kanë punuar vullnetarisht, sepse dihet se po thuaj se të gjithë shqiptarët me një mënyrë apo tjetër ishin të angazhuar në rezistencën popullore të asaj kohe.

Sa i përket njohjes së përvojës mund të them se do të ishte turp po qe se edhe vetëm të mendohej se mësimdhënësve të asaj kohe nuk duhet t'u njihet përvoja e punës, sepse kjo qasje jo vetëm që nuk përmban as dozën minimale të logjikës, por është edhe fyese edhe shumë e rëndë.

Të gjithë atyre të cilët kanë kryer punën që u është caktuar duhet t'u njihet përvoja e punës dhe kjo do të duhej të ishte e vetëkuptueshme, sepse edhe nxënësve të tyre, për shembull ju njoh shkollimi, përndryshe duhet që të gjithë ato gjenerata që dolën nga ata të presin miratimin e ligjit për të vazhduar shkollimin e mëtutjeshëm që do të mundësohej vetëm pas njohjes apo pranimi të mësim marrjes nga këta mësimdhënës.

Pra, nëse përvoja e mësuesve tanë nuk njihet atëherë çka na legjitimon neve nxënësve të tyre sot, a nuk u arsimuam ne nga po ata mësimdhënës?

Kërkoj që përvoja e punës duhet t'u njihet jo vetëm këtyre shtresave që përmenden në këtë propozim, por edhe gjithë atyre që u përzhunë me dhunë nga puna, sepse edhe ata vendosën të radhiteshin në krah të rezistencës popullore.

Kur thashë se mësimdhënësit duhet të shihen si kategori e veçantë, unë personalisht mendoj dhe propozoj se nëse merren parasysh rrethanat në të cilën mësimdhënësit në fjalë e jepen kontributin e tyre në vazhdimin e mësimi në gjuhën shqipe, atëherë jo vetëm që duhet llogaritur përvoja 9 apo 10- vjeçare, por se kjo përvojë duhet të llogaritur e dyfishuar dhe se ata mësimdhënës që hyjnë në këtë grup dhe të cilët kanë arritur moshën e pensionimit, të marrin pensionin në vlerë të pagës së tyre të fundit.

Duke marrë parasysh që në këtë periudhë kohore ishin krijuar fonde të veçanta për këto kategori, atëherë mendoj se ka ardhur koha edhe llogaridhënies lidhur me ato fonde.

Qasja në këtë çështje do të jepte edhe një herë e përgjithmonë fund spekulimeve që qarkullojnë në shoqëri dhe do të kontribuonte në vendosjen e rregullit dhe të përcaktimit të meritave në një mënyrë të civilizuar për një periudhë kohore të cilën ne e mbijetuum vetëm me angazhimin maksimal të të gjitha shtresave shoqërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Bytyçi.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë pse më herët kam kërkuar fjalën edhe kam qenë mbas Afërdita Berishës, po megjithatë le të jetë në ndërgjegjen e juaj.

Gjatë viteve 1990/91, arsimitarët e gjitha kategorive refuzuan zbatimin e ligjeve dhe plan-programeve mësimore të Republikës së Serbisë.

Ata organizuan procesin mësimor në kushte të okupimit serb, shtëpitë i shndërruan në shkolla dhe krijuan një sistem të pavarur arsimor në Kosovë.

Arsimi në Kosovë ka anët e veta pozitive që ka bërë një parandalim të një eksodi masiv të popullit shqiptar, sidomos të rinjve për në shtetet e perëndimit. Gjithashtu kjo kategori e tyre punuan në kushte të vështira të punësuarit pa pagesë.

Mirëpo, falë vëllezërve shqiptar dhe motrave shqiptare nga diaspora ata e mbajtën gjallë arsimin me një simbolikë.

Ata përveç punës së tyre ndihmuan dhe krijuan UÇK-n dhe ndihmuan luftën çlirimtare moralisht, materialisht duke ofruar edhe pjesëmarrjen aktive.

Pra, kjo ishte një qëndresë kolektive e mësimdhënësve, mirëpo për hir të së drejtës nuk duhet të shkëputet as kategoria e shërbyesve civilë të cilët punuan në sektorin publik, të cilët edhe këta me dhunë i larguan nga puna edhe kësaj kategorie t'i njihet stazhi pensional, sepse këta nuk mund të zënë përvojën prej 15 vjetëve.

Në fund, mbështes rekomandimet e Lidhjes Demokratike dhe lus të gjithë kolegë deputetë, domethënë t'i aprovojme këto rekomandime në Kuvend, pra të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Njëherit zoti kryesues do të ishte mirë jo dikush të flasë nga dy- tri herë e dikush hiq edhe zoti kryeministër vjen këtu vetëm na merr kohën, minutazhat del jashtë rendit të ditës, në qoftë se donë kryeministri të flasë, ta ngrit çështjen e komunave, atëherë le ta thërras një debat për tjera herë, le ta le. Jemi të gatshëm edhe të bëjmë këtu debate e jo ta shndërrojmë domethënë kur kemi për Qeverinë ta shndërrojmë në komuna. Më duket ju ka bërë kjo si sëmundje Prishtina. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Valbona Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Sa për sqarim koleges parafolëse, zoti kryeministër e ka të drejtën e fjalës të lejuar me Rregulloren të Kuvendit dhe ndoshta më të kisha përkrahur kolege nëse kishe thënë që të respektohet paraqitja e fjalës dhe t'ju jepet fjala diskutuesve sipas radhës e jo të kyçeshe në fjalën e kryeministrit, sepse atij ia lejon Rregullorja.

Debati të cilin sot po e debatojmë është i një rëndësie të veçantë dhe më kujtoj kohën jo shumë të largët ku rinia kosovare e shumë edhe nga ne këtu në këtë sallë, vijonim mësimin nëpër shtëpi- shkolla, në kushte tejet të vështira. Ishte koha më e vështirë e popullit të Kosovës kur regjimi policor ngulfaste çdo gjë në Kosovë, vriste, arrestonte, plaçkiste çdo gjë që ishte shqiptare, dëbonte nga puna dhe pikërisht ky dëbim dhe arsimtarët të cilët u përgjigjën në atë kohë ishin ata të cilët nuk u dorëzuar kurrë.

Dëshira e madhe mbi të gjitha guximi për t'u edukuar dhe mësuar në gjuhën shqipe ishte shumë e madhe sa që bënë gjithçka që të mos ndalohej mësimi, edhe pse shkollat ishin të mbyllura nga regjimi serb.

Familjarët që kanë lëshuar këto shtëpi për shkolla gjatë asaj periudhe kanë merita të veçanta, ishin ata të parët të cilët mundësuan hapësira për zhvillimin e mësimin përderisa shkollat shfrytëzoheshin nga regjimi serb si strehimore për refugjatë nga Bosnjë-Hercegovina dhe Kroacia. Por, këto shtëpi- shkolla nuk do të kishin rëndësinë e tyre sikur mos të ishte vullneti i madh i mësimdhënësve që të edukonin rininë kosovare përkundër rrezikut të madh jo vetëm të jetës së tyre, por edhe të familjarëve të tyre.

Për 10 vjet, mësimdhënësit kosovarë nuk u lodhën nga maltretimet e pushtuesit serbë dhe vështirësitë e asaj kohe sidomos ato ekonomike që ishin shumë të rënda, por, përkundër të gjitha këtyre vështirësive vullneti për edukimin e brezave të rinj sa vite e shtohet. Ata ishin një ndër shembujt më të mirë të popullit të Kosovës, andaj unë mburrem me kontributin e tyre. Fal kontributit të madh të mësimdhënësve tanë dhe vullnetit të lartë të familjarëve që kanë lëshuar shtëpitë gjatë viteve '90-99 mbijetoi arsimit shqip.

Ne brezat e rinj të atyre viteve u jemi falënderues të gjithë atyre mësimdhënësve të cilët nuk kryesën asgjë nga vetja që populli shqiptar të edukohet dhe të emancipohet.

Që nga paslufta e deri në vitin 2008 këtë mësimdhënës nuk kanë gëzuar asnjë benifit nga qeveritë e atëhershme, punonin po thuaj se me ndihma sociale.

Qeveria Thaçi ka bërë shumë që kësaj kategorie që dha kontribut të madh t'ia kthejë dinjitetin, identitetin e merituar.

Qeveria Thaçi mori vendimet e vështira krahasuar me buxhetin që ka Republika e Kosovës, vendimin për rritjen e pagave dhe ky vendim i gëzoi shumë mësimdhënësit dhe të gjithë shërbyesit civilë.

Ne si deputetë të gjithë u pa këtu që jemi për rregullimin e statusit të mësimdhënësve me ligj dhe ligji të rregullojë qartë të drejtat meritore të mësimdhënësve të viteve '90-'99, pra, njohja e përvojës së punës.

Njohja e përvojës së punës është ajo që më së paku duhet bërë për këtë kategori të mësimdhënësve, të cilët na edukuan në kohërat më të vështira. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bytyçi ka replikë.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryesues!

Unë zonjë nuk kërkova sqarim prej teje, por kryeministri po devijon prapë prej temës, po del prej temës, s'kërkova, domethënë, prej teje asgjë. Dhe ky po i mbulon defektet e Qeverisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryesues!

Unë e pashë të arsyeshme të sqaroj, meqenëse isha në radhë që m'u thirr emri për të folur dhe besoj që bëra mirë që ia kujtova. Unë e kisha përkrahur sikur ajo të thoshte – të respektohet renditja e paraqitjes së deputetit. Shumë e kisha përkrahur, por kryeministri e ka të lejuar fjalën me Rregullore, kështu që nuk është kurrëgjë keq nëse ta jap këtë këshillë, që lexojë Rregulloren. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Kam frikë se jo rrallë po merremi me politikë shumë të lartë duke i injoruar problemet themelore të njerëzve të cilët do të duhej t'i përfaqësonim.

Në këtë amnezion apo harresë të dhembshme dhe vetëmashttrim shkatërrues sikur nuk po ndjejmë më as frymën e vështirësuar të popullatës sonë, kemi mbytur në harresë peripecitë, sakrificat dhe përpjekjet nëpër të cilat kaluam së bashku dhe sikur duam të jetojmë për të sotmen.

Në këtë përsiatje kuturu pa busull e pa cak për të gjetur identitetin tonë individual, të stërkequr nga lakmia për famë të pamerituar, shkurt pamësia jetëshkurtër dhe bulimia kanibaliste, ne kemi harruar të gjithë shpesh edhe vetën tonë.

Kjo ringjallje e kombit tonë pas asaj nëpër të cilën kaluam po aq sa mund të konsiderohet si energji dhe potencial i pashtershëm për mbijetesë, po aq mund të konsiderohet si marrëzi, në qoftë se nga e kaluara nuk nxirret mësimi i duhur dhe sakrificat e bëra nuk vlerësohen dhe shpërblehen me mirënjohjen e merituar.

Në këtë kontekst, të nderuar deputetë, konsideroj si një shoqëri si popull dhe si individ kemi bërë një mëkat të pafalshëm ndaj dy kategorive, të punëtorëve të arsimit dhe të

shëndetësisë, të angazhuar në kuadër të klinikave të Shoqatës “Nënë Tereza” për vite të tëra në mbarë Kosovën.

Prandaj ngritjen e debatit për kompensimin apo të paktën njohjen e stazhit të punës, unë do të thosha sakrificës të punëtorëve të arsimit të dhe shëndetësisë në sistemin paralel të arsimit në Kosovë dhe të shëndetësisë po aq sa është e vonuar është edhe e domosdoshme, po aq sa është e domosdoshme është edhe njerëzore, po aq sa është njerëzore është edhe e natyrshme.

Nuk besoj se ka njeri që për këtë vonesë mund të fshihet mbas arsyetimeve naive dhe të shpenzuara si pengesat buxhetore apo ligjore për të rregulluar çështjen në fjalë.

Ata pishtarë të arsimit dhe shëndetësisë punuan pa kurrfarë kompensimi për vite të tëra dhe nuk lejuan agoninë e sistemit arsimor kosovar, shëndetësor dhe punëtorëve tjerë, parandaluan ikjen e të rinjve nëpër botë dhe shkatërrimin e qenies sonë kombëtare duke rrezikuar shpesh edhe veten e tyre dhe duke injoruar mirëqenien e tyre personale dhe familjare.

Prandaj, sot edhe po të kishim buxhetin e botës nuk do të mund ta shpërblemini atë që ata e bënë për kombin dhe për aq sa i njoh dhe kam kontakte me ta, as që presin t’u kompensohet, mirëpo, të paktën, si ligjvënës e kemi obligim moral që në mos kompensimit material, të paktën të bëjmë një kompensim moral dhe ligjor ndaj tyre.

Këtë mendoj se mund ta bëjmë duke ua njohur një si stazh të beneficuar pune të gjithë atyre profesionistëve të arsimit, të shëndetësisë dhe punëtorëve tjerë, të gjitha ato vite të kontributit të dhënë për popullin dhe për kombin. Kjo do të ishte më e pakta që mund dhe duhet të bëjmë për ta, pa humbur asnjë ditë. Por kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se duhet të heqim dorë nga kompensimi material i merituar i tyre. Kur e them këtë, më mban shpresa se një ditë kur ligji vërtet të jetë mbi të gjithë ne, në mos me rrugë tjetër, këtë duhet dhe mund ta sigurojmë nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme të atyre që keqpërdorën fonde të ndryshme dhe brenda natës u shndërruan në milionerë. Kështu të paktën do të shkarkojmë një ngrimë në ndërgjegjen tonë.

Prandaj, kur të përshkruhet destinimi i fondeve të krijuara nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme mendoj se duhet të prioritetizohet si kategori përfituese kategoria e punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve, të Kosovës.

Me siguri kjo është vetëm një nga shumë zgjidhje të mundshme për njohjen, vlerësimin dhe kompensimin e sakrificës së këtyre pishtarëve të arsimit, të shëndetësisë, kujtimit dhe vetëmohimit të të cilëve vërtet duhet t’i përulemi ne të gjithë.

Në kërkesën e 12 mijë e 341 nënshkruesve është edhe kërkesa e zgjidhjes, pra, të statusit të punëtorëve shëndetësorë, Këshillit të Financimit dhe të tjerëve, që të barazohet me statusin e personave të merituar në rezistencën kundër pushtetit okupues të Serbisë.

Lufta në Kosovë është zhvilluar në mënyra të ndryshme. Mënyra e luftës të cilën e kanë

zhvilluar punëtorët e arsimit ka qenë ditari dhe lapsi. Mënyra e luftës që e kanë zhvilluar punëtorët shëndetësorë ka qenë cistoskopi dhe pajisjet tjera mjekësore, kështu që unë besoj se këta e meritojnë një njohje të punës së sakrificës së tyre dhe unë kërkoj që në pikën 4 gjithsesi të rekomandimeve të futet që edhe punëtorët shëndetësorë dhe punëtorët tjerë që kanë qenë me dhunë të larguar nga puna, që kanë qenë të larguar si teprice teknologjike, të futen barabar me punëtorët e arsimit si përfitues të benifiteve. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Izmaiku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit kryesues!

Të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë,

E di që jeni të lodhur dhe jeni konsumuar prej krejt debateve. Përkundër kolegut tim Ardianit, mua po më vjen shumë keq që nuk ka transmetim. Kam pasur realisht nevojë që qytetarët e komunës së Vushtrrisë t'i dëgjojnë disa emra të cilët nuk janë vetëm në partinë time, por janë emrat që sot janë në Lidhjen Demokratike, janë në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, por një pjesë e tyre janë edhe të Shoqërisë Civile.

Pra, nuk ka qenë qëllimi për të fituar votë, por me të vërtetë njerëzit kanë nevojë të ndihen të respektuar dhe të çmuar nga ne. Po ashtu, kanë nevojë që të dëgjohen emrat e tyre për kontributin e tyre në këtë Kuvend.

Unë e kam fjalimin shumë të gjatë, por meqenëse jemi të lodhur, do ta dorëzoj me shkrim. Do të ndalem vetëm në një kontekst tjetër.

Kam nevojë që para juve të ndaj një, si të them, gjest jashtëzakonisht të mirë. Pra, qytetarët e komunës së Vushtrrisë, institucionet e komunës së Vushtrrisë janë njerëz të cilët këto merita i kanë materializuar në libra. Pra, është një libër, i punuar jashtëzakonisht me kualitet të mirë dhe flet për gjithë këtë përvojë, për atë periudhë 20-vjeçare ku mbi 3 000 nxënës të komunës së Vushtrrisë kanë qenë të organizuar nëpër shtëpi-shkolla dhe përmbi 60 qytetarë i kanë lëshuar shtëpitë e tyre, pra shtëpitë-shkolla dhe dikush, njëri nga ta edhe u rrah për vdekje, ishte i ndjeri veprimtari Zymber Haziri, i cili pasi e lëshoi shtëpinë për shkollë, një shtëpi të madhe në mes të qytetit, u rrah nga policia serbe dhe vdiq nga ajo rrahje.

Por, janë edhe shumë e shumë qytetarë të tjerë të cilët i bënë këto veprime dhe vitin e kaluar komuna e Vushtrrisë organizoi një ngjarje të madhe ku atyre qytetarëve të cilët liruuan shtëpitë-shkolla në atë periudhë u ndau mirënjohje. Ajo ishte shumë pak, mirëpo së paku ishte një përkrahje morale, pra njerëzit kanë nevojë të ndihen edhe mirënjohës dhe të jenë të çmuar, dhe për këtë e përgëzoj me të vërtetë Drejtorinë dhe në përgjithësi Komunën e Vushtrrisë, që e bëri një gjest të vogël.

Po ashtu, krejt në fund, do të ndaj edhe një ditar bashkë me ju. Kam pasur pra nevojë që ta shohin të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që ka njerëz që këto i ruajnë në arkivat e tyre të shtëpisë - ditar i improvizuar që e ruajti për 20 vjet një drejtor i një

shkolle në Vushtrri, ku u shënuan detajet e të gjitha orët, vërejtjet, shënuan edhe ndërhyrjet e policisë me datë e me orë.

Ju lutem, më lejoni vetëm për një minutë, t'ua lexoj vetëm një intervenim, të cilin e përshkruan një drejtor në Shkollën "Ali Kelmendi" në Vushtrri, i cili thotë se më datën 3. 9. 1994, pas mbledhjes me prindër thotë: "Në shkollën tonë hynë pjesëtarët e sigurimit dhe njëri nga ta i quajturi polici Simiq, i cili pastaj nuk është akuzuar vetëm për ndërhyrjen në shkollë, por ka qenë edhe kriminel". Pra, janë disa fletë ku shihet dhuna që është bërë nga arsimtarëve, dhe mendoj se kjo ia vlen të jetë në Arkivin e Republikës së Kosovës dhe ky dokument edhe fizikisht ia ka vlejtur të jetë sot në debat, këtu në Kuvend.

Pra, po më vjen jashtëzakonisht keq që qytetarët e mi sot nuk e kanë ndjerë këtë respekt se nuk arritën ta shohin nëpërmjet televizionit. Megjithatë, më vjen mirë që ju, kolegë të nderuar, e shihni që ata kanë nevojë të jenë të respektuar e të çmuar dhe do të jenë të çmuar, por unë nuk dyshoj që edhe Qeveria do ta kryejë punën e vet lidhur me çuarjen në vend të dinjitetit të këtyre njerëzve. Faleminderit!

Pjesë e diskutimit, e dorëzuar me shkrim

Të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë,
Debat i sotëm parlamentar lidhur me statusin e punëtorëve të arsimit shqiptarë të Republikës së Kosovës nga viti 1990 deri në vitin shkollor 1999, është më shumë se një debat, kërkesë, rekomandim, është një rikthim edhe emocional në një pjesë të së kaluarës sonë jo të largët për ne, plot vuajtje e plot peripeci.

Shumica nga ne deputetët në këtë sallë, ishim pjesë e këtij procesi, qoftë si mësimdhënës, studentë, nxënës, por edhe organizatorë e donatorë të shtëpive-shkolla për një periudhë 10-vjeçare.

Të nderuar qytetarë, edhe pse kanë kaluar 20 vjet, në memoriet tona nuk është fshirë asnjë kujtim, që lidhet me ditët kur nxënësit tanë u dëbuan nga shkollat e tyre, nga objektet e mësimi.

Në çdo cep të Kosovës, u bë mobilizim i qytetarëve tanë për të mos lënë pa mësim fëmijët e tyre dhe qytetarët tanë lëshuan shtëpitë e tyre për t'i bërë objekte mësimi e kush e kishte menduar se në shekullin 20 dikujt në mes Evropë akoma po i pengonte arsimimi në gjuhën amtare.

Kontributi i këtyre njerëzve që bënë të mundur vazhdimin e arsimit për gjeneratat e reja, qoftë i këtyre që sot janë gjallë, qoftë i atyre që nuk janë më ne në mesin e të gjallëve, do të mbetet lavdi e përvetshme, e bashkë me ta, të gjithë arsimtarët dhe punëtorët që morën pjesë në organizimin e mësimi alternativ në shtëpitë-shkolla, u bënë një faqe e ndritur e historisë së këtij vendi.

Të nderuar kolegë deputetë, me debitin nga objektet shkollorë të nxënësve të nxënësve të shkollave të mesme, mësimi u organizua edhe në objektet e shkollave fillore, dhe për

gjithë këtë proces u desht dhënë kontribut një numër i madh mësimeve të cilët punuan me përkushtim e atdhedashuri në kushte të rënda politike e financiare.

Duhet theksuar se në punën e këtyre qendrave që ishin mbijetesë e fundit e arsimit shqip, përveç arsimtarëve që më parë ishin në marrëdhënie pune në shkolla të mesme, kontribut dhanë edhe arsimtarët e shkollave fillore në lokalet e të cilave organizohej mësimi i shkollave të mesme, dhe stafi tjetër mbështetës e teknik.

Gjatë kësaj periudhe arsimit shqip përpiquej të mbijetonte dhunën e okupuarit. Vendosmëria e arsimtarëve për të qëndruar dhe punuar me nxënës në shkolla të veta do të mbetet shtyllë e fuqishme në luftën për çlirim e pavarësim të vendit.

Do të kujtoj këtu edhe protestat masive të cilat në një komunë siç është Vushtrria janë bërë deri 20 mijë qytetarë, për të kërkuar me dinjitet të drejtën për arsimimin.

Në këtë drejtim dua të përmend kontributin e profesorit Ramadan Pllana, një ish i burgosur politik i cili kryesoi këshillin e këtij organizimi në komunën e Vushtrrisë, pra protestat e para, por edhe të gjithë aktorët tjerë që nuk u ndalën në këtë betejë: arsimtarë, profesorë, drejtorë, qytetarë, njerëz të këtij vendi.

Statusi i këtyre njerëzve meriton vëmendjen tonë, pasi që ajo periudhë ishte një betejë para betejë, ata nxënës që u shkolluan në kushte okupimi, dolën edhe ushtarë të ardhshëm për çlirimin e vendit, ata sot janë kudo nëpër institucione të shtetit, janë policë, janë doganierë, janë profesorë, inxhinierë, janë mjekë, janë prind, qytetarë të këtij shteti të krijuar me shumë sfida e dhembje.

Arsimtarët dhe të gjithë ata qytetarë që kontribuan, ishin të vetëdijshëm se sakrifica ishte e vetmja rrugë që do të hapte shtigje për çlirim. Në këtë drejtim, mos të harrojmë se menjëherë pas këtij procesi, patëm edhe punëtorë shëndetësorë që dhanë një kontribut të çmuar në këtë periudhë.

Xhevahire Izmaqi, d.v.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Shumë shkurt, për kolegen e nderuar.

Është në rregull që njerëzit donë të dëgjojnë çka flitet në Kuvend po edhe më në rregull është për ta votuar ose mos ta votojnë kur është një mocion për të cilin tërë pajtohemi, dhe kjo ishte çka thashë unë.

Kuvendi është njëfarë tribune, ku njerëzit flasin çka mendojnë dhe tjerët i ndiejnë, është njëfarë tribune, është e vërtetë. Por, nuk bën për t'u shndërruar krejtësisht në tribunë, domethënë, kur edhe krejt deputetët flasin njëjtë, atëherë po shndërrohet krejtësisht në tribunë dhe krejt kjo është për çka fola unë.

Fundi i fundit, absolutisht pajtohem që njerëzit duan të dëgjojnë çka themi ne, nuk ka dilemë.

Dhe, e fundit, nuk e di, nuk isha i sigurt, ajo farë furra, a ishte në Gjakovë, a jo e kryetarit që e përmendi, e pata obligim ta pyes? Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zonja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit i nderuari kryesues!

Do të flas shumë shkurt meqenëse edhe është fundi i ditës, edhe shumica e çështjeve tashmë u shtruan.

Do t'i them vetëm disa fjalë, natyrisht për atë që ka ndodhur gjatë atyre viteve, sepse ky është fokusi i këtij debati dhe kjo është arsyeja pse është thirrur ky debat.

Siç e dimë të gjithë, por fatmirësisht çështja e mbijetesës së arsimit shqip edhe është ndërkombëtarizuar. Mbijetesa e popullit shqiptar ndaj sistemit shtetëror serb që kishte qëllime gjenocidale dhe gjatë viteve 90-ta zbatonte këtë politikë përmes diskriminimit dhe segregacionit, është një prej dëshmive më të veçanta se arsimi mund ta mbajë një popull gjallë dhe mund ta mbrojë atë nga asimilimi e nga shfarosja.

Shkeljet flagrante të drejtave të njeriut përfshirë edhe shkeljen e të drejtës në arsim, sepse regjimi milosheviqian e dinte se rrezikun më të madh i kishte shqiptarët e arsimuar, pra luftën me pendë, siç thoshte presidenti Rugova, mori përmasat më eklatante pikërisht gjatë viteve të '90-ta kur synohej asimilimi i shqiptarëve.

Siç u tha nga kolegët, studiuesit ndërkombëtarë thonë që mbijetesa e arsimit shqip gjatë viteve '89-'99 është ndër shembujt më unikë në botë të luftës paqësore me laps e me dituri.

Unë si nxënëse në atë kohë, natyrisht përjetimet kanë qenë në dy rrafshe të ndryshme, sepse si nxënës na është dashur t'i fshehim librat sepse çdo hetim nga ana e policisë në rrugët e Mitrovicës, kur kishim libra shqip përfundonte me dhunë ndaj nesh përkundër faktit që ishim nxënës të shkollave fillore.

Mirëpo, mbrojtjen më të madhe, një rrethojë të gjallë që na mbronte i kishim gjithmonë arsimtarët dhe profesorët tanë, prandaj edhe sot dua të shpreh admirimin tim për këtë punë e përkushtim të paprecedent i cili jo vetëm që bëhej pa pagesë në shumicën e rasteve, por ngërthente në vete rrezikimin e jetës së tyre.

Shumë prej arsimtarëve të mi sot nuk janë gjallë, sepse janë vrarë gjatë viteve të '90-ta, 2 prej tyre edhe para syve tanë si nxënës, prandaj unë vërtet shpreh admirimin e të gjithë tyre për këto sakrifica.

Sot u tha nga ministria Buja që çështja s'ka nevojë të rregullohet me rekomandime, në fakt ministri duhet ta dijë shumë mirë që asgjë nuk mund të rregullohet me rekomandime, sepse rekomandimi këtu thjeshtë kërkon që të miratohet ligji, mirëpo ligjin duhet domosdo ta miratojë Qeveria. Po ashtu u tha që do të ishte turp në qoftë se së paku tentohet që t'i hiqet kontributi apo t'i njihet stazhi asaj kategorie, në fakt një tentim i tillë

është bërë me Ligjin për skemat pensionale, ku ne e dimë shumë mirë të gjithë që neni 8 i atij ligji ka propozuar që vetëm përvoja nga viti 1999 të njihet, pra është përjashtuar në tërësi periudha '89-'99.

Kjo do të ishte vetëm një vazhdimësi e politikës Milosheviqiane, prandaj ne si deputetë assesi nuk do të duhej të lejojmë që diçka e tillë të vazhdonte.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës i cili u përmend, i vitit 2008, përkundër asaj që është një vendim, që ka krijuar efekte juridike, nuk është implementuar dhe fakti që ka pasur një tendencë tani me ligj të eliminohet efekti juridik i atij vendimi, tregon që ligji natyrisht e suprimon çdo vendim të Qeverisë, prandaj edhe ekziston nevoja e një ligji të tillë. Në qoftë se Ministria e Arsimit tashmë ka marrë iniciativën, mendoj që miratimi i këtyre rekomandimeve vetëm do ta përshpejtonte procedurën e ardhjes së atij ligji në Kuvend, meqenëse ka përcaktuar afatin kohor brenda të cilit duhet domosdoshmërisht të vijë në Kuvend.

Edhe një herë, shpresojmë që të gjithë deputetët do t'i përkrahin rekomandimet e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Berisha-Shala!

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për të gjithë ju kolegë deputetë, të pranishëm,
Edhe unë e di se jemi në fund të debatit, por po ndjehem e obliguar t'i them nja dy-tri fjalë dhe do të përpiqem të jem shumë e shkurtër dhe të mos përsëritëm nga kolegët.

Megjithatë, për atë periudhë kohore edhe vet kam, pothuaj se, një lloj nostalgjie, sepse kam qenë pjesë e asaj armate të mësimitdhënësve dhe pa dashur të hyj në histori të mbijetesës së arsimit shqip në Kosovë, po dua të kujtoj se me 21 gusht të vitit 1991, Grupi i Helsinkit në Vjenë e lëshoi një deklaratë ku konstatohej se arsimi shqiptar në Kosovë më nuk ekziston dhe se është shkatërruar nga Serbia.

Na kujtohet të gjithëve ajo kohë kur së pari sulmohet, ndërpritet mësimi në Fakultetin e Mjekësisë, për të vazhduar më tutje të përhapej si një epidemi në tërë sistemin arsimor, po edhe në segmente tjera të jetës në Kosovë. Nuk ka qenë rastësi që goditen sferat më të ndjeshme arsimi, shëndetësia e tjera, që pasojat e asaj kohe po i vuajmë ende, mbijetesa nuk ka qenë fare e lehtë. Ishte mobilizim i pashoq, andaj kjo periudhë mendoj që neve të gjithëve këtu në Parlamentin e Kosovës duhet të na bashkojë sikur që kemi qenë të bashkuar e të mobilizuar edhe në atë dhjetëvjetësh.

Në fillim të vitit 92, synohen të gjenden mundësitë dhe format që shkolla shqipe të fillojë të jetë aktive. Në fillim të shkurtit, Universiteti i Prishtinës njofton se më 17 shkurt të vitit 1992, do të fillojë mësimi në nivel universitar. Kështu, më 17 shkurt filloi viti akademik nëpër shtëpi – fakultete.

Mendoj se ajo ishte koha e mëvetësisë së shkollës shqipe në Kosovë, ishte koha më e lavdishme e arsimit shqip, ishte koha më homogjene, më e unifikuar ndër shqiptarë. Ishte koha kur një trekëndësh shumë i fuqishëm, siç është trekëndëshi nxënës – mësimmhënës dhe prind, ishin një front të mbrojtjes së shkollës, librit dhe gjuhës shqipe, ishte koha kur të gjithë shqiptarët ishin një dhe ia dolën me fitore. Prandaj, edhe një herë duhet t'i kthehemi asaj periudhe dhe të marrim mësim nga ajo kohë, ishte koha kur po mendohej në kohën e unifikimit për çështje shumë madhore të shtetit. Ishte koha kur u larguan ideologjizmat komunist, kur lëndët me përmbajtje kombëtare e shkencore u zhvilluan pa kufizime politike e ideologjike. Mendoj se ishte koha kur mund të quhet si hyrje në integrimin e sistemit kombëtar e arsimor me një planprogram e tekste për të gjithë shqiptarët.

Të nderuar, secili nga ne bart kujtime nga ajo kohë, dikush si pjesë e armatës së mësimmhënësve, dikush si nxënës e dikush si student. Meqenëse edhe unë kam qenë pjesë e arsimit, ku përveç dijes që u ofronim nxënësve kishim si obligim që të ofronim edhe dije, edhe ndërgjegjësim, edhe vetëdijësim për luftën që e kishim para. Dhe më ka rastis që shumë nxënës të mi t'i shoh edhe në vijat e para të frontit të luftës, edhe pse në atë kohë nuk kishim paga, kënaqësinë e gjenim në vullnetin e nxënësve, në vullnetin e prindërve dhe në vullnetin e kolegëve.

Me që flitet për atë kohë, do t'i jap veti të drejtë këtu të kujtoj një bashkë kolege timen, të nderuarën - të pavdekshmen, heroinën e kombit, Xhevë Krasniqi - Lladrovci që në atë kohë e jepte lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Gjimnazin "Skënderbeu" në Drenas.

Dua t'i jap veti të drejtë ta kujtoj me pietet të lartë edhe nxënësen time, Luljeta Shalën, ish- ushtarë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, tani dëshmore e kombit e rënë në kufirin shqiptaro-shqiptar. Unë i kam dhënë matematikë në atë kohë, e ajo me pavdekësinë e vet u ka siguruar gjeneratës së vet dhe brezave që vijnë lirinë që po e gëzojmë. Shkolla në atë kohë nuk ka qenë vetëm bazë e mësimmhënies dhe mësim- nxënies, por ka qenë edhe vullkan që e ka mbajtur llavën e ndezur për liri.

Dhe, mendoj se për deri sa të vlerësohet validiteti jo vetëm i sistemit arsimor për ato vite 90 – 99, atëherë është krejt normale që edhe të zgjidhet statusi i të gjithë punëtorëve që kanë punuar në sistemin arsimor gjatë kësaj periudhe, prandaj dua të kthehem edhe një herë t'i rikujtoj, mendoj që vendimi i nënshkruar nga viti 2008, nga kryeministri i Kosovës, një vendim në mënyrë që t'u njihet të gjithë mësimmhënësve të Republikës së Kosovës periudha dhjetëvjeçare e ka bazën këtu.

Ajo çka ne duhet të bëjmë si deputetë, duhet të kujdesemi se sa po zbatohen ato vendime, se sa kemi bërë ligje dhe se sa duhet të jemi ne në nivel të detyrës që të iniciojmë dhe t'i shohim se sa po zbatohen e t'i miratojmë sa më shpejtë ato ligje.

Askujt nuk duhet t'i shkojë mendja se një betejë dhjetëvjeçare e punëtorëve të arsimit mund të heshtet e as të anashkalohet, siç u përmend këtu, e aq më pak nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ku në këtë Kuvend ka ish- mësimmhënës, ish- nxënës e të tjerë.

Dhe mendoj se statusi i këtyre njerëzve meriton vëmendjen tonë pasi që ajo periudhë ishte një betejë para betejë, ata nxënës që u shkolluan në kushte okupimi, dolën edhe ushtarë të ardhshëm për çlirimin e vendit, ata sot janë kudo nëpër institucione, disa prej tyre janë edhe në altarin e pavdekësisë për të cilin ne kemi obligim shumëfish që t'i nderojmë e respektojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmeti e ka fjalën.

IMRI AHMETI: Faleminderit kryesues!

Normalisht që është konsumuar debati dhe po provoj me qenë, vetëm për dy-tri segmente t'i përdor.

Ky vullnet i shprehur sot nga të gjitha subjektet politike, uroj që të gjejë zbatim nga Qeveria në praktikë dhe normalisht ky vullnet i shprehur për të mbështetur që përvoja e punës të kategorisë së punëtorëve arsimorë të viteve 90 të njihet, është një vullnet që besoj se Qeveria do të duhej të afatizohej përmes rekomandimeve në periudhë të caktuar kohore të implementojë.

E mira e këtij debati është që më duket se po pranohet në fakt ndoshta më mirë me vonë se kurrë që Kosova në vitet 90-ka pasur institucionet e veta shtetërore të ndërtuara, të strukturuar, të financuara, të legjitimuara dhe të mbështetura nga gjithë popullata shqiptare në shumicë.

Sektori i arsimit nuk ka funksionuar vetë dhe funksionimi i sektorit të arsimit para se gjithash është rezultat, produkt, vullnet i qytetarëve, i vullnetit të tyre për të vazhduar arsimimin, por duhet të pranojmë edhe është rezultat i politikave të ndërtuara nga institucionet e asaj kohe dhe ky sektor nuk mund të jetë i ndarë nga ata që e kanë bërë politikën, e kanë ndërtuar politikën e zhvillimit të arsimit dhe të sektorëve tjerë.

Thjesht, dua të jem në kuptimin praktik që arsimi është mbajtur gjallë bashkë me këshillat e arsimit, bashkë me këshillat e financimit, me nënkëshillat e financimit që kanë funksionuar në çdo lagje, në çdo qytet dhe në çdo sferë. Dhe unë uroj që ky vullnet të vazhdohet tutje me njohjen e statusit dhe me njohjen e përvojës së punës të gjitha institucioneve që kanë funksionuar në vitet e '90-ta sipas Kushtetutës së Kaçanikut. Sepse, mos harroni, se e kemi pasur edhe sistemin juridik të ndërtuar për vitet, për të cilat po flasim.

Për të mos zgjatur, sepse u konsumua debati, unë kujtoj se ka edhe segmente tjera të rëndësishme të asaj periudhe, siç ka qenë QIK-u, siç janë ish- deputetët e legjislaturave të para luftës, deri te zyra e Presidencës, tek stafi teknik i asaj zyre.

Për të mos marrë kohë, krejt në fund, jashtë kësaj teme një të vërtetë e kam kuptuar, që për ta kritikuar kryesuesin dhe për ta kritikuar kryetarin e Kuvendit, fjalën e merr në fund, pavarësisht kur e ke kërkuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë vetëm kryesuesi ose kryetari duhet të marrë pjesë në ndonjë këngë që duam ta këndojmë si në kor të gjithë bashkë dhe flasim të gjithë përnjëherë. Rregulli është rregull, unë s'e kam kaluar asnjërin. Përkundrazi, që duhet për të përzgjedhur, jeni në radhë siç jeni paraqitur të gjithë, kështu që unë i kam parasysh vërejtjet. Asnjëri që ka kërkuar, me përjashtim, s'e kam kaluar kurrë, po më vjen keq që të ka ardhur rendi vonë, por qysh je paraqitur ashtu të ka ardhur. Zoti Kryeziu e ka fjalën.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet për ministrin e Arsimit, që në fakt është sot këtu titullari kryesor i këtij debati.

Dola, si tha dikush, ma përkujtoj që s'ka transmetim, kështu që mund të jem më intim në këto biseda, se unë zakonisht hyj do qyfyreve, në këtë rast nuk do të më shkruhen, ku ta di se sa.

Në fakt dola për të folur për një ndjesi, njëfarë lloj sentiment i cili definitivisht është i pakapshëm me formulime formalo-juridike. Unë nuk po i kontestoj këto debate për normatizim e ligje... jo larg asaj, por dalja ime është për të folur për këto çështje të pakapshme nga këto dispozita.

Është fjala për homazhin që dëshiroj t'ia bëj një gjenerate të tërë të fëmijëve që kanë shkuar nëpër ato shkolla.

Po unë dola për të bërë homazh për fëmijë që kanë shkuar nëpër ato shkolla. Është e vërtetë që unë kam qenë njëfarë mësuesi në periferi, por unë s'kam pasur qare pa shkuar në shkollë kur ishin carrokët armata të tëra se shqiptarët këtë të mirë e kanë pasur deri tash së paku, që kanë pasur fëmijë mjaft, kështu që unë dola për këtë gjë, këtu.

Dhe, më lejoni të citoj një poet serb, i Nishit, emblema kryesore e poezisë pas Luftës së Dytë Botërore, serbe është ky njeri që e vari veten në pyllin e Maksimit në Zagreb, më 61, në moshën 27-vjeçare, e ndiqte policia sekrete, iku nga Beogradi, për t'i kontribuar edhe Kosovës multikulturore, natyrisht. Edhe vargu i tij si sinonim i emrit të tij është: "A do të dijë vallë liria të këndojë, siç i kënduan robërit asaj". Ky është vargu i tij emblemantik.

Çka po dua të them? Po dua të them a ka qeveri në Kosovë, a ka pasur qeveri në Kosovë dhe a do të ketë qeveri në Kosovë, që do të mund ta kompensojë këtë vendosmëri të atyre carrokëve, 'kolopuqëve', sa frika, sa ankthi, sa tmerri i fëmijëve. Qysh mundësh ta kompensosh atë, qysh mundësh ta vlerësosh atë?

Kështu që unë dola këtu për këtë gjë. Dhe nuk është, është meritë e imja që e kam pasur në bashkëbisedim këtë temë që në kohën e serbit dhe më erdhi mirë që ndejta deri në vonë, falë edhe Kryesisë që na detyron të jemi këtu si mriz, e nuk e bën me orar kur duhet për të votuar dhe ti vjen, nuk keni nevojë të më dëgjoni mua çka flas këtu. Po, Kryesia ka qejf nga pak me na... Kurrkund në botë nuk ka që duhet për të mrizuar njerëzit patjetër të më dëgjojnë edhe mua çka flas këtu në Parlament, kurrkund në botë s'ka.

Por, sidoqoftë, edhe një herë po them, madje jam i emocionuar ku flas për këtë temë, po duket sikur energjia kryesore më e madhe dhe më e shenjta është e pakapshme edhe nga historia edhe nga ligjet. Unë e kam fjalën tek ata ‘kolopuqët’ - vendosmëri, frikë, ankth, tmerr, megjithatë guxim, se si tha dikush, nuk ka trimëri pa frikë. Po pse te fëmija? Mos po manipuloj unë me fëmijë tash? Jo, kjo ka shkuar më. Veç mbetet ta citoj Ungjillin dhe Krishtin, që tha: “të vërtetën do ta kuptoni nga gojët e fëmijëve”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar! Nuk do ta zgjas për shkak se u fol shumë për këtë histori, histori e cila i ka pasur edhe protagonistët e saj, të cilët sot janë në Parlament, të cilët disa po flasin, disa po dëgjojnë me kureshtje, po flasim për një histori e cila i ka edhe të bukurat edhe të këqijat e veta.

E bukura e saj ishte që ne mbijetuan, ne jemi sot këtu falë një organizimi të përkryer që sot na e kanë lakmi të gjithë ata të cilët studiojnë apo merren me çështjen tonë shqiptare.

Tmerri i asaj është që ishte që ishte thyerja e pushtetit serb, pikërisht mbi bazën e këtij organizimi politik dhe të arsimit.

Ndjej për obligim që në fund si deputet i cili flet para juve, për shkak të përgjegjësisë të cilën e kam pasur në atë kohë si njeri i dytë në hierarki, që sot edhe ministri i cili sot me meritë është ministër për arsye se ka qenë pjesë dhe bartës i viteve të ‘90-ta të atij organizmi, është edhe kryetari i Parlamentit i cili ka qenë po ashtu njëri nga bartësit e organizimit të atij aktiviteti, siç janë të gjithë deputetët e LDK-së sot, edhe ju deputetët tjerë të cilët nuk jeni më në LDK, por në vitet e ‘90-ta ishim të gjithë në LDK se LDK-ja ishte forcë sublimë e organizuar për të bërë organizimin kundër pushtetit serb, ishte një përpjekje e përbashkët, ishte një meritë dhe një mburrje kolektive e përbashkët.

Sot mund të flasin ndrysh, për arsye se jemi të ndarë në subjekte politike. Për atë që unë marr përgjegjësi para juve, me dy fjalë, t’i them. Mbaj përgjegjësi, evidencë për të gjitha ato dokumente, për të gjitha ato para që janë shpërndarë për arsimin. Këtu u folën shuma, që ia futën kot, fjala është për 181 milionë të grumbulluara e të ndara nga kafshata e bukës. Njerëzit e kanë shitur domethënë edhe atë që e kanë pasur pak, për me e la atë 3%, por unë po ju them, ishte një sasi e parave jo vetëm për arsimtarë, fjala është për 181 milionë që janë dhënë në llogari në Kuvendin e Republikës së Kosovës, menjëherë pas luftës dhe presidentit Rugova. Nuk është financuar vetëm arsimi për pagë, është financuar edhe libri, edhe kultura, edhe shëndetësia, edhe politika, edhe sporti, të gjitha janë financuar prej këtyre mjeteve dhe këto shënime mund t’i kërkon, mund të keni qasje sa herë të doni, mund t’ua dërgoj secilit deputet në e-mailin e vet, që ta ketë parasysh si janë grumbulluar mjetet, si janë shpërndarë sipas komunave dhe të përmbledhura në nivel të Kosovës. Gjithmonë e kam fjalën për mjetet e grumbulluara në Kosovë edhe ato mjete të cilat kanë ardhur nga diaspora për këtë qëllim.

Kjo ishte, domethënë, ideja që para jush të them që shënimet ekzistojnë, janë të sakta.

Ajo që më bëri përshtypje, por edhe jo shumë, që ministri për çështje sociale, doli këtu me thënë gjëra të cilat nuk qëndrojnë.

Këshilli për arsim dhe Këshilli për financim kanë qenë jashtëzakonisht mirë të organizuar. Ekzistojnë evidenca të sakta. Për të gjithë ata arsimtarë që kanë punuar, për të gjithë ata njerëz që kanë qenë të angazhuar në këtë çështje, shënimet janë të përkryera, të sakta. Vetëm a dëshiron Qeveria t'i marrë ato, ta keni parasysh, shumica e arsimtarëve që kanë punuar edhe e njerëzve edhe sot punojnë. Domethënë, nuk ka edhe shpenzime sa këtu u treguan, është me rëndësi që në mënyrë të dinjitetshme për një periudhë për të cilën krenohemi krejt, të kemi një qasje të barabartë ndaj të gjitha strukturave shoqërore për të cilat kemi bërë deri tash diçka. Faleminderit, për vëmendje, kryetar. Shënimet mund t'i keni në qasje sa herë të doni, kur të doni, cili do prej juve, shënimet janë të përpunuara dhe në mënyrë analitike të prezantuara. Faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

HASHIM DESHISHKU: I nderuari kryetar i Parlamentit,

I nderuari kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Zgjidhja e çështjes së punëtorëve të arsimit për periudhën 1990-1999 është njëra prej detyrave më të rëndësishme që ka kjo shoqëri, posaçërisht Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës.

Për këtë ka shumë arsye:

1. Punëtorët e arsimit, pas ushtarëve të UÇK-së, në të kaluarën kanë pasur rol të rëndësishëm për kultivimin e shoqërisë dhe për ndërtimin e institucioneve;
2. Të udhëhequr nga ideja vizionare e presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova, arsimi në Kosovë në periudhën ndërmjet viteve 1990-1999 në mënyrën më të mirë e ka pasqyruar funksionimin e shtetit dhe të institucioneve të tij në kohën e një okupimi të egër;
3. Kjo pjesë e shoqërisë sonë i ka meritat kryesore pse në procesin e arsimit nuk pati asnjë ditë ngecje, pos gjatë kohës së luftës. Pra, punëtorët e arsimit atëherë e morën përgjegjësinë për ngritjen dhe arsimin e gjeneratave, e cila falë asaj pune sot e ka marrë në dorë udhëheqjen dhe ndërtimin e shtetit.

Kontributi i tyre vërehet kur kemi parasysh se një numër shumë i madh i nxënësve dhe i studentëve të atëhershëm, falë dijes dhe diplomave, që kishte fituar gjatë punës nëpër shtëpi-shkolla, sot kanë arritur në nivele të rëndësishme, si në shkencë, politikë, arsim, biznes dhe në të gjitha poret e jetës.

Pra, ky dokumentacion nuk ka qenë i pavlerë, sikur që nuk ka qenë e pavlerë as puna e mbi 23 mijë punëtorëve të arsimit, të angazhuar në të gjitha nivelet.

Ndonëse të gjithë e dini, vetëm po ju përkujtoj se në çfarë rrethanash është punuar:

1. Punëtorët e arsimit, që të gjithë kanë qenë nën shënjestrën e pushtetit të atëhershëm okupues serb, meqenëse ata e kanë mbajtur gjallë shpresën e

- popullatës për një ardhmëri më të mirë, e njëkohësisht kanë përgatitur gjenerata për shtetin e ardhshëm të Kosovës;
2. Për ndjekjen dhe represionin që është shtrirë mbi ta, mjafton vetëm ta përmend vrasjen e arsimtarëve në fshatin Uçë të Burimit, por janë edhe sa e sa të tjerë të burgosur, e të torturuar. Nuk duhet harruar se në shënjestër të okupatorit kanë qenë edhe pronarët e shtëpive-shkolla, sikur edhe nxënësit që kanë ndjekur mësimin aty;
 3. Pa marrë parasysh këto rrethana dhe gjendjen materiale, asnjëherë, madje asnjë ditë nuk ka ardhur në pikëpyetje vazhdimi i punës në institucionet arsimore të asaj kohe, por falë edhe mobilizimit të popullatës dhe kontributit të saj nëpërmjet Fondit të 3-përqindëshit, u mbuluan të gjitha nevojat materiale që ka pasur sistemi i atëhershëm i arsimit.

A nuk janë këto arsye të mjaftueshme që Qeveria e Kosovës të kërkojë zgjidhje për këtë kategori të punëtorëve, kontributi i të cilëve ishte i pazëvendësueshëm gjatë asaj periudhe të rëndësishme në historinë e shtetit të Kosovës.

Pa marrë parasysh problemet që mund të shkaktohen në buxhetin e vendit, është për përshëndetje angazhimi i Qeverisë për mbrojtjen e standardit të punëtorëve në arsim. Posaçërisht kur dihet se kjo ka qenë kategoria më e shtypur dhe më e persekutuar gjatë gjithë historisë.

Tash, ne jemi ata që e kemi detyrim dhe përgjegjësi që punës që është bërë në arsim gjatë periudhës 1990-1999 t'ia japim vlerësimin më meritë dhe atë ta trajtojmë si punë me rëndësi të veçantë për popullatën dhe shtetin. Njëkohësisht ta bëjmë të qartë se puna e atëhershme nuk ka qenë spontane dhe e bazuar në vullnetin individual, por ishte e organizuar përbrenda lëvizjes së atëhershme, të udhëhequr nga presidenti historik, Ibrahim Rugova.

Kjo punë që është bërë me gjeneratat e reja të asaj kohe nuk duhet, por as që mund të merret si meritë e një partie. Ajo fillimisht është meritë e punëtorëve të arsimit, të cilët nuk kursyen asgjë, vetëm që të mos mbytet dija në Kosovë. Ndërkaq, i tërë organizimi dhe funksionimi ishte bërë në pajtim me rrethanat e asaj kohe.

Kështu që ky është obligim shtetëror, përkatësisht qeveritar, e jo i një partie politike.

Ndërkaq, Lidhja Demokratike e Kosovës po e aktualizon këtë problem, nisur nga fakti, se:

1. Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk e ka përmendur, e as që e ka trajtuar çështjen e funksionimit të arsimit gjatë periudhës 1990-1999;
2. Qeveria e Kosovës ka gjetur zgjidhje për disa kategori të shoqërisë - si janë pjesëmarrësit e luftës, veteranët, invalidët, pensionistët kontributdhënës, minatorët. Dhe, mirë që e ka bërë këtë, meqenëse e ka shpërblyer kontributin dhe meritat individuale për të arritur deri te pavarësia dhe shteti;

3. Por, do të jetë padrejtësi e madhe dhe sjellje johumane, së pari e Qeverisë, pastaj edhe e të gjitha strukturave shtetërore, po që se një zgjidhje e tillë nuk gjendet edhe për punëtorët e arsimit, të cilët kanë merita kryesore për funksionimin e institucioneve arsimore gjatë kohës së okupimit.

Faleminderit!

Hashim Deshishku, d.v.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani po paraqiten për së dyti, po më duket. Hykmete, a do të diskutosh prapë? Urdhëro!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Jo, nuk jam për së dyti. Është hera e parë që po e marr fjalën për këtë debat. Unë desha veç t'u bëj thirrje deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës të cilët, në krye me kryeministrin e tyre, folën shumë për punëtorët e arsimit dhe tash nuk janë këtu, duket që me qëllim e kanë humbur kuorumin dhe kjo duhet të theksohet.

Ju lutem, mjaft më me retorika, na vyejnë veprimet konkrete. Ku janë deputetët, ku është kryeministri që na bënte neve ftesë që e kemi thirrur debatin, për ta përkrahur në implementimin e vendimit? Është po ai kryeministër i cili i ka thirrur deputetët dhe i ka qit jashtë, me humbë, sepse kjo është arsyeja gjithmonë, gjithmonë po e humbni kuorumin vetëm që t' i humb rëndësia dhe relevanca debateve që po i thërrasim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Ne debatuaam për një çështje tepër të ndjeshme, tepër të rëndësishme. U thurën lavde nga të gjithë, po gjithsecili le ta shikojë veten në pasqyrë dhe s'ka nevojë kurrkush askujt këtu për t'i mbajtur ligjëratë dhe për t'i dhënë mend, se të gjithë e vlerësojnë vetveten dhe i kanë ato merita që kanë.

Se sa ishte çështja serioze, e rëndësishme, s'kemi kurrfarë komenti, dihet. Kryeministri ishte shumë i qartë. Është një vendim që jo vetëm për një kategori, por për të gjitha kategoritë, duhet t'u njihet përvoja e punës. E bëri edhe më të qartë ministri i Arsimit për sektorin përkatës, se është në përfundim e sipër ligji i cili do ta njohë këtë përvojë të punës, folën edhe përfaqësuesit apo anëtarët e komisioneve përkatëse se jemi duke punuar për këtë çështje dhe ne deri më tash kemi bërë apo është shfrytëzuar foltorja e Parlamentit për të bërë fushatë, për të shitur demagogji dhe po shihet qartë se sa jemi të gatshëm vërtet ato fjalë t'i shndërrojmë në vepra. Dhe, unë po them shumë qartë e me përgjegjësi, Qeveria u deklarua dhe kërkohet përkrahje serioze prej të gjithëve që vërtet ta ndihmojmë, ta përkrahim që këto kërkesa tona të shndërrohen në realitet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hamiti, nënkryetar i Kuvendit.

SABRI HAMITI: Kush duron, fiton! Edhe mos të ankohet kurrkush pse i pari e i fundit. Ai që flet i fundit është, e ka edhe përparësinë nëse do, se i ka dëgjuar të gjithë.

Unë veç po përsëris, po sublimoj. Të gjithë i vlerësuan në nivelin më të lartë arsimtarët që për 10 vjet të vështira e kanë udhëhequr arsimin.

Meqë të gjithë i vlerësuan ashtu, atëherë le të vendosë Kuvendi që iu njihet merita e veçantë arsimtarëve të viteve 90 të shekullit të kaluar, le të vendosë Kuvendi përmes votës tuaj, që iu njihet stazhi i atyre 10 vjetëve, le të vendosë Kuvendi t'i urdhërojë Qeverisë ta hartojë ligjin në afatin brenda 2 muajve ose 3, qysh të merremi vesh, për këto dy vendimet e para. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Siç e kemi filluar ne që një kohë të caktuar për të kërkuar buxhet dhe për të vendosur, është vështirë që t'ia arrijmë qëllimit për t'i realizuar të gjitha aspiratat tona.

Një ditë lexova që në krejt botën, janë diku rreth disa qindra kub metër ari, krejt bota ka aq shumë ar. Andaj, ne nuk e kemi as buxhetin e Zvicrës as buxhetin e botës, kemi këto që i kemi dhe unë mendoj që para se të jemi elektorale shumë, të jemi realistë për ato që mund t'i realizojmë.

Kuorum nuk ka. I fundit, i mbetet, sipas Rregullores, zotit Beqiri...

(Ndërhyrje)

Po s'është me Rregullore ajo, 52 deputetë janë në sallë.

(Ndërhyrje)

Jo, e dimë shumë mirë. Qysh? Nuk e di unë. Çka? Janë regjistruar atje kush ka qenë në sallë.

(Ndërhyrje)

A, tash, mirë de, nëse keni kërkesë, pse jo. Regjia për prezencë votojmë tash.

Nuk pranoresh ti pa kartelë dhe vota jote s'vlen!

Atëherë, regjia po e jep, duke e përfshirë edhe një pa kartelë, janë 51 deputetë në sallë.

(Ndërhyrje)

Unë po e them këtë dhe vetëm 1 është paraqitur pa kartelë, të tjerët s'e kanë shtypur sustën.

Pra, 52 deputetë janë në sallë. Zoti Beqiri, e keni fjalën përfundimtare. Dhe pastaj votojmë, e lëmë për një ditë tjetër e votojmë, çka të bëjmë tash. Zoti Beqiri, e keni fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Meqenëse nuk ka kuorum, zoti nënkryetar, normalisht edhe unë i falënderoj të gjithë deputetët për kontributin e tyre dhe ne në seancën tjetër, meqenëse s'ka kuorum, unë do t'i lexoj po ato rekomandime që ishin në fillim të seancës që i kam lexuar, por kjo mbetet kur të kemi kuorum, unë do t'i lexoj, sepse sot s'mund t'i lexoj këtu. Dhe unë do të kërkoj atë ditë edhe do t'i lexoj edhe do të kërkoj të votohen rekomandimet. Faleminderit!

KRYESUESI: Mendoj, meqë jemi në seancë dhe duhet t'i lexosh tani ta përfundojmë e ta bëjmë votimin, pastaj, nuk ka ndonjë të keqe, besoj. Dhe, këta të administratës duhet t'ua shpërndajnë të gjithë deputetëve për seancën e ardhshme rekomandimet dhe të votojnë, nuk është ndonjë problem. Mendova se mos ke ndërruar diçka, nëse janë ato, i kemi. Atëherë, vazhdo. Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë duke mos dëshiruar t'ju lodh as për atë se çfarë shkruan si çështje as si arsyetim, më lejon që në fund të debatit vetëm t'i lexoj rekomandimet e Grupit Parlamentar të LDK-së. Edhe një herë po them, i falënderoj të gjithë ata që kanë dhënë kontribut në diçka që është e rëndësishme për të gjithë ne. Dhe rekomandimet janë këto:

1. Të nxirret ligj i veçantë për statusin e punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti shkollor '90/'91 deri në vitin shkollor '98/'99, në bazë të cilit ligj statusi i tyre barazohet me statusin e personave të merituar në formimin dhe ndërtimin e shtetit të Republikës së Kosovës.
2. Ky ligj të përfshijë, mes tjerash, rregullimin e statusit të mësimdhënësve, personelit udhëheqës, personelit tjetër të punësuar në shkolla, përkatësisht universitete, të punësuarve në sekretariatet, këshillat komunale të arsimit, entet pedagogjike komunale dhe republikane si dhe në Ministrinë e Arsimit të Republikës së Kosovës, të punësuarve në këshillat e financimit, të pronarëve shtëpi-shkolla dhe
3. Qeveria e Republikës së Kosovës të jetë bartëse e hartimit të këtij ligji në afatin kohor prej 3 muajsh dhe ta sjellë për miratim këtë ligj në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Nëse ai është gati, siç u tha, ne veç e motivojmë që të bëhet dhe sillet më shpejt dhe unë shpresoj që në seancën e radhës deputetët e nderuar do t'i votojnë këto rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Beqiri, unë po besoj se pas mbledhjes së Kryesisë, kur do të caktohet seanca, do të votohen rekomandimet e Grupit Parlamentar.

Mirupafshim në seancën e ardhshme!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, të filluar më 11 prill 2013
Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Konstatoj se në sallë, me elektronikë, janë 66 deputetë, nëse ka deputetë pa kartela. Le të lajmërohen ata. Nuk ka. Vazhdojmë. Prania fizike është 73, dhe një pa kartelë. Mirë, 74 deputetë.

E vazhdojmë seancën e kaluar, me një pikë të rendit të ditës:

1. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me statusin e pazgjidhur të punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990 deri në vitin 1999, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe rekomandimeve të komisioneve parlamentare

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2013. Mirëpo, në mungesë të kuoromit, votimi për këtë pikë është shtyrë për sot. Andaj, vazhdojmë me votimin e rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me statusin e pazgjedhur të punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990 deri në vitin shkollor 1999, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe rekomandimeve të komisioneve parlamentare. Ju e dini se janë dy komisione parlamentare.

Të pranishëm janë 77 deputetë, edhe prania fizike, edhe prania elektronike. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 66 vota për, 7 vota kundër dhe një abstenim, konstatoj se Kuvendi i miratoi rekomandimet për statusin e pazgjedhur të punëtorëve të arsimit të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 dhe me këtë e përfundojmë këtë seancë të vazhduar.

Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë